

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Manuali i Mbikëqyrjes të Shoqërive të Sigurimit

Përmbajtja

Faqe Nr.

A. METODOLOGJIA	4
Hyrje	4
Pamje e përgjithshme e mbikëqyrjes me fokus rrezikun	4
Çfarë Nënkuptomë me “Mbikëqyrje me Fokus Rrezikun”	6
Pse me fokus rrezikun: Avantazhet dhe sfidat.....	6
Cikli i Mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun	10
A.1. FAZA I: Mbledhja e Informacionit dhe Analiza Financiare Paraprake	13
HAPI 1: Mbledhja e Informacionit	13
HAPI 2: Shqyrtimi i Informacionit të Mbledhur dhe Analiza Financiare	16
Planet e Biznesit	17
Raportet e Auditimit	18
STEP 3: Gjetjet kryesore dhe përditësimi i Profilit Përmbledhës të Siguruesit.....	20
A.2. FAZA II: Planifikimi i inspektimit.....	21
A. 2.1 Dokumenti i Planifikimit të Inspektimit.	21
A.2.2 Kërkesat e para-inspektimit dhe koha kur kryhet inspektimi.....	21
A.3. Faza III: Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut dhe Strategjitë për Zbutjen e Rrezikut... ..	23
Matrica e RrezikuRrezikut	23
A.3.1 Aktivitetet e biznesit dhe rreziqet e pranishëm	24
A.3.2 Mbikëqyrja dhe rreziku neto.....	34
A.4. Faza IV Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut të Përgjithshëm Neto dhe Rrezikut të Përbërë.....	40
A.4.1 Rreziku i përgjithshëm neto	40
A.4.2 Kapitali dhe fitimet	41
A.4.3 Rreziku i përbërë	44
A.5 Faza V Njoftimi i gjetjeve të Inspektimit dhe Letra për drejtuesit.	47
A.5.1 Njoftimi i gjetjeve të Inspektimit	47
A.5.2 Letra për drejtuesit	47
A.6 Faza VI Përditësimi i Përparësive dhe Profilit Përmbledhës të Siguruesit	48
A.6.1 Vendosja e Përparësive dhe Profili Përmbledhës i Siguruesit	48
A.6.2 Shkalla e Ndërhyrjes	48
B. ANEKS 1. ILUSTRIME	56
Profili përmbledhës i siguruesit	57
Pyetësi i Planifikimit të Inspektimit	59
Kuptimi i Strukturës së Qeverisjes së Shoqërisë	69
Procedurat e Rishikimit Analitik.....	75
Matrica e Rrezikut.....	82
Letra për drejtuesit	83
Pasqyra e Zhvillimit të Dëmeve.....	84
E. TESTET E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM	86

E.1 Hyrje në Testet e Paralajmërimit të Hershëm.....	86
Formulat e Raporteve të Testeve të Paralajmërimit të Hershëm.....	88
Testet e Paralajmërimit të Hershëm (EWT) - Përdorimi në Vlerësimin e Rrezikut	96
Testet e Paralajmërimit të Hershëm – Komentet e Tjera	97
Analiza e Tendencave	97

SHËNIM

TERMAT RREGULLATOR, MBIKËQYRËS, INSPEKTOR, MENAXHIM I LARTË, MENAXHIM OPERACIONAL PËRDORËN GJATE GJITHË KËTIJ DOKUMENTI. KUPTIMET E TYRE JEPEN ME POSHTË:

RREGULLATOR: AUTORITETI PËRGJEGJËS I NGARKUAR ME RREGULLIMIN DHE MBIKËQYRJEN E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT QË MBIKËQYREN, AMF.

MBIKËQYRËS: PERSONELI I RREGULLATORIT QË KRYEN MBIKËQYRJEN E SHOQËRIVE, PERSONAT QË PËRGJIGJEN PËR

- ANALIZËN FINANCIARE,
- SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LICENCA APO MIRATIME TË TJERA QË LIDHEN ME USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT.
- KRYERJEN E INSPEKTIMEVE NË VEND.

INSPEKTOR: PERSONEL I RREGULLATORIT, PËRGJEGJËSIA KRYESORE E TE CILIT ËSHTË KRYERJA E INSPEKTIMEVE NË VEND TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT QË MBIKËQYREN.

MENAXHIM I LARTË: ADMINISTRATORI ANËTAR I KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT NË SISTEMIN ME NJË NIVEL DREJTIMI. ADMINISTRATORI/BORDI I DREJTORËVE NË SISTEMIN ME DY NIVELE DREJTIMI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT.

MENAXHIM OPERACIONAL: FUNKSIONET E KRYERA NGA FUNKSIONARËT KRYESORË.

KËSHILL: SHOQËRITË E SIGURIMIT JANË TË LIRA TË ZGJEDHIN OSE SISTEMIN ME NJË NIVEL DREJTIMI (KU KËSHILLI I ADMINISTRIMIT PËRBËHET NGA ANËTARË ADMINISTRATORË DHE JO ADMINISTRATORË) OSE SISTEMIN ME DY NIVELE DREJTIMI (ME KËSHILL MBIKËQYRËS DHE ADMINISTRATORI/BORDI I DREJTORËVE). NË FUNKSION TË QARTËSISË, DHE PËR TË QENË NË PËRPUTHJE ME TEORINË DHE PRAKTIKËN MË TË MIRË BOTËRORE, KY MANUAL E PËRDOR TERMIN E PËRGJITHSHËM "KËSHILL" ME KUPTIMIN: KËSHILLI I ADMINISTRIMIT (NË SHOQËRITË ME SISTEMIN E DREJTIMIT ME NJË NIVEL) DHE KËSHILLI MBIKËQYRËS (NË SHOQËRITË ME SISTEMIN E DREJTIMIT ME DY NIVELE). NË KËTË ASPEKT, INTERPRETIMET RAST PAS RASTI NË LIDHJE ME KËTË DUHET TË MBËSHTETEN NË DISPOZITAT LIGJORE DHE PRAKTIKAT KONKRETE TË SHOQËRIVE TË VEÇANTA TË SIGURIMIT.

LETRA PËR DREJTUESIT: ËSHTË RAPORTI QË PËRGATITET PËR ÇDO INSPEKTIM SIPAS PARASHIKIMEVE TË NENIT 19 TË LIGJIT NR. 9572, DATË 03.07.2006 "PËR AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE", I NDRYSHUAR.

A. METODOLOGJIA

Hyrje

Objektivat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare janë:

- Mbrojtja e interesave të investitorëve dhe të personave të siguar.
- Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare që mbikëqyren.
- Sigurimi i respektimit të ligjit.


Metodologjia me fokus rrezikun në mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve, synon realizimin më të plotë të këtyre objektivave.

Objektivi i këtij manuali është që të krijojë një pikë referimi të rëndësishme për AMF por nuk synon dhënien e të gjitha zgjidhjeve të gatshme që t’iu përshtatet të gjitha çështjeve të përditshme që do të hasen në mbikëqyrjen e siguruesve në Shqipëri. Më saktë, synohet mbulimi i një gamë të gjerë çështjesh, në detaje të mjaftueshme për të lehtësuar qasjen praktike për çështje të ndryshme dhe të paparashikuara që mund të lindin. Gjatë zbatimit të kësaj metodologjie mbeten në fokus konceptet themelore dhe parimet bazë në mbikëqyrjen e sigurimeve.

Pamje e përgjithshme e mbikëqyrjes me fokus rrezikun

Qëllimi parësor i mbikëqyrjes së sigurimeve është të garantojë që siguruesit të kenë situatë financiare të shëndetshme dhe të jenë në gjendje që t’i përmbushin të gjitha detyrimet e tyre ndaj siguarve dhe pretenduesve për dëmshpërblim (mbikëqyrja e aftësisë pague), si dhe të kujdeset që këto detyrime, të përmbushen në mënyrë të drejtë dhe në kohë (mbikëqyrja e sjelljes së tregut).

Synimi i procesit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun është që të zgjerojë dhe të nxisë identifikimin e rrezikut të pranishëm tek siguruesi dhe ta përdorë këtë vlerësim për formulimin e mbikëqyrjes në vazhdimësi të siguruesit. Procesi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun përfshin konstatimin e rreziqeve të konsiderueshme, vlerësimin dhe analizën e këtyre rreziqeve, dokumentimin e rezultateve të analizës dhe hartimin e rekomandimeve për mënyrën se si mund të zbatohet analiza në monitorimin e vazhdueshëm të siguruesit.



Metodologjia me fokus rrezikun e përqendron përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit financiar të shoqërisë së sigurimit aty ku duhet – tek këshilli dhe menaxhimi i lartë i saj. Është përgjegjësi e shoqërisë së sigurimit të ketë dhe t’i përmbahet politikave dhe praktikave të përshtatshme për administrimin e rrezikut, për të zbutur rreziqet e konsiderueshme që shoqërojnë biznesin.

Koncepti bazë i metodologjisë me fokus rrezikun është të identifikojë fushat me risk më të lartë në aktivitetet e shoqërisë së sigurimit dhe më tej, aty ku është e nevojshme, të punojë me drejtuesit e shoqërisë për të reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme. Objektivi është që të parandalohen në kohë problemet financiare që mund t’i ndodhin një shoqërie sigurimi, në vend që të tentohet rregullimi i tyre pasi të kenë ndodhur.

Një pamje e një kuadri të përgjithshëm për një sistem modern mbikëqyrjeje pasqyrohet në grafikun më poshtë:

Sistemi përfshin tre sisteme të veçanta mbikëqyrjeje. Së pari, mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë, me fokus rrezikun nga AMF. Së dyti, një sistem i orientuar drejt qeverisjes së shoqërisë për kryerjen e mbikëqyrjes së brendshme nga ana e këshillit dhe menaxhimit të lartë të shoqërisë së sigurimeve, që bazohet në përgjegjësitë e përcaktuara qartë në ligj. Kjo përfshin një sistem të mirëpërcaktuar të administrimit të rrezikut të sipërmarrjes në përputhje me praktikën ndërkombëtare të pranuar të fushës. Së treti, një sistem vëzhgimi dhe monitorimi me fokus rrezikun që zbatohet për audituesit e jashtëm dhe aktuarët e autorizuar, gjithmonë në përputhje me termat e ligjit.

Çfarë nënkuptojmë me “Mbikëqyrje me fokus rrezikun”

Mbikëqyrja me fokus rrezikun është një metodë e vlerësimit objektiv të rrezikut, për shembull, duke përdorur raporte financiare të pranuar në nivel ndërkombëtar dhe duke zbatuar nivele vlerësimi për të cilat është rënë dakord për fusha të tilla si efektiviteti i këshillit dhe menaxhimit të lartë. Në fund, mbikëqyrësi do të hartojë një profil rreziku që përfaqëson vlerësimin e tij për secilin nga rreziqet e një shoqërie sigurimi, brenda kontekstit të sektorit të sigurimeve në përgjithësi.

Përveç se është një sistem për vlerësimin e rrezikut, mbikëqyrja me fokus rrezikun përfshin veprime mbikëqyrëse që duhet të ndërmerren për nivele të caktuara të rrezikut, duke rritur masën e ndërhyrjes mbikëqyrëse sipas nivelit të rrezikut.

Metodologjia me fokus rrezikun do të përditësohet në vijimësi, me vendosjen e parimeve më të forta për qeverisjen e shoqërisë, duke përfshirë edhe praktikën e menaxhimit të rrezikut të sipërmarrjes, duke marrë shkas nga rritja e përgjegjësisë së këshillit dhe menaxhimit të lartë, me qëllim garantimin që shoqëria e sigurimeve të funksionojë në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe të biznesit.

Pse me fokus rrezikun: Avantazhet dhe sfidat

Rregullatorët, në mbarë botën, kanë konstatuar se, përjasja me fokus rrezikun për mbikëqyrjen financiare krahasuar me metodologjinë tradicionale, është një bazë më efektive dhe efiçente për të përmbushur objektivat mbikëqyrëse.

Studimet kanë treguar se problemet e shoqërive të dështuara nuk kanë buruar nga mosrespektimi i legjislacionit e kuadrit rregullator, por praktikisht në çdo rast kanë ardhur si rezultat i praktikave të dobëta menaxhuese, mungesës të kontroleve financiare të mjaftueshme dhe mungesës së sistemeve të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut. Sistemi mbikëqyrës kishte nevojë të rishikohej për tu dhënë më tepër përgjegjësi këshillit dhe menaxhimit të lartë të shoqërive të sigurimit, për të forcuar veprimtarinë e tyre në këtë fushë. Gjithashtu sistemi mbikëqyrës do të kishte qenë shumë më tepër efektiv në paralajmërimin në kohë të problemeve që krijoheshin, duke mundësuar ndërhyrjen në kohë dhe efektive, në qoftë se rregullatori do të

kishte qenë më tepër i fokusuar tek rreziqet e aktivitetit të shoqërive se sa tek cilësia e të dhënave të transaksioneve e, në shumë raste, në çështje të vogla të përputhshmërisë me bazën ligjore.

Kur shoqëritë e sigurimit menaxhohen dobët, ato janë të ekspozuara ndaj humbjeve të menjëhershme të paparashikuara, përkeqësimit të treguesve operacional dhe ndaj situatave të trazuara ekonomike, d.m.th., rritet mjaft mundësia e dështimit. Prandaj, duket e arsyeshme që të adoptohet një sistem mbikëqyrës që thekson rëndësinë e menaxhimit institucional dhe praktikave financiare të shëndosha. Kjo është ajo çka synon të arrijë mbikëqyrja me fokus rrezikun.

Avantazhet kryesore të qasjes me fokus rrezikun për mbikëqyrjen mund të përmbledhen si më poshtë:

1. **Shmangia e problemit:** Qasja tradicionale e bazuar tek rregullat, nuk ka qenë shumë efektive. Kjo ka ardhur pjesërisht nga fakti se rregullat tentojnë të jenë statike, dhe kushtet ndryshojnë shpejt në një fushë të tillë si industria financiare. Për pasojë, shumë nga rregullat zbatohen për situatat që nuk janë më koherente apo të rëndësishme. Me njohjen e problemeve të reja, do të hartohen rregulla të reja, por ato gjithashtu do të vjetrohen me kalimin e kohës. Një vështirësi tjetër me qasjen e bazuar tek rregullat është se, mbështetur në rregulla, rregullatori nuk mund të ndërmarrë veprime ndaj një shoqërie derisa kjo e fundit të ketë shkelur një rregull, kohë gjatë së cilës, mund të jetë tepër vonë për të ndërhyrë. Për shembull, mund të ekzistojë një rregull që u ndalon shoqërive të sigurimit të japin hua fondet e tyre palëve të lidhura. Është e qartë se, nëse siguruesi nuk ka shkelur ndonjë rregull, nuk ekziston asnjë problem. Por kur rregulli të jetë shkelur, paratë kanë dalë nga shoqëria dhe mund të mos rikthehen më. Kjo është një situatë shqetësuese për mbikëqyrësit.

Mbikëqyrja me fokus rrezikun kapërcen disa nga dizavantazhet e përqasjes së bazuar tek rregullat, duke njohur rrezikun dhe duke u përpjekur të ndërmarrë masa për reduktimin dhe kontrollin e rrezikut përpara se situata të bëhet kritike. Në qoftë se, veprimi në kohë mund t'i zgjidhë problemet potenciale përpara se të ndodhin faktikisht, situata do të përmirësohet shumë. Ky është një koncept i mirënjohur edhe në shëndetin publik: është më efektive dhe më eficiente që njerëzit të mbahen të shëndetshëm se sa t'i lesh ata të sëmuren dhe pastaj të përpiqesh t'i kurosh.

2. **E ndjeshme ndaj burimeve:** Meqenëse burimet mbikëqyrëse janë gjithmonë të kufizuara, logjika e do që ato të fokusohen tek situatat që kanë rrezikun më të lartë dhe potencialin më të madh për dëmtimin e sistemit financiar. Po të konsiderojmë shembullin e lartpërmendur, në qoftë se politikat dhe praktikat e brendshme të një siguruesi janë të qarta, të krijuara mirë dhe të mbështetura nga funksionarët kryesorë, reduktohet mjaft mundësia që një sigurues t'i japë hua të paligjshme një pale të lidhur.
3. **E strukturuar dhe e vazhdueshme:** Një përqasje me fokus rrezikun mund të hartohet në mënyrë të tillë që të garantojë një përqasje të strukturuar dhe të vazhdueshme për vlerësimin e rrezikut nga ana e mbikëqyrësit. Në çdo institucion mbikëqyrës, është e vështirë të garantohet që punonjësit e shoqërisë të reagojnë në të njëjtën mënyrë ndaj të njëjtave

rrethana. Individët mund ta interpretojnë atë që shikojnë në mënyra të ndryshme, dhe reagimet e tyre përkatëse mund të ndryshojnë. Megjithatë, metodologjitë me fokus rrezikun ofrojnë qëndrueshmëri në rritje për vlerësimin e rrezikut dhe për marrjen e vendimeve nëpërmjet përdorimit të treguesve për matjen e rrezikut për të cilat është rënë dakord më parë. Shumë prej tyre mund të maten mjaft saktësisht, dhe mund tu caktohen koeficientë ponderimi në mënyrë që e gjithë metodologjia të ketë sa më pak mundësi interpretimi subjektiv nga individët e përfshirë. Këta janë të njëjtët faktorë që motivojnë agjencitë profesionale të vlerësimit të tilla si Standard & Poor's and Best's që të ndjekin në mënyrë rigoroze kriteret e përcaktuara të vlerësimit si gurë themeli të punës së tyre.

4. **Sfiduese për personelin mbikëqyrës:** Krahësim me përqasjen e bazuar tek rregullat, përqasja me fokus rrezikun kërkon që mbikëqyrësi t'i diskutojë me funksionarët kryesorë të shoqërisë së sigurimit operacionet e biznesit dhe planet e ardhshme, meqenëse këta janë personat, vendimet e të cilëve do të ndikojnë në rezultatin e ardhshëm të kësaj shoqërie. Mund të bëjmë një krahasim midis punës së një mbikëqyrësi dhe asaj të një menaxheri investimi. Menaxherët e investimit kanë pranuar prej kohësh se një nga detyrat e tyre më të rëndësishme është gjetja e shoqërive që kanë gjasa të performojnë më mirë se tregu me kalimin e kohës. Detyra e mbikëqyrësit financiar është kryesisht e ngjashme. Por sfida qëndron në identifikimin e shoqërive që kanë gjasa të *performojnë më dobët* në treg me kalimin e kohës. Duke pasur parasysh këtë ngjashmëri, nuk është e çuditshme se të dy kanë konstatuar se mënyra më efektive për të proceduar është vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve në mënyrë të vazhdueshme, me theks të veçantë tek takimet me drejtuesit e shoqërive, duke krahasuar raportet financiare, duke kryer analiza të tjera financiare dhe duke i mbajtur në monitorim të vazhdueshëm. Sipas termave të mbikëqyrjes financiare, i referohemi përkatësisht inspektimeve në vend, analizës financiare dhe sinjaleve apo informacioneve në lidhje me tregun.

Në mbikëqyrjen me fokus rrezikun, inspektimet në vend marrin një rëndësi më të madhe se sa në mbikëqyrjen tradicionale. Kjo ndodh sepse shumë nga informacionet e kërkuara nga mbikëqyrësi për të vlerësuar rrezikun janë të njëjta ose të ngjashme me informacionet që nevojiten nga drejtuesit e shoqërisë për të ngritur dhe zbatuar strategji biznesi. Mbikëqyrësi përpiqet të vlerësojë besueshmërinë e planit të biznesit dhe rreziqet e ndryshme që mund ta pengojnë realizimin e këtij plani. Parë nga një këndvështrim tjetër, duhet të marrim në konsideratë mundësitë që identifikohen nga shoqëria e sigurimit, të vlerësojmë besueshmërinë e tyre, në disa raste me anë të testeve të veçanta, dhe të vlerësojmë rreziqet përpara se ato të ndodhin.

5. **Transparente:** Struktura, qëndrueshmëria dhe objektiviteti rrisin transparencën sepse bëhet fjalë për një sistem formal që mund të dokumentohet dhe të shpjegohet. Ky është një përfitim pasi kuptohet qartë funksionimi i sistemit dhe rekomandimet do të jenë të paanshme dhe të bazuara në fakte. Meqenëse sistemi përfshin edhe shembuj të veprimeve tipike mbikëqyrëse që ndërmerren me rritjen e niveleve të rrezikut, ka një siguri më të lartë në nivele të larta të vendimmarrjes me veprimet e propozuara mbikëqyrëse, të cilat do të shoqëronin nivele të ndryshme të rrezikut.

Edhe pjesëtarëve të industrisë i jepet informacion në lidhje me mënyrën si matet rreziku në mënyrë që ata të kuptojnë implikimet e rrezikut ndaj veprimeve të ndryshme që mund të ndërmarrin ose mund të mendojnë t'i ndërmarrin. Kur ta kuptojnë se disa veprime do të interpretohen se çojnë në risk më të lartë, bashkë me të gjitha implikimet mbikëqyrëse që kjo mund të përfshijë, ata duhet të fillojnë të mendojnë për alternativat për risk më të ulët për të arritur objektivat e tyre të dëshiruara.

Pavarësisht avantazheve të diskutuara më sipër, ka edhe disa sfida:

1. **Aftësi të ndryshme të mbikëqyrësit:** Për të qenë mbikëqyrës efektivë me fokus rrezikun, stafi mbikëqyrës duhet të kuptojë në mënyrë të shkëlqyer konceptet financiare, të ketë njohuri të thella për operacionet e siguruesit, të kuptojë shumë mirë rreziqet e biznesit dhe sigurimit, dhe në të njëjtën kohë, të jetë në gjendje t'i diskutojë të gjitha këto çështje me dituri dhe në mënyrë të respektueshme me anëtarët e Këshillit dhe menaxhimit të lartë të shoqërive të mbikëqyrura. Kjo është shumë më komplekse dhe kërkuese se sa thjeshtë përcaktimi nëse një transaksion është në përputhje ose jo me Ligjin e Sigurimit. Trajnimi i vazhdueshëm është pjesë thelbësore e kryerjes së tranzicionit nga mbikëqyrja tradicionale tek ajo me fokus rrezikun.
2. **Nevoja e mbikëqyrësit për tu përshtatur me ndryshimin:** Lidhur me sa më sipër, ndërsa *koncepti* i mbikëqyrjes me fokus rrezikun është relativisht i thjeshtë për tu shprehur, ai është më i vështirë për tu vënë në praktikë. Vlerësimi i rrezikut të biznesit kërkon një fokus të ndryshëm nga ai që në përgjithësi lidhet me mbikëqyrjen financiare tradicionale. Në rastin e fundit, përcaktimi i përputhshmërisë është çështje e drejtpërdrejtë: transaksioni ose aktiviteti në fjalë ose i zbaton rregullat e shkruara ose nuk i zbaton. Megjithatë, dhënia e gjykimit në lidhje me nivelin e rrezikut për një aktivitet ose politikë të caktuar dhe masa deri në të cilën shoqëria mund ta zbutë rrezikun efektivisht, kërkon aftësi më të mëdha nga ana e mbikëqyrësit për të bërë vlerësime që janë të informuara mirë. Këto gjykime janë të ngjashme me ato që duhen bërë nga funksionarët kryesorë të shoqërisë së sigurimit.

Në qasjen me fokus rrezikun duhet një ndryshim në perspektivë, që mbikëqyrësit ta kthejnë vëmendjen e tyre, tek nivelet e larta të drejtimit të shoqërisë, ku formulohen politikat dhe merren vendimet. Cilësia e menaxhimit të shoqërisë së sigurimit, planet dhe strategjitë e saj të biznesit, konceptet për zhvillimin e produktit të ri dhe marketingu, besueshmëria në sistemet e kontrollit dhe administrimit të rrezikut, janë të gjitha fusha që duhet të vlerësohen sepse janë themelore për vlerësimin e perspektivave të ardhshme dhe suksesit të shoqërisë së sigurimit. Prandaj, një çështje praktike lidhur me mbikëqyrjen me fokus rrezikun është kryerja e tranzicionit nga një mjedis relativisht i sigurt që përdor interpretime të përcaktuara të ligjeve dhe rregulloreve, tek një mjedis në të cilin një rol kyç luajnë kuptimi i praktikave financiare dhe të biznesit dhe teknikat e zbutjes së rrezikut. Aftësi për tu përshtatur me ndryshimin përbën një sfidë.
3. **Shkalla e Gatishmërisë së Industrisë:** Gjendja e industrisë ndonjëherë mund të çojë në lindjen e problemeve për një program mbikëqyrjeje me fokus rrezikun. Aty ku siguruesit kanë sisteme efektive të administrimit të rrezikut dhe menaxherët janë mësuar të mendojnë me fokus rrezikun, mbikëqyrja me fokus rrezikun do të jetë një përshtatje natyrale, në një


farë kuptimi do të ofrojë një qasje të harmonizuar midis sistemeve të brendshme (shoqëria e sigurimit) dhe të jashtme (rregullatori) të administrimit të rrezikut.

Cikli i Mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun

Procesi mbikëqyrës është një cikël:

- Mbledhja dhe analiza në mënyrë të vazhdueshme e dokumenteve financiare, raporteve nga audituesit dhe aktuarët, informacioneve nga tregu dhe të dhënave të tjera;
- Rishikimi i profileve të rrezikut të shoqërive të sigurimeve me rezultatet e kësaj analize;
- Planifikimi dhe kryerja e inspektimeve në vend duke përdorur profilet e rrezikut të njohura; dhe
- Rishikimi i mëtejshëm i profilin të rrezikut të shoqërive të sigurimit duke përdorur informacionin e marrë në inspektimet në vend.

Cikli pasqyrohet në grafikun më poshtë.



Cikli mbikëqyrës me fokus rrezikun

Mbikëqyrja me fokus rrezikun synon të ofrojë rregullim të vazhdueshëm. Qasja me fokus rrezikun kërkon përpjekje plotësisht të koordinuara midis funksionit të inspektimit në vend dhe funksionit të analizës financiare. Duhet të ketë shkëmbim të vazhdueshëm informacioni midis funksionit të inspektimit në vend dhe funksionit të analizës financiare për të siguruar që i gjithë stafi mbikëqyrës të informohet siç duhet për çështjet që lidhen me siguruesit.

Përgjegjësitë e analistëve në kuadrin e mbikëqyrjes financiare me fokus rrezikun janë:

1. Të monitorojnë siguruesit;
2. Të bëjnë përditësime për përmbledhjen e profilit të siguruesit;
3. Të sigurojnë të dhëna për prioritetet që duhet të ketë departamenti i mbikëqyrjes për çdo sigurues;
4. T'u ofrojnë drejtuesve të departamentit të mbikëqyrjes informacion në kohë për ngjarje të rëndësishme që lidhen me siguruesit.

Ky informacion përdoret nga funksioni i inspektimit në vend si kontribut për të programuar dhe për të caktuar stafin e inspektimeve. Përpara një inspektimi në vend, inspektorët dhe analistët duhet të kryejnë një mbledhje planifikuese për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit përkatës midis analistëve dhe ekipit të inspektimit. Duke kryer inspektimet në vend, inspektorët duhet të informojnë analistin për çdo konstatim të rëndësishëm të inspektimit. Në përfundim të inspektimit në vend, inspektorët dhe analistët do të punojnë së bashku për të përcaktuar prioritetet për shoqërinë. Hartimi i [letrës për drejtuesit](#) e shoqërisë duhet të përfshijë kontribut si nga inspektorët ashtu edhe nga analistët.

Pasi të ketë filluar procesi i mbikëqyrjes me fokus rrezikun, çdo informacion i dhënë në profilin e rrezikut të siguruesit mund të ndryshohet në çdo kohë për të pasqyruar ndryshimet e situatës financiare dhe operationale të siguruesit. Në çdo kohë, informacioni që mund të ndikojë në profilin e rrezikut të siguruesit mund të vihet në dispozicion nga burime të tilla si tregu, shqyrtimi i pasqyrave financiare ose edhe nga inspektimi në vend i ndonjë shoqërie tjetër sigurimi.

Deri në krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm, prioritetet për inspektimin në vend fillimisht mund të përcaktohen duke përdorur rezultatet e raporteve të tilla si raportet e paralajmërimit të hershëm (Early Warning Tests), por kjo duhet të pasurohet dhe me njohuritë e shoqërisë dhe aplikimit të gjykit të shëndoshë dhe të informuar. Meqenëse një sistem i vetëm prioritetesh nuk përfaqëson një mekanizëm të plotë për vendosjen e prioriteteve, analistët inkurajohen të përdorin mjete të brendshme të ndryshme dhe të kryejnë analiza të mëtejshme për të vendosur për prioritetet e shoqërisë. Për të përcaktuar treguesin e përgjithshëm të prioritetit (ang. overall priority score), inspektori dhe analisti duhet të marrin në konsideratë faktorë të tillë si rezultatet e vlerësimit të rrezikut, ndryshimet e brendshme/të jashtme si dhe aftësinë për të ndërmarrë rrezik apo dhe efektivitetin e drejtuesve të shoqërisë.

A. 1. FAZA I: Mbledhja e Informacionit dhe Analiza Paraprake

HAPI 1: Mbledhja e Informacionit

Krijimi i një perceptimi për siguruesin dhe rreziqet specifike të tij, si dhe krijimi ose përditësimi i [profilit përmbledhës të siguruesit](#) janë kritike për procesin e mbikëqyrjes me fokus rrezikun dhe lehtësojnë mbikëqyrjen në vijimësi. Profili përmbledhës i siguruesit duhet të përpilohet për çdo sigurues dhe të përditësohet sipas nevojave gjatë gjithë vitit, duhet të jetë i përmbledhur dhe të përmbajë informacionin e marrë nga cikli mbikëqyrës me fokus rrezikun.

Në përgjithësi, profili përmbledhës i siguruesit duhet të përfshijë:

- Informacion të përgjithshëm për siguruesin, si emri, adresa dhe lloji i biznesit;
- Një përmbledhje të shkurtër të veprimtarisë së shoqërisë;
- Disa informacione për aftësinë paguese, renditjen e problematikave sipas prioriteteve të AMF-së, etj;
- Konstatime të rregullatorit, nga shqyrtimi i fundit, bazuar tek analiza dhe inspektimi financiar, letra për drejtuesit, dërguar shoqërisë dhe ndonjë vendim i AMF-së për shoqërinë;
- Planin e mbikëqyrjes që përmban: shpeshhtësinë e inspektimit, problematikën e shoqërisë, etj;
- Të dhënat më të rëndësishme financiare duke përfshirë pikat e forta dhe pikat e dobëta;
- Një përmbledhje të shkurtër në mënyrë që të jepet një përmbledhje e shkurtër e gjendjes financiare dhe operacionale të shoqërisë, bazuar mbi të gjithë informacionet e mëparshme.

[Pyetësori i planifikimit të inspektimit](#) është përfshirë në ilustrimin 2 për të ndihmuar mbikëqyrësit në mbledhjen e informacionit të nevojshëm të planifikimit.

Ndërsa proceset e administrimit të rrezikut ndryshojnë nga një sigurues tek tjetri, ka pesë elementë bazë që kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për menaxhimin e rrezikut:

1. Këshill aktiv dhe mbikëqyrje nga menaxhimi i lartë;
2. Procese të përshtatshme të administrimit të rrezikut, monitorimit dhe menaxhimit;
3. Politika, procedura dhe kufij autorizimi të pranimi të rrezikut, të përshtatshëm dhe të qartë;
4. Kontrolle të brendshme gjithëpërfshirëse dhe efektive; dhe
5. Procese që sigurojnë përputhshmëri me ligjet dhe rregulloret.

Pavarësisht nga kompleksiteti i një kompanie, disa aspekte janë të rëndësishme për krijimin e mjedisit të kontrollit të rrezikut, që lehtëson mbikëqyrjen efektive të rreziqeve të pranishëm të veprimtarisë së shoqërisë. Ato përfshijnë:

- Proceset që monitorojnë saktë dhe në kohë përputhshmërinë me politikat e brendshme dhe kufijtë;

- Mbikëqyrjen efektive të drejtuesve dhe kontrollet e brendshme të veprimtarisë së përditshme të biznesit, duke përfshirë mekanizmat e brendshme të qëndrueshëm dhe efektivë të komunikimit dhe linjat e duhura të raportimit;
- Pavarësia e mjaftueshme ndërmjet funksioneve të kontrollit dhe të linjës së biznesit, në mënyrë që të sigurohet ndarja e saktë e detyrave dhe shmangja e konflikteve të interesit; dhe
- Një funksion efektiv i auditit të brendshëm (ose një program efektiv i auditit të jashtëm për veprimtarinë) që identifikon dhe vlerëson tërësisht fushat kyçe të rrezikut.

Mbikëqyrësi duhet të identifikojë fushat e raportimit financiar dhe operacional që do të kërkojnë vëmendje gjatë inspektimit. Burimet e informacionit që e mbështesin këtë perceptim janë:

- raportet e AMF-së dhe të rregullatorëve të tjerë;
- burimet publike;
- burimet e shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë intervistat me menaxhimin e lartë të shoqërisë, këshillin;
- intervistat me audituesin e jashtëm dhe raportet e dërguara duke përfshirë letrën për drejtuesit;
- burime të tjera.

Shembuj të llojeve të përgjithshme të informacionit që mund të mblidhet ose rishikohet janë:

Struktura e Shoqërisë së Sigurimit

- Përshkrimi i strukturës organizative, duke përfshirë edhe çdo ndryshim strukturor që prej rishikimit të mëparshëm;
- Strategjitë e biznesit, sfidat konkurruese, linjat kyçe të biznesit, produktet dhe kombinimet e tyre, thelbi i marketingut, fushat e rritjes, planet e blerjes ose shitjes së degëve dhe produkteve të reja ose kanalet e shpërndarjes të paraqitura që prej inspektimit të mëparshëm;
- Diagrama e organizimit të shoqërisë (njësive ligjore/të biznesit) dhe diagrama e organizimit të departamenteve që tregojnë aktivitetet kyçe të biznesit dhe drejtuesit përgjegjës për to;
- Përshkrimi i marrëdhënieve të shoqërisë me degët ose shoqëritë e kontrolluara;
- Kontratat e drejtuesve dhe programet inkurajuese; dhe

Informacion për Qeverisjen e Shoqërisë

- Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit dhe komitetit të auditit; dhe
- Një listë e komiteteve të rëndësishme të menaxhimit dhe operacionale, anëtarëve të tyre dhe shpeshhtësinë e takimeve.

Mbikëqyrësit duhet t'i referohen ilustrimit 3 si udhëzim për të kuptuar strukturat qeverisëse të shoqërisë.

Informacion për Administrimin e Rrezikut

- Raportet më të fundit të audituesit të jashtëm dhe të brendshëm dhe reagimet me shkrim të drejtuesve;
- Përmbledhje e profilit të përgjithshëm të rrezikut të shoqërisë, duke përfshirë fusha të rëndësishme që përbëjnë shqetësim për rregullatorin; dhe
Shqyrtimi i [profilit përmbledhës të siguruesit](#) mund t'i ofrojë mbikëqyrësit këtë informacion;
- Vlerësimi i pranisë dhe efektivitetit të masave të kontrollit të brendshëm në të gjitha linjat kryesore të biznesit, dhe krahasimin e rezultateve financiare të vitit në vazhdim e të vitit të mëparshëm me planin.
Kjo mund të përfshinte vlerësimet e bëra nga shoqëria, të tilla si raportet e auditit të brendshëm ose nga mbikëqyrësi si rezultat i inspektimeve të një viti më parë.

Pasqyrat Financiare të Brendshme dhe Informacioni për Aftësinë Paguese

- Raportet për Aksionarët/Vjetore;
- Analizat e shoqërisë për gjendjen dhe tendencat financiare; dhe
- Ngjarje që kanë ndikuar tek siguruesi që prej inspektimit të mëparshëm.

Pasqyrat Financiare të audituara dhe Informacioni për Aftësinë Paguese

- Raporti me opinionin e audituesit të jashtëm për pasqyrat financiare dhe letra për drejtuesit;
- Opinioni aktuarial i pavarur për vitet që rishikohen; dhe
- Raporti aktuarial i pavarur për provigjonet e dëmeve, nëse ka;

Informacion Rregullator

- Raportet e analistit financiar për gjendjen financiare dhe rezultatet operationale të shoqërisë që prej raportit të fundit të analizës financiare të përditësuar, që përfshijnë profilin përmbledhës të siguruesit, nivelin e prioritetit, konkluzionet e përgjithshme të analizës financiare;
- Vlerësimi aktual i nivelit të prioritetit dhe çështjet e evidentuara nga AMF;
- Përmbledhje e dokumenteve të mbikëqyrjes që prej inspektimit të mëparshëm, duke përfshirë dhe trajtimin e konsumatorëve dhe/ose inspektimet me objekt të kufizuar;
- Pasqyrat financiare për vitet që shqyrtohen;
- Gjetjet e mëparshme të inspektimit dhe dokumentet mbështetëse të punës;
- Dosjet e korrespondencës së AMF-së;
- Statuti, aktet nënligjore dhe amendimet;
- Marrëveshjet ose kontratat e miratuara kohët e fundit, p.sh., marrëveshje për ndarjen e shpenzimeve, kontrata risigurimi, marrëveshje kujdestarie; dhe
- Informacion nga rregullatorë të tjerë.

Teknologjia e Informacionit (TI)

- Merr ose përgatit një pamje të përgjithshme të sistemit;
- Standardet dhe procedurat e TI për:
 - o Zhvillimin e sistemit;
 - o Administrimin e rrjetit;
 - o Sigurinë e informacionit;
- Metodologjia e zhvillimit të sistemit;
- Raportimi i incidenteve të sigurisë, procesi i monitorimit dhe ndjekjes;
- Politika e sigurisë fizike;
- Listimi i shërbimeve të marra nga të tretë apo marrëveshjeve për përpunim;
- Kontrata/ marrëveshje me shitësin duke përfshirë çdo shtesë:
 - o Planet për rikthimin pas katastrofave (ang. Disaster recovery plans);
 - o Rezultatet e testimit të rikthimit pas katastrofave (ang. Disaster recovery testing results);
 - o Planet e rifillimit të biznesit (ang. Business resumption plans); dhe
 - o Rezultatet e testimit të rifillimit të biznesit (ang. Business resumption testing results).

Shqyrtohen gjetjet nga inspektimet e mëparshme, letra për drejtuesit (nëse ka) dhe dokumentet e punës që lidhen me shqyrtimet e sistemeve të informacionit. Shqyrtohet puna e kryer nga audituesit e brendshëm dhe të jashtëm të shoqërisë lidhur me rishikimet e sistemeve të informacionit.

Përshkrimi i Kontrolleve nga Shoqëria

Përshkrimi i kontrolleve nga shoqëria është përgjegjësi e vetë shoqërisë. Në shumë raste, audituesi do të ndihmojë shoqërinë që të përgatitë përshkrimet. Përshkrimi i kontrolleve në përgjithësi duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- Aspekte të mjedisit të kontrollit të shoqërisë; Procesin e vlerësimit të rrezikut; Procesin e informacionit dhe komunikimit; dhe proceset e monitorimit;
- Objektivat e kontrollit dhe kontrollet që kanë lidhje me to; dhe
- Kontrolle plotësuese që mund të kërkohen.

Shumica e pikave të mësipërme paraqiten në formë përshkruese shoqëruar me diagrama ose organigrama për të ilustruar aktivitetet e kontrollit. Organizata mund të paraqesë edhe informacion për shërbimet që kryen dhe mjedisin e përpunimit që ka.

HAPI 2: Shqyrtimi i Informacionit të Mbledhur dhe Analiza Financiare

Hapi 2 Fokuset tek përpunimi dhe analiza e informacionit të mbledhur sipas hapit 1, me theks të veçantë tek pika 3 më poshtë – analiza financiare dhe aktuariale. Ekipi i mbikëqyrjes duhet të njihet me aspektet unike të operacioneve/produkteve të shoqërisë, kontrollet/strategjitë e administrimit të rrezikut si dhe projektet dhe qëllimet e ardhshme të biznesit. Hapat fillestarë në

procesin e planifikimit përfshijnë shqyrtimin e dokumenteve të mëposhtme për të marrë një pamje të përgjithshme të situatës së shoqërisë tek rregullatori (AMF) dhe për të identifikuar fushat ekzistuese të fokusit rregullator:

1. **Profili përmbledhës i siguresit** – Profili përmbledhës i siguresit është një përmbledhje ekzekutive e gjendjes financiare të siguresit, profilit të rrezikut, veprimt/planeve rregullatore dhe çështje të tjera të rëndësishme. Format i profilit do të jetë një strukturë e qëndrueshme që paraqet gjendjen e një siguresi ose një grup siguresish nga pikëpamja rregullatore në çdo kohë.
2. **Korrespondenca e përgjithshme dhe skedarë të tjerë** – Shqyrtimi i ngjarjeve të rëndësishme të periudhës aktuale që mund të kenë një ndikim në vlerësimin e punës krahasuese të periudhës së mëparshme, bilancet e llogarisë ose operacionet e ardhshme.
3. **Analiza financiare dhe aktuariale** – Rishikimi i tendencave të rëndësishme, raporteve kryesore të aftësisë paguese, duke përfshirë rezultatet e testeve të paralajmërimit të hershëm, rezultatet financiare që nga data e inspektimit të fundit, raportimet e shoqërisë mëmë, analizën aktuariale, etj. Në qoftë se ka rezultate ose tendenca të pazakonta të aftësisë paguese, mbikëqyrësi mund të dojë t'i diskutojë rezultatet analitike, përfshi çdo korrespondencë me shoqërinë për ndjekje, me analistin financiar përpara mbledhjes fillestare planifikuese me shoqërinë. Në rishikimin e testeve të paralajmërimit të hershëm, mbikëqyrësi duhet të fokusohet për të kuptuar se nga janë shkaktuar devijimet, jo thjesht në faktin që disa raporte janë jashtë normave. Për siguresit e Jojetës, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mjaftueshmërisë së provigjoneve të dëmeve si dhe mbështetjes së shoqërisë tek programi i saj i risigurimit dhe cilësisë së tij.
4. **Raportet e periudhës së mëparshme** – Duhet të kryhet një rishikim i shkurtër për të kuptuar në përgjithësi punën e kryer në periudhat e mëparshme, objektin e përgjithshëm të punës, fushat e perceptuara me risk dhe gjetjet specifike. Rishikimi duhet të fokusohet tek tendencat kyçe të aftësisë paguese dhe rezultatet e hapave të mëparshëm.
5. **Projektimet financiare** – Mbikëqyrësit duhet të marrin dhe të shqyrtojnë projektimet dhe planet e dokumentuara të biznesit të shoqërisë, kur disponohen, në mënyrë që të identifikojnë nëse janë planifikuar rishikime të rëndësishme në lidhje me veprimtarinë e siguresit (zgjerimi i gamës së produkteve, përfaqësimi gjeografik, etj). Ky shqyrtim do ta ndihmojë mbikëqyrësin të identifikojë rreziqet e ardhshme operacionale dhe të raportimit financiar në mënyrë që analizimi i mëtejshëm të mund të plotësohet gjatë gjithë procesit të inspektimit.

Planet e Biznesit

Planet e biznesit janë një nga mjetet më të dobishme mbikëqyrëse. Plani i biznesit duhet të jetë një përmbledhje e shkurtër nga ana e funksionarëve kryesorë për vizionin e shoqërisë dhe hapat që do të përdoren për ta realizuar këtë vizion. Ky është një rast për mbikëqyrësin që të vlerësojnë se sa realiste janë qëllimet e shoqërisë dhe sa e mundshme duket se do të jetë strategjia e deklaruar.

Plani i biznesit do t'i krijojë mbikëqyrësit mundësinë që të mendojë për rreziqet që mund të shfaqen gjatë ekzekutimit të planit. Për shembull, plani i biznesit që parashikon rritje të shpejtë, shtrirjen e biznesit në juridiksione të reja apo zhvillimin dhe marketingun e produkteve të reja, duhet të ndiqet nga afër në nivel mbikëqyrës sepse të gjithë këto aktivitete kanë potencial të lartë rreziku.

Pasqyrat financiare të projektuara (ang. pro forma) duhet të përgatiten në përputhje me standardet raportuese financiare që ndiqen në Shqipëri. Supozimet që janë përdorur në to duhet të jenë të shprehura qartazi dhe informacioni duhet të paraqitet sipas linjave kryesore të biznesit, i ngjashëm me formatin e raportimit financiar pranë Rregullatorit.

Parashikimet duhet të përfaqësojnë vlerësimet më të mira të menaxhimit në lidhje me pasojat financiare të strategjisë që synohet të ndiqet. Normalisht mbikëqyrësi do të dojë të monitorojë performancën financiare faktike me planin. Duhet të ndiqen devijimet e mëdha. Shoqëria duhet të jetë në gjendje që të shpjegojë devijimet dhe duhet ta përditësojë planin e biznesit në mënyrë të vazhdueshme që ai të pasqyrojë pozicionin aktual të shoqërisë. Planet e përditësuara duhet të depozitohen tek rregullatori.

Gjatë shqyrtimit të planit të biznesit, më poshtë jepen disa nga fushat kryesore për tu patur në konsideratë nga mbikëqyrësi dhe për tu diskutuar më tej me shoqërinë:

- Aksesit ndaj kapitalit që kërkohet për të mbështetur planin;
- Kapaciteti i menaxhimit për të zbatuar planin, duke konsideruar veprimtarinë e deritanishme dhe historikun e zhvillimit të shoqërisë;
- Zbatueshmëria e planit në tërësi, duke pasur parasysh natyrën e propozimeve të bëra, mjedisin konkurrues në industri dhe gjendjen e përgjithshme të ekonomisë në vend; dhe
- Detajet se si do të realizohet plani. Mbikëqyrësi duhet të bëjë të gjitha pyetjet e nevojshme për të kuptuar plotësisht planin dhe për të trajtuar çështje të veçanta që mund të lindin.

Raportet e Auditimit të jashtëm

Raportet e audituesit të jashtëm duhet të shqyrtohen si pjesë e vlerësimit të rrezikut nga mbikëqyrësi. Stafi mbikëqyrës mund të jenë njohur me pasqyrat financiare të audituara, por nga pikëpamja e vlerësimit të rrezikut, pikat kyçe për tu konsideruar përmbledhen si më poshtë:

- A ka kualifikime në raportin e auditimit? Një kualifikim nuk bëhet asnjëherë lehtë, dhe nëse raporti përmban një të tillë, çështja është tepër e rëndësishme. Në këtë rast duhet të ndiqet me urgjencë nga mbikëqyrësi me synim kuptimin e rëndësisë së çështjes dhe efektet e mundshme në vlerësimin e rrezikut. Ndjekja mund të përfshijë dhe investigim të mëtejshëm me shoqërinë dhe auditin e jashtëm.
- Shënimet në pasqyrat financiare të audituara janë shënimet e drejtuesve të shoqërisë, por meqenëse ato janë pjesë e pasqyrave financiare të audituara, audituesi i jashtëm duhet të ketë rënë dakord për to. Një mosmarrëveshje serioze midis drejtuesve të shoqërisë dhe audituesit të jashtëm për shënimet mund të çojë në dhënien e kualifikimit, ose madje në mohim të opinionit nga audituesi. Mbikëqyrësit duhet të kenë kujdes për shënimet që nuk duken 'të

drejta'. Audituesit ndonjëherë bien dakord për çështje, që normalisht nuk duhet të bien dakord dhe, kur kjo ndodh, zakonisht e mbrojnë veten nëpërmjet publikimit në raport të çështjes. Në mënyrë tipike, në rastin e një pike të debatueshme, audituesi do të dojë që të përfshihet në shënimet e pasqyrave financiare ndonjë referim për çështjen në fjalë. Shënimet duhet të lexohen me kujdes, meqenëse ato mund të përmbajnë referime për ngjarjet e rëndësishme të shoqërisë ose trajtimet e pazakonta kontabël.

Përveç shqyrtimit të raporteve të auditimit, është i vlefshëm edhe akses i AMF-së në skedarët e punës së audituesve pa rënë ndesh me dispozitat ligjore në fuqi. Këshillohet si praktikë më e mirë takimi me audituesin e jashtëm dhe shqyrtimi i skedarëve të tij të punës, përpara fillimit të inspektimit në vend. Objektivat parësore janë:

- të theksohen fushat me risk të përcaktuar në mënyrë reciproke ku mbikëqyrësit mund të përdorin punën e audituesve për të shmangur punën e dyfishtë;
- të identifikohen shqetësimet materiale që janë identifikuar nga audituesit gjatë punës së tyre;
- të përdoren dokumentet e punës së audituesve si burim informacioni shtesë për formulimin e profilit të rrezikut të shoqërisë; dhe
- të merren vëzhgimet e audituesve për çështje të tilla si pikat e forta dhe pikat e dobëta të mjedisit të kontrollit të brendshëm, sistemet dhe drejtimi i përgjithshëm si dhe efektiviteti i departamentit të auditit të brendshëm.

Kryerja e një rishikimi analitik përfshin studimin dhe krahasimin e varësive ndërmjet të dhënave në një pikë të caktuar në kohë dhe tendencave të këtyre varësive në periudha të caktuara kohore. Bazuar në të kuptuarit e biznesit të shoqërisë, mbikëqyrësi zhvillon disa pritshmëri në lidhje me marrëdhënie të rëndësishme financiare dhe operacionale. Rezultatet nga rishikimi analitik, të cilat mbështesin këto pritshmëri rrisin nivelin e besimit dhe mund të sjellin rritje të efikasitetit të analizimit duke ndryshuar natyrën e testeve ose duke reduktuar volumin e procedurave të tjera. Në rast të kundërt, rezultatet nga rishikimi analitik, që ndryshojnë nga pritshmëritë duhet të rrisin nivelin e skepticizmit dhe mund të kërkojnë procedura shtesë për të shpjeguar devijimet e mëdha nga pritshmëritë. Në ilustrimin 4 jepen më tepër udhëzime në lidhje me [procedurat e rishikimit analitik](#).

Përveç vlerësimit të ndikimit të faktorëve të kudogjendur dhe kryerjes së analizave, mbikëqyrësit duhet të mbajnë diskutime me menaxhimin e shoqërisë për të kuptuar më mirë çështjet si më poshtë:

- a) ngjarjet aktuale të rëndësishme – Duhet të identifikohen dhe të trajtohen zhvillimet e rëndësishme, si një blerje e re, ndryshimi i funksionarëve kryesorë, çështjet gjyqësore ose çështje të tjera që mund të ndikojnë në aftësinë paguese të shoqërisë;
- b) kushtet dhe çështjet e shoqërisë – Ekipi i mbikëqyrjes duhet të kuptojë strukturën dhe mënyrën se si e kryen biznesin shoqëria për të vlerësuar në mënyrë të drejtë aftësinë e saj paguese. Duhet të konsiderohen çështje të tilla si më poshtë:
 - i. Struktura organizative e subjektit
 - ii. Tregjet kryesore dhe linjat e produkteve
 - iii. Konkurrentët kryesorë

- iv. Faktorët kyç të rrezikut të aftësisë paguese, p.sh., mbajtja e shumave të mëdha të obligacioneve me klasifikim të ulët dhe/ose pasurive të paluajtshme me probleme.
- c) kushtet e industrisë që mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e shoqërisë për të disponuar aftësi paguese në të ardhmen. Këto kushte mund të përfshijnë fushat e mëposhtme:
 - i. Tendencat ekonomike e të biznesit
 - ii. Mjedisin konkurrues
 - iii. Ndryshimet rregullatore
- d) veprimtaria e shoqërisë sipas linjave ose llogarive kryesore të klientëve.

HAPI 3: Gjetjet kryesore dhe përditësimi i Profilit Përmbledhës të Siguruesit

Bazuar në shqyrtimin dhe analizën e kryer deri në këtë pikë, mbikëqyrësi duhet të përditësojë profilin përmbledhës të siguruesit për ndonjë konstatim fillestar të rëndësishëm. Profili përmbledhës i siguruesit mund të përditësohet më tej gjatë gjithë procesit të inspektimit.

A. 2. FAZA II: Planifikimi i inspektimit

A. 2.1 Dokumenti i Planifikimit të Inspektimit.

Dokumenti i planifikimit të inspektimit përgatitet para inspektimit dhe është tepër i rëndësishëm pasi:

- krijon kuadrin për të gjithë punën që do të vijë më pas;
- së bashku me 'Shkallën e Ndërhyrjes', përditëson profilin e rrezikut të shoqërisë dhe përqendron burimet e inspektimit bazuar në risk, ku fushat me risk më të lartë marrin më tepër vëmendje se ato me risk më të ulët; dhe
- përcakton detyrat për punën e secilit inspektor.

Në qoftë se dokumenti i planifikimit të inspektimit hartohet jo mirë ose është jo i plotë, ai ndikon negativisht në efektivitetin e të gjithë procesit të inspektimit.

A.2.2 Kërkesat e para-inspektimit dhe koha kur kryhet inspektimi

Është e rëndësishme për efektivitetin dhe efikasitetin e procesit të inspektimit që të kontaktohet shoqëria paraprakisht, në mënyrë që personeli menaxherial të jetë gati për ndonjë kërkesë specifike për informacion që kërkon kohë për tu përgatitur. Në qoftë se nuk bëhet kjo, humbet kohë e vlefshme meqenëse inspektorët mund të presin në terren që punonjësit të gjenerojnë raporte specifike që inspektorët duan t'i rishikojnë. Duhet pasur parasysh se drejtuesit e shoqërive kanë shumë kërkesa në periudha të caktuara dhe ata do ta çmonin shumë në qoftë se njoftohen në kohën e duhur për informacionin që u nevojitet inspektorëve.

Drejtuesit e shoqërive zakonisht duhet të jenë të prirur t'i ndihmojnë inspektorët që t'i zgjidhin çështjet që kanë me shoqërinë. Një qasje që shpesh funksionon mirë për inspektorët është që në vend që t'i kërkojnë shoqërisë që të përgatisë dokumente ose raporte specifike, tu shpjegojnë drejtuesve se cili është problemi dhe tu kërkojnë atyre se çfarë disponojnë që mund t'i vijë në ndihmë inspektorëve për ta zgjidhur atë. Kjo qasje ndërton besimin e duhur në një kohë të shpejtë, duke i bërë inspektimet më të lehta për shoqërinë dhe rregullatorin.

Edhe audituesit e jashtëm duhet të kontaktohen përpara inspektimit të planifikuar. Duhet të organizohet një takim midis grupit të inspektimit (ose të paktën drejtuesit të grupit dhe një anëtar) dhe audituesit në mënyrë që grupi i inspektimit të jetë në dijeni të punës së kryer nga audituesi dhe deri në çfarë mase do të mbështetet në atë punë. Grupi i inspektimit duhet të jetë në dijeni të çdo çështjeje të ngritur nga audituesi dhe gjendjen aktuale të këtyre çështjeve. Inspektorët duhet gjithashtu të kenë një kopje të letrës për drejtuesit nga audituesi për shoqërinë, në të cilën audituesi përmbledh çdo çështje që duhet rregulluar nga shoqëria. Dokumenti i planifikimit të inspektimit duhet të theksojë çdo çështje të rëndësishme për ndjekje që lidhet me auditimin.

Në qoftë se shoqëria është aktive në juridiksione të tjera, inspektorët duhet të komunikojnë me rregullatorët në ato juridiksione për të konstatuar në se ata kanë ndonjë shqetësim për

veprimtarinë e shoqërisë. Çdo çështje e rëndësishme duhet të përfshihet në dokumentin e planifikimit të inspektimit.

Të gjitha informacionet e grumbulluara si pjesë e procesit të planifikimit para inspektimit duhet të përdoren për të përditësuar profilin e rrezikut të shoqërisë duke planifikuar punën kryesore të inspektimit për fushat me risk më të lartë.

Për çdo fushë rreziku, dokumenti i planifikimit duhet të vlerësojë qartë situatën e rrezikut neto dhe të tregojë qasjen e inspektimit që do të zbatohet për atë fushë, duke përfshirë dhe sasinë e punës që do të kryhet.

Normalisht, procesi i planifikimit do të kryhet nga drejtuesi i grupit të inspektimit, duke bashkëpunuar me anëtarët e tjerë për kontributet e tyre.

A. 3. Faza III: Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut dhe Strategjitë për Zbutjen e Rrezikut

Matrica e Rrezikut

Matrica e rrezikut shërben për vlerësimin e rrezikut të siguruesit. AMF fillimisht punon për vlerësimin e rrezikut të biznesit siç përcaktohet në model, dhe më pas procesi zgjerohet me vlerësimin e kontrollit të rrezikut të siguruesve dhe proceset e administrimit të rrezikut, që këtej e tutje do të quhen funksionet mbikëqyrëse në shoqëri. Hapi tjetër është të vlerësohet rreziku neto për çdo aktivitet biznesi dhe rreziku i përgjithshëm neto për të gjitha aktivitetet e biznesit të shoqërisë. Hapi i fundit është të vlerësohen cilësia e kapitalit dhe e fitimeve, si dhe efekti i këtyre vlerësimeve tek rreziku i përgjithshëm neto, që të çon tek vlerësimi i rrezikut të përbërë, i cili përfaqëson profilin e rrezikut të shoqërisë. Në pjesën e mbetur të këtij seksioni do të shpjegohet matrica e rrezikut.

Matrica e rrezikut i:

- ❖ lejon si stafit mbikëqyrës dhe anëtarëve të industrisë të ndjehen komodë, pasi rekomandimet dhe veprimet janë të qëndrueshme në kohë dhe nga një situatë në tjetrën,
- ❖ mundëson shoqërive që të njohin fuqinë e reagimit rregullator që mund të pritët në situata të ndryshme dhe ta qeverisin veten në përputhje me to, d.m.th., pa ‘të papritura’ nga rregullatori.

Siç sugjerohet nga pika e fundit, në dispozicion të siguruesve duhet të vihet të paktën një përmbledhje e nivelit të lartë të procesit të vlerësimit të rrezikut që ata të kuptojnë pritshmëritë e AMF-së prej tyre dhe se si do të mbikëqyren.

Asnjë metodologji nuk mund ta zëvendësojë kuptimin e parimeve bazë dhe zbatimin e gjykimit të shëndoshë, të informuar dhe praktik. Duke pasur këto gjëra themelore, modeli ofron një bazë të qëndrueshme për vlerësimin e rrezikut.

A. 3.1 Aktivitetet e biznesit dhe rreziqet e pranishëm

EMRI I SHOQËRISË MATRICA E RREZIKUT më [DATË]							
Aktivitetet e biznesit	Rreziqet e pranishëm						
	Kreditit	Tregut	Likuiditetit	Sigurimit	Operacional	Ligjor & Rregullator	Strategjik
Klasifikimi i përgjithshëm							

Hapi i parë për vlerësimin e rrezikut në shoqëri e është identifikimi i aktiviteteve të rëndësishme me të cilat merret shoqëria dhe rreziqet kryesore të pranishëm në ato aktivitete. Arsyeja për këtë është se rreziku është i pranishëm tek aktiviteti; ku nuk ka aktivitet nuk ka risk.

Aktivitetet e biznesit

Aktivitetet bazë që priten të konstatohen në një sigurues Jojete janë, marrja në sigurim, negocimi dhe lidhja e marrëveshjeve të risigurimit, administrimi dhe vlerësimi i dëmeve, dhe investimi. Kur identifikohen aktivitetet, inspektori duhet të dallojë se si është e strukturuar shoqëria dhe si menaxhohet, dhe t'i organizojë aktivitetet në të njëjtën mënyrë. Për shembull, mund të jetë një menaxher i nivelit të lartë që mbikëqyr marrjen në sigurim, por aktiviteti mund të ndahet në njësi operative të veçanta, si p.sh., në linjat e sigurimit personal dhe linjat e sigurimit për bizneset, secila me menaxhimin e vet operacional. Meqenëse mbikëqyrja me fokus rrezikun vlerëson se si menaxhohet rreziku nga shoqëria, inspektorët duhet ta shikojnë rrezikun në të njëjtën mënyrë që e shikojnë drejtuesit e shoqërisë.

Gjithashtu është e rëndësishme që të veçohen aktivitetet në bazë të nivelit të ndryshëm të rrezikut që ato kanë. Për shembull, marrja në sigurim mund të identifikohet si një aktivitet, por ajo mund të përmbajë edhe risk të lartë (p.sh. përgjegjësitë e biznesit) edhe risk të ulët (p.sh. prona

personale). Në skenarin me linjat e sigurimit personal/biznesit, linjat personale do të përfshinin sigurimin e pronës dhe përgjegjësitë motorike ndaj palëve të treta, ndërsa linjat e biznesit mund të përfshijnë sigurimin e pronës dhe lloje të ndryshme të sigurimit të përgjegjëseve, si përgjegjësitë e përgjithshme, përgjegjësitë e produktit dhe përgjegjësitë profesionale. Aktivitetet/produktet me risk të lartë duhet të veçohen gjatë vlerësimit të rrezikut për të siguruar që rreziku në to nuk maskohet nga kombinimi i tyre me aktivitetet/ produktet me risk më të ulët. Duhet të identifikohen për vlerësim vetëm ato aktivitete që janë të rëndësishme. Aktivitetet e rëndësishme mund të përfshijnë çdo produkt, njësi ose proces dhe identifikohen nga burime të ndryshme që përfshijnë diagramat organizative, planet strategjike/të biznesit dhe raportimet financiare të brendshme dhe të jashtme të shoqërisë. Kërkohej gjykim i shëndoshë, i mbështetur në informacion për të përcaktuar rëndësinë ose materialitetin e çdo aktiviteti në të cilën angazhohet shoqëria. Shembuj të kriterëve që mund të përdoren janë:

- a) të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti në raport me të ardhurat totale;
- b) të ardhurat neto për veprimtarinë në raport me të ardhurat neto totale;
- c) ekspozimi nga marrja në sigurim në raport me kapitalin;
- d) provigjonet e mbajtura si përqindje e provigjoneve totale.

Rreziket e Pranishme

Rreziku mund të kategorizohet në shumë mënyra. Pavarësisht nga kategoritë e përzgjedhura, duhet treguar kujdes që çfarëdo rreziku biznesi që mund të identifikohet nga ndonjë shoqëri, ai të jetë i përfshirë në një prej kategorive të përzgjedhura. Shtatë kategoritë e treguara në matricën e rrezikut u provuan si të suksesshme në juridiksionet e tjera dhe përkufizohen më poshtë:

Rreziku i Kreditit

Rreziku i kreditit lind nga paaftësia ose mungesa e vullnetit të palës tjetër për të përmbushur plotësisht detyrimet e saj kontraktuale të bilancit dhe/ose jashtë bilancit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku vjen nga transaksionet financiare me një palë tjetër që mund të jetë emetuesi, debitori, huadhënësi, ndërmjetësi, i siguruari, i risiguruari ose garantuesi.

Rreziku i Tregut

Rreziku i tregut lind nga ndryshimet në normat ose çmimet e tregut. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga aktivitetet e tregtimit dhe marrjes së pozicioneve në tregje si norma e interesit, këmbimi i monedhës së huaj, kapitalit, mallrave dhe pasurive të paluajtshme. Rreziku i normës së interesit dhe rreziku i këmbimit të monedhës së huaj përshkruhen më poshtë:

1. Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit lind nga luhatjet në normat e interesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku kryesisht lind nga diferencat në kohë në rivendosjen e çmimeve të aseteve dhe detyrimeve, si në bilanc edhe jashtë bilancit, sepse ato ose maturohen (instrumentet me norma fikse) ose u rrihet çmimi me kontratë (instrumentet me norma të ndryshueshme).

2. Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj

Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij rreziku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut (ang. spot & forward markets).

Rreziku i Sigurimit

1. Rreziku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit

Rreziku i dizenjimit të produktit dhe vendosjes së çmimit lind nga ekspozimi ndaj humbjes financiare nga transaksionet në sigurime dhe/ose në biznesin e anuitive, ku kostot dhe përgjegjësitë e marra përsipër në lidhje me një linjë produkti e tejkalojnë pritshmërinë në vendosjen e çmimit të linjës së produktit.

2. Rreziku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësive

Rreziku i marrjes në sigurim dhe i përgjegjësive është ekspozimi ndaj humbjes financiare që rezulton nga përzgjedhja dhe miratimi i rreziqeve që do të sigurohen, reduktimi, mbajtja dhe transferimi i rrezikut dhe menaxhimi i opsioneve kontraktuale dhe jo kontraktuale të produktit.

Rreziku Operacional

Rreziku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore.

Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind nga paaftësia e shoqërisë për të blerë ose për të pasur fondet e nevojshme, nëpërmjet rritjes së detyrimeve ose konvertimit të aseteve, për të përmbushur detyrimet e saj në bilanc ose jashtë bilancit kur vjen koha e pagesës së tyre, pa shkaktuar humbje të papranueshme.

Rreziku Ligjor dhe Rregullator

Rreziku ligjor dhe rregullator lind nga moszbatimi nga ana e një shoqërie i ligjeve, rregullave, rregulloreve, praktikave të parashkruara apo standardeve të etikës në çdo juridiksion ku operon shoqëria.

Rreziku Strategjik

Rreziku strategjik lind nga paaftësia e një shoqërie për të zbatuar planet e duhura të biznesit, strategjitë, vendimmarrjet, shpërndarjen e burimeve si dhe paaftësia e tij për tu përshtatur me ndryshimet në mjedisin e tij të biznesit.

Duhet të vlerësohen vetëm rreziqet kryesore në një aktivitet. Për shembull, në një aktivitet të marrjes në sigurim, rreziku i sigurimit është rreziku kryesor, por rreziku i kreditit nuk është i tillë po që se nuk ka kushte kredie për primet, të cilat kanë peshë. Anasjelltas, ndërsa në risigurim nuk ka risk sigurimi, rreziku i kreditit është një risk kryesor. Rreziku operacional është i pranishëm në shumicën e aktiviteteve dhe rreziku strategjik mund të jetë i pranishëm në një aktivitet, në qoftë se shoqëria ka hartuar plane strategjike për aktivitetin, dështimi i të cilave do të dëmtonte mirëqenien e shoqërisë.

Është detyra e inspektorit që të zbatojë gjykimin e shëndoshë, dhe të informuar për të vendosur se cilat rreziqe i përkasin një aktiviteti dhe deri në çfarë mase i përkasin. Rreziqet do të kategorizohen si të ulët, mesatarë ose të lartë. Përkufizimet për kategorizimin e rreziqeve janë:

I ulët

Rreziku i pranishëm i ulët ekziston kur, ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet e ardhshme potenciale, ka një **probabilitet më të ulët se mesatarja** për të pasur ndikim negativ mbi kapitalin ose fitimet e një shoqërie.

Mesatar

Rreziku i pranishëm mesatar ekziston kur, ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet e ardhshme potenciale, ka një **probabilitet mesatar** për të pasur ndikim negativ mbi kapitalin ose fitimet e një shoqërie.

I lartë

Rreziku i pranishëm i lartë ekziston kur, ekspozimi dhe pasiguria nga ngjarjet e ardhshme potenciale, ka një **probabilitet më të lartë se mesatarja** për të pasur ndikim negativ mbi kapitalin ose fitimet e një shoqërie.

Koncepti i ‘probabilitetit mesatar’ është subjektiv. Nuk ka ndonjë shkallë absolute me anë të së cilës të mund të matet rreziku. Vlerësimi i nivelit të rrezikut në një aktivitet kërkon ta njohësh dhe ta kuptosh mjaft thellë aktivitetin dhe të përdorësh gjykimin e shëndoshë, dhe të informuar mbi faktet që janë në dispozicion.

Nuk ka ndonjë vlerësim përgjithësues për rreziqet e pranishëm. Në matricën e rrezikut, ‘i përgjithshëm’ do të thotë për të gjithë shoqërinë. Rreziqet i përkasin aktiviteteve specifike dhe është pothuajse e pamundur që një risk i caktuar t’i përkasë të gjithë aktiviteteve të një shoqërie. Po kështu, nivelet e rrezikut në aktivitetet e veçanta me shumë mundësi ndryshojnë, duke e bërë të pakuptimtë çdo përpjekje për një vlerësim të të gjithë shoqërisë. Rreziku i përgjithshëm në aktivitetet e një shoqërie vlerësohet më vonë në matricën e rrezikut.

Tabela më poshtë sugjeron aktivitetet e biznesit në të cilat janë të pranishëm rreziqet e veçanta dhe jep faktorët që duhen konsideruar gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve.

Kategoria e rrezikut	Aktivitetet e zakonshme	Konsiderata vlerësimi
Rreziku i kreditit Rreziku i kreditit lind nga paaftësia ose mungesa e vullnetit të palës tjetër për të përmbushur plotësisht detyrimet e saj kontraktuale. Ekspozimi ndaj këtij rreziku vjen nga transaksionet financiare me një palë tjetër që mund të jetë emetuesi, debitori, huadhënësi, ndërmjetësi, i siguruari, i risiguruari ose garantuesi.	- Mbledhja e primit - Të arkëtueshme nga ndërmjetësit - Të arkëtueshme nga risiguruesit - Investimet - Të tjera të arkëtueshme si komisione dhe rimbursime	- A ka shoqëria politika të administrimit të rrezikut të kreditit? - Këto politika - o a përcaktojnë nivelet e vendimmarrjes dhe kufijtë për dhënien e kreditit? - o a vendosin kufij përqendrimi për debitorë/huamarrës të veçantë? - o a zbatohen për investimet e shoqërisë? - A rishikohen politikat në mënyrë periodike? - Përveç investimeve të saj në instrumente me të ardhura fikse, a i jep shoqëria kredi subjekteve/personave të tjerë përveç risiguruesve? - Nëse po, kujt dhe për çfarë qëllimi? - A ka standarde për vlerësimin e debitorëve/huamarrësve të veçantë si të përshtatshëm për t'ju dhënë hua? Cilat janë ato standarde? Si zbatohen ato? - A ka standarde që parashikojnë borxhet e këqija? - Si adresohen falimentimet/moskthimet e huave? - A ka një proces të vendosur për menaxhimin dhe mbledhjen e llogarive problematike? - Cilat janë kriteret për klasifikimin dhe heqjen/reduktimin në vlerë të një borxhi të keq si të pa mbledhshëm? - A ka ndonjë proces raportimi të rregullt e periodik të llogarive problematike për menaxhimin e lartë dhe këshillin?
Rreziku i Tregut Rreziku i tregut lind nga ndryshimet në normat ose çmimet e tregut. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga aktivitetet e tregtimit	- Investime - Instrumente derivate - Vlerësimi i aseteve	- A mban shoqëria asete, vlera e drejtë e tregut të të cilave nuk është e lehtë të përcaktohet? - A është përcaktuar vlera e këtyre aseteve nga shqyrtim i pavarur? - Sa herë rishikohet vlera?

Kategoria e rrezikut	Aktivitetet e zakonshme	Konsiderata vlerësimi
dhe marrjes së pozicioneve në tregjet si norma e interesit, këmbimi i monedhës së huaj, kapitalit, mallrave dhe pasurive të paluajtshme. Rreziku i normës së interesit dhe rreziku i këmbimit të monedhës së huaj përshkruhen më poshtë a. Rreziku i normës së interesit Rreziku i normës së interesit lind nga luhatjet në normat e interesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku kryesisht lind nga diferencat në kohë në rivendosjen e çmimeve të aseteve dhe detyrimeve, si në bilanc edhe jashtë bilancit, sepse ato ose maturohen (instrumentet me norma fikse) ose u rrvihet çmimi me kontratë (instrumentet me norma të ndryshueshme). b. Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj Rreziku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij rreziku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut (ang. spot & forward markets).	- Pasuri e paluajtshme - Hua të siguruara	- Cili është qëllimi i mbajtjes së këtyre aseteve? - A ka shoqëria politika për të kufizuar vlerat dhe përqendrimin e këtyre aseteve? - monitorohen dhe maten rregullisht fitimet/humbjet e pa realizuara mbi këto asete, p.sh., në çdo tre muaj? - A ka shoqëria ndonjë politikë/procedurë për ta reduktuar vlerën e aseteve kur vlera në pasqyrat financiare e kalon vlerën e tregut? - A mban shoqëria asete ose detyrime në monedhë të huaj? - Nëse mban, a përputhen ato në mënyrë të arsyeshme? - Si monitorohet dhe matet rreziku i këmbimit të monedhës së huaj?
Rreziku i Sigurimit a. Rreziku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosjes së Çmimit Rreziku i dizenjimit të produktit dhe vendosjes së çmimit lind nga ekspozimi ndaj humbjes financiare nga transaksionet në sigurime dhe/ose në biznesin e anutivë, ku kostot dhe përgjegjësitë e marra përsipër në lidhje me një linjë produkti	Marrja në sigurim: - Politikat për madhësinë/nivelin e primit - Përzgjedhja e rreziqeve që do të sigurohen - Marketingu dhe rritja e shitjeve - Performanca e marrjes në sigurim e agentëve,	- A ka shoqëria politika që mbulojnë rrezikun e marrjes në sigurim? - A janë këto politika të shprehura në manuale/udhëzues dhe a shpërndahen ato në mënyrë të qartë për stafin e duhur? - A trajtojnë këto politika? - zhvillimin e produkteve të reja dhe futjen apo/dhe daljen nga linjat e produkteve? - llojet e biznesit që duhen shmangur?

Kategoria e rrezikut	Aktivitetet e zakonshme	Konsiderata vlerësimi
e tejkalojnë pritshmërinë në vendosjen e çmimit të linjës së produktit. b. Rreziku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësi Rreziku i marrjes në sigurim dhe i përgjegjësi është ekspozimi ndaj humbjes financiare që rezultojnë nga përzgjedhja dhe miratimi i rreziqeve që do të sigurohen, reduktimi, mbajtja dhe transferimi i rrezikut dhe menaxhimi i opsioneve kontraktuale dhe jo kontraktuale të produktit.	brokerave dhe personelit të shitjeve	- o zhvillimin e nivelit të primit – përfshirjen aktuariale? - o kufijtë e policës dhe të mbajtjes? - o përzgjedhjen e rrezikut? - o përqendrimin e ekspozimit? - o përzgjedhjen dhe përdorimin e risigurimit? - o nivelet dhe kufijtë e autorizimit? • A ka procedura për verifikimin e përputhshmërisë me politikat e marrjes në sigurim? • A monitoron shoqëria rregullisht përvojën/rezultatet sipas klasave/llojit të biznesit? • A rishikohen në mënyrë periodike skedarët/dosjet e marrjes në sigurim?
Rreziku i Likuiditetit Rreziku i likuiditetit lind nga paaftësia e shoqërisë për të blerë ose për të pasur fondet e nevojshme, nëpërmjet rritjes së detyrimeve ose konvertimit të aseteve, për të përmbushur detyrimet e saj në bilanc ose jashtë bilancit kur vjen koha e pagesës së tyre, pa shkaktuar humbje të papranueshme.	• Vlerësimi i letrave me vlerë që kanë pësuar rënie në treg (obligacione, aksione, etj.) • Instrumente derivate • Investime në ndërmarrje të përbashkëta, partneritete dhe në kompani me përgjegjësi të kufizuara • Investime në pasuri të paluajtshme	• A shoqëria ka një politikë likuiditeti? • A monitoron shoqëria pozicionin e saj të likuiditetit në mënyrë periodike? • Cilat janë burimet e likuiditetit për shoqërinë? • A bën shoqëria parashikime për flukset e parasë dhe tabela përputhshmërie që i përshtaten llojit të biznesit të shkruar? • A marrin në konsideratë parashikimet mos arkëtimet e mundshme nga risigurimi? • A analizohen rregullisht nevojat e likuiditetit, p.sh., pagesat e dëmeve dhe pagave? • A mund të demonstrojë shoqëria se ka likuiditete të mjaftueshme për të përballuar kërkesat maksimale të mundshme për likuiditet? • A ka shoqëria ekspozime të konsiderueshme ndaj investimeve jo-likuide të tilla si pasuritë e paluajtshme? • A mund të ndikojnë ato në nevojat e saj për likuiditet? • A përcakton politika e investimit kufij maksimalë për investimet jo-likuide? • A konsiderohen nevojat e shoqërisë për likuiditet si pjesë e politikës së investimit?

Kategoria e rrezikut	Aktivitetet e zakonshme	Konsiderata vlerësimi
Rreziku Operacional Rreziku operacional lind nga problemet në performancën e funksioneve ose proceseve të biznesit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku mund të lindë nga mangësitë ose defektet në kontrollet e brendshme ose proceset, defektet në teknologji, gabimet njerëzore ose pandershmëria dhe katastrofat natyrore. Problemet operationale si sistemet e papërshtatshme të informacionit, shkeljet në kontrollet e brendshme, mashtrimi, apo katastrofat e paparashikuara çojnë në humbje të papritura. Këtu futet vlerësimi i gabuar i provigjoneve të dëmeve dhe detyrimeve të tjera, gjë që çon në pagesa faktike më të mëdha se shumatat e parashikuara.	• Monitorimi i menaxhimit • Prezantimi i pasqyrave financiare • Rikthim në gjendje normale pas katastrofave (ang. Disaster recovery) • Sistemet e informacionit • Vlerësimi i dëmeve dhe parashikimet • Procedurat e trajtimit të dëmeve • Metodatat e provigjonimit dhe supozimet • Shpenzimet për vlerësimin e dëmeve • Shërbimi ndaj klientit	• A ka shoqëria ndonjë plan veprimi për të trajtuar problemet potenciale të likuiditetit? • A ka menaxhimi i lartë njohuri të nevojshme për biznesin në mënyrë që të monitorojë në mënyrë efektive menaxhimin operacional? • A i merr këshilli informacionet e mjaftueshme dhe të duhura për operacionet e shoqërisë në mënyrë periodike? • A ka politika për shmangien e konfliktit të interesit për drejtorët, punonjësit, drejtuesit dhe të gjithë punonjësit e tjerë? • A ka shoqëria kontrole të brendshme të përshtatshme, të miratuara nga këshilli dhe të monitoruara nga menaxhimi i lartë? • A është menaxhimi operacional i informuar plotësisht për kontrollet e brendshme dhe a i kuptojnë ato? • A ekzistojnë procese me anë të së cilave menaxhimi operacional zbaton përputhshmërinë me kontrollet e brendshme? • A ka auditime të rregullta periodike të veprimtarisë dhe të efektivitetit të kontrolleve të brendshme? • A ka shoqëria politika për vendosjen, rishikimin dhe përditësimin e provigjoneve? • A specifikohen afatet maksimale kohore për rishikimin e provigjoneve fillestare dhe rishikimin periodik të praktikave individuale të dëmeve? • A përfshihen në provigjone të gjitha kostot e trajtimit të dëmeve, d.m.th., zhdëmtimi, komisionet e ekspertëve/vlerësuesve të pavarur dhe kostot e brendshme? • A përfshihet dhe llogaritet IBNR në mënyrë të arsyeshme? • A monitoron shoqëria raportin provigjone ndaj kapitalit, për të përcaktuar marzhin e saj të gabimit në parashikimin e provigjoneve? • A ka raportim të rregullt periodik për

Kategoria e rrezikut	Aktivitetet e zakonshme	Konsiderata vlerësimi
		dëmet e mëdha pranë një komiteti të menaxhimit të lartë apo të këshillit? - A ka rishikime/shqyrtime të rregullta periodike të praktikave të dëmeve? - A rishikohen/shqyrtohen provigjonet e shoqërisë nga një aktuar i kualifikuar?
Rreziku Ligjor dhe Rregullator Rreziku ligjor dhe rregullator lind nga moszbatimi nga ana e një shoqërie i ligjeve, rregullave, rregulloreve, praktikave të parashkruara apo standardeve të etikës në çdo juridiksion ku operon shoqëria.	- Zbatimi i parimeve dhe standardeve të kontabilitetit - Zbatimi i akteve të AMF - Detyrimi tatimor - Mbajtja e fondit të garancisë - Zbatimi i rregullave për trajtimin e konsumatorëve (ang. Market conduct compliance)	- A ka ndonjë punonjës/funksionarë kryesorë që i njeh tërësisht dispozitat ligjore dhe rregulloret të cilat shoqëria duhet t'i zbatojë? - A u nënshtrohen të gjitha transaksionet dispozitave specifike, p.sh., a rishikohet përputhshmëria e transaksioneve me palët e lidhura para se të kryhen? - A vepron shoqëria në ndonjë juridiksion të huaj dhe në qoftë se vepron, a i kupton qartë kërkesat e atyre juridiksioneve? - A mban shoqëria komunikim të hapur me rregullatorin e vendit dhe ato të juridiksioneve të huaja në të cilat vepron?
Rreziku Strategjik Rreziku strategjik lind nga paaftësia e një shoqërie për të zbatuar planet e duhura të biznesit, strategjitë, vendimmarrjet, shpërndarjen e burimeve si dhe paaftësia e tij për tu përshtatur me ndryshimet në mjedisin e tij të biznesit.	- Monitorimi i menaxhimit - Analiza e rreziqeve nga kompania - Krahasime (ang. benchmarking) të pasakta - Projeksione financiare dhe parashikime ekonomike	- A kryen shoqëria planifikim strategjik? - Në se po, a janë të dokumentuara qartë ato plane? - A shqyrtohen dhe miratohen nga këshilli të gjitha planet strategjike? - A krijon shoqëria plane taktike/biznesi duke përcaktuar hapat e kërkuar për të arritur planin strategjik? - A duken se janë të arritshëm këto hapa në rrethanat që janë? - A ka konstatuar shoqëria pengesa për arritjen e qëllimeve të saj strategjike? - A e ka testuar shoqëria efektin e mosarritjes së të gjithë apo një pjese të qëllimeve të saj strategjike? - A ka bërë shoqëria ndonjë plan kontingjence për të mbuluar këtë mundësi?

Përmbajtja e kësaj tablele përbën një udhëzues për inspektorët. Shoqëritë mund të angazhohen në veprimtari të papërmendura më lart. Për këtë arsye edhe konsideratat e vlerësimit nuk janë

shteruese por mbikëqyrësi ka të drejtë brenda kompetencave ligjore të kërkojë çfarëdolloj informacioni që e gjykon të nevojshëm për vlerësimin e rrezikut. Siç është thënë dhe më sipër, është detyrë e inspektorëve të zbatojnë gjykimin e shëndoshë dhe të informuar për të vendosur se cilat rreziqe shoqërohen me një aktivitet të caktuar dhe deri në çfarë mase.

A. 3.2 Mbikëqyrja nga drejtimi dhe rreziku neto

EMRI I SHOQËRISË							
MATRICA E RREZIKUT më [DATË]							
Cilësia e funksioneve të mbikëqyrjes nga drejtimi						Rreziku neto	Drejtimi i rrezikut
Manaxhimi operacional	Përputhshmëria	Auditi i Brendshëm	Administrimi i Rrezikut	Manaxhimi i Iartë	Këshilli mbikëqyrës		
Performanca e funksioneve të mbikëqyrjes brenda aktiviteteve							
	Performanca e përgjithshme	Performanca e përgjithshme	Performanca e përgjithshme	Performanca e përgjithshme	Performanca e përgjithshme		
						Rreziku neto i përgjithshëm	

Mbikëqyrja nga drejtimi

Strategjitë/kontrollet për zbutjen e rrezikut në përgjithësi bazohen në pesë parime, të cilat zbatohen për të gjithë veprimtaritë kyçe:

1. Këshill aktiv dhe mbikëqyrja e menaxhimit të lartë.
2. Sisteme të përshtatshme/mjaftueshme të administrimit të rrezikut, monitorimit dhe menaxhimit të informacionit.
3. Politika, nivele autorizimi dhe procedura të qarta dhe të përshtatshme.
4. Kontrolle të brendshme gjithëpërfshirëse.
5. Procese që sigurojnë përputhjen me ligjet dhe rregulloret.

Për të arritur në një vlerësim të rrezikut neto në çdo veprimtari të shoqërisë, vlerësojmë cilësinë e funksioneve të mbikëqyrjes së saj (kontrolli dhe zbutja e rrezikut):

Këshilli: drejton dhe mbikëqyr menaxhimin dhe veprimtarinë e shoqërisë;

Menaxhimi i lartë: Drejton dhe mbikëqyr menaxhimin e veprimtarisë së shoqërisë;

Auditi i brendshëm: mbikëqyr efektivitetin dhe zbatimin e politikave dhe kontrolleve organizative dhe proceduriale të shoqërisë;

Përputhshmëria: mbikëqyr menaxhimin e shoqërisë nëse zbaton legjislacioni në fuqi në të gjitha vendet ku shoqëria ushtron veprimtari;

Administrimi i rrezikut: mbikëqyr administrimin e rreziqeve në aktivitetet e shoqërisë duke siguruar që të ketë procese efektive;

Menaxhimi operacional: planifikon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e përditshme të aktiviteteve të biznesit të shoqërisë. Gjithashtu siguron që politikën, praktikën, niveli i stafit dhe eksperiencën janë të mjaftueshme dhe efektive për menaxhimin e përditshëm të rrezikut. Nuk ka një klasifikim të përgjithshëm për menaxhimin operacional pasi përgjegjësitë e tij nuk shtrihen në nivel kompanie.

Në mënyrë tipike vetëm shoqëritë e mëdha e të sofistikuar kanë departamente për administrimin e rrezikut, ndërsa shoqëritë më të vogla mundet të mos kenë p.sh. departamente përputhshmërie (ang. compliance). Aty ku siguruesit nuk kanë strukturë formale që ju korrespondojnë këtyre funksioneve, dikush në një nivel të përshtatshëm autoriteti duhet të përgjigjet për funksionet e përshkruara

Shumë shpesh, siguruesit e vegjël kanë funksione mbikëqyrëse që kryhen nga punonjës me përgjegjësi të shumëfishta. Aty ku nuk ekzistojnë departamentet e veçantë të mbikëqyrjes, menaxhimi i lartë përgjigjet për funksionet që ato departamente do të kryenin dhe vlerësohet në lidhje me këtë.

Funksionet e mbikëqyrjes ofrojnë “një palë sy të tjerë”, që siguron që menaxhimi operacional është duke menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive me bazë ditore. Për shembull, menaxhimi i lartë mund të ketë implementuar një politikë që shoqëria nuk do të mbajë më tepër se 15 milionë lekë ekspozim në një risk. Drejtuesit e marrjes në sigurim (menaxhimi operacional) përgjigjen për të siguruar që specialisti i marrjes në sigurim t’i përmbahet kësaj politike ose nëpërmjet kufijve të policës, ose nëpërmjet risigurimit të përshtatshëm.

Mbikëqyrja e zbatimit të politikës nga drejtuesit e marrjes në sigurim mund të kryhet nga auditi i brendshëm, i cili do t’ua raportonte shkeljet e politikës menaxhimit të lartë dhe këshillit, si dhe do të vepronte për t’i rregulluar shkeljet. Funksionet e mbikëqyrjes vlerësohen si të forta, të pranueshme ose të dobëta.

Pasi të jenë vlerësuar funksionet e mbikëqyrjes në lidhje me performancën e tyre në secilin nga aktivitetet e biznesit të shoqërisë, atyre mund tu jepet vlerësimi i përgjithshëm. Në qoftë se një funksion mbikëqyrjeje është vlerësuar i fortë në çdo aktivitet dhe veprimtari, atëherë vlerësimi i përgjithshëm i tij do të jetë i fortë. Megjithatë, në qoftë se funksioni vlerësohet ndryshe në aktivitetet e shoqërisë, duhet dhënë një gjykim për vlerësimin e përgjithshëm. Inspektori duhet t’i

kushtojë vëmendje të veçantë çdo vlerësimi të dobët të aktiviteteve sepse kjo mund të ishte një shenjë paralajmëruese për funksionin, pavarësisht nga performanca e tij në veprimtari të tjera. Tabela më poshtë sugjeron faktorët që mund të merren në konsideratë nga inspektorët kur bëjnë vlerësimin e funksioneve të mbikëqyrjes në shoqëri.

Funksioni i mbikëqyrjes	Konsiderata
Këshilli	• A ka politika për numrin e drejtuesit dhe kualifikimin, njohuritë, aftësitë dhe përvojën e tyre? • A ka një proces për përzgjedhjen, miratimin, rinovimin e kohës në detyrë dhe zëvendësimin e drejtorëve? • A ka drejtorë të jashtëm? • A i rishikon dhe a i miraton Këshilli? - o objektivat, strategjitë dhe planet e biznesit? - o politikat dhe praktikën e administrimit të rrezikut? - o politikat dhe praktikën e menaxhimit të kapitalit? - o politikat e konfliktit të interesit? • A merr Këshilli rregullisht informacionet e nevojshme për të monitoruar respektimin e politikave dhe procedurave? • A është Këshilli i përfshirë aktivisht në përzgjedhjen dhe vlerësimin e performancës së menaxhimit të lartë dhe funksionarët kryesorë? • A vendos Këshilli një prag për llojin dhe rëndësinë e çështjeve që duhen sjellë në vëmendjen e tij? • A i sfidon/diskuton Këshilli informacionet që merr nga Menaxhimi i lartë?
Menaxhimi i Lartë	• A janë të përcaktuara qartë autoriteti, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e menaxhimit të lartë? A janë komunikuar ato në të gjithë shoqërinë? • A përdoren komitetet e menaxhimit të lartë për të mbikëqyrur menaxhimin e aktiviteteve të biznesit dhe rreziqet që lidhen me to? • Në qoftë se po, a janë të përcaktuara qartë përgjegjësitë dhe detyrat e komiteteve dhe a janë komunikuar në të gjithë shoqërinë? • A disponon menaxhimi i lartë të gjitha kualifikimet, njohuritë, aftësitë dhe përvojën e kërkuar për të përmbushur përgjegjësitë e tyre? • A vendos menaxhimi i lartë objektiva, strategji dhe plane biznesi, dhe a e monitoron performancën kundrejt tyre? • A sigurohet menaxhimi i lartë se po respektohen politikat e miratuara si dhe po zbatohet legjislacioni në fuqi? • A harton menaxhimi i lartë strategji dhe plane të përshtatshme dhe të kujdesshme? • A vendos menaxhimi i lartë një 'ton nga sipër' të përshtatshëm, duke i kryer detyrat në mënyrë etike dhe duke pritur të njëjtën gjë nga i gjithë stafi? • A e informon menaxhimi i lartë vazhdimisht dhe në mënyrë të plotë, Këshillin dhe komitetet e tij, për mundësitë strategjike dhe shqetësimet, performancën operative dhe problemet që mund të ndikojnë në mirëqenien e shoqërisë?
Auditi i Brendshëm	• A përmban njësia i auditit të brendshëm?

Funksioni i mbikëqyrjes	Konsiderata
	- o objektiva të qarta për veprimtaritë e tij? - o autoritetin e tij për të kryer përgjegjësitë në mënyrë të pavarur? - o të drejtën e tij për akses në të dhënat, informacionet dhe personelin e shoqërisë? - o autoritetin e tij për të ndjekur me menaxhimin veprimet e ndërmarra në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit? • A ka stafi i auditit të brendshëm kualifikimet dhe kompetencën e duhur? • A u përmbahen metodologjitë e auditit standardeve aktuale profesionale? • A ka një proces të planifikimit të auditit që identifikon qartë objektivat e auditit dhe objektin e punës? • A ua komunikon auditit i brendshëm rregullisht Këshillit dhe komitetit të auditimit, konstatimet e rëndësishme dhe të vazhdueshme si dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhimi në lidhje me to?
Përputhshmëria (ang. compliance)	• A përcakton funksioni i përputhshmërisë? - o objektiva të qarta për aktivitetet e tij? - o autoritetin për të kryer përgjegjësitë e tij në mënyrë të pavarur? - o të drejtën e tij për akses në të dhënat, informacionet dhe personelin e shoqërisë? - o autoritetin e tij për të ndjekur me menaxhimin çështjet e identifikuar që lidhen me zbatimin dhe rekomandimet e bëra? • A ka akses të drejtpërdrejtë funksioni i përputhshmërisë tek menaxhimi i lartë dhe këshilli? • A ka përputhshmëria? - o praktika për të qëndruar në koherencë me ligjet e reja dhe ato që ndryshojnë, përfshi dhe kërkesat rregullatore? - o a zhvillon, dokumenton dhe ua komunikon politikat apo kërkesat, të reja apo të ndryshuara, të gjitha fushave të përfshira të shoqërisë? - o a monitoron zbatimin nga ana e shoqërisë të të gjitha ligjeve dhe kërkesave rregullatore? - o a shqyrton në mënyrë periodike praktikën e përputhshmërisë, për të synuar efektivitet të vazhdueshëm?

Funksioni i mbikëqyrjes	Konsiderata
Administrimi i Rrezikut	• A përcakton funksioni i administrimit të rrezikut? - o objektiva të qarta për veprimtaritë e tij? - o autoritetin e tij për të kryer përgjegjësitë në mënyrë të pavarur? - o të drejtën e tij për akses në të dhënat, informacionet dhe personelin e shoqërisë? - o autoritetin e tij për të ndjekur me menaxhimin çështjet e identifikuar që lidhen me administrimin e rrezikut dhe rekomandimet e bëra? • A ka funksioni i administrimit i rrezikut akses të drejtpërdrejtë tek menaxhimi i lartë dhe këshilli? • A është funksioni i administrimit i rrezikut i pavarur nga menaxhimi i përditshëm i rreziqeve? • A i monitoron funksioni i administrimit i rrezikut pozicionet e rrezikut kundrejt kufijve të miratuar dhe a sigurohet që shkeljet e konsiderueshme të trajtohen menjëherë? • A i trajton funksioni i administrimit i rrezikut në mënyrë efektive çështjet e administrimit të rrezikut të identifikuar si rezultat i ngjarjeve të brendshme ose të jashtme, apo nga funksionet e tjera të kontrollit? • A i jep funksioni i administrimit i rrezikut, raporte të rregullta, këshillit dhe menaxhimit të lartë, mbi efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut të shoqërisë?
Menaxhimi Operacional	• A janë menaxherët operacionalë plotësisht në dijeni të politikave, procedurave dhe kontrolleve të shoqërisë që ju përkasin fushave të tyre të veprimit? • A e monitorojnë ata respektimin e këtyre politikave, procedurave dhe kontrolleve nga stafi i tyre? • A përmbajnë raportet e departamenteve, informacionin e nevojshëm për menaxhimin e lartë që ata të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre të mbikëqyrjes? • A janë planet e biznesit në nivel departamenti, të arsyeshme, të menduara mirë dhe në përgjithësi të realizuara? • A bashkëpunon menaxhimi operacional me audituesit e brendshëm dhe të jashtëm në rastet kur këto të fundit kanë konstatime jo pozitive për departamentet e tyre? • A është stafi i departamentit i trajnuar siç duhet dhe i motivuar për të punuar mirë? • A i krijon menaxhimi operacional stafit mundësinë e trajnimit të përshtatshëm?

Rreziku Neto

Rreziku neto i një veprimtarie është rreziku i mbetur, pasi rreziku i pranishëm i nënshtrohet teknikave të kontrollit dhe zbutjes. Mbikëqyrja me fokus rrezikun është novatore, prandaj inspektori duhet të bëjë vlerësimin për drejtimin e rrezikut neto në çdo aktivitet. Ai mund të jetë duke u reduktuar, i qëndrueshëm ose në rritje. Për shembull, në qoftë se rreziku i biznesit është mesatar dhe mbikëqyrja (ang. oversight) është e pranueshme, por pa ndonjë pritshmëri për

përmirësim, ndërsa niveli i rrezikut neto mund të jetë i moderuar, drejtimi i tij mund të vlerësohet si në rritje.

Për të vlerësuar rrezikun neto të një veprimtarie, duhet ushtruar një gjykim i informuar mirë. Sa më i lartë të jetë rreziku i biznesit në një aktivitet, aq më e lartë pritet që të jetë cilësia e mbikëqyrjes. Tabela më poshtë tregon se çfarë vlerësimi rreziku mund të pritet, duke pasur parasysh një kombinim të veçantë të rrezikut të pranishëm dhe cilësisë së vlerësimeve të mbikëqyrjes, por kjo nuk duhet të përdoret si përcaktues absolut i nivelit të rrezikut.

Tabela e vlerësimit të rrezikut neto

Administrimi i rrezikut	Rreziku i pranishëm		
	I ulët	Mesatar	I lartë
I fortë	I ulët	I ulët	Mesatar
I pranueshëm	I ulët	Mesatar	I lartë
I dobët	Mesatar	I lartë	I lartë

A. 4. Faza IV Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut të Përgjithshëm Neto dhe Rrezikut të Përbërë

A. 4. 1 Rreziku i përgjithshëm neto

EMRI I SHOQËRISË							
MATRICA E RREZIKUT më [DATË]							
Cilësia e funksioneve të mbikëqyrjes						Rreziku neto	Drejtimi i rrezikut
Manaxhimi operacional	Përputhshmëria	Auditi i Brendshëm	Administrimi i Rrezikut	Manaxhimi i lartë	Këshilli mbikëqyrës		
						Rreziku neto i përgjithshëm	

Pasi vlerësohet rreziku neto për çdo aktivitet, vlerësohet rreziku neto i përgjithshëm në të gjitha aktivitetet. Për të bërë këtë, inspektori duhet të konsiderojë rrezikun neto të çdo aktiviteti dhe rëndësinë e çdo aktiviteti për shoqërinë. Për shembull, të supozojmë se një shoqëri ka pesë aktivitete, një prej të cilave vlerësohet se ka një rrezik të lartë neto ndërsa katër të tjerët vlerësohen se kanë risk neto të ulët ose të moderuar. Në qoftë se aktiviteti me risk të lartë përbën vetëm 5% të biznesit të shoqërisë, nuk ka gjasë që të ketë ndonjë efekt në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut neto. E kundërta, në qoftë se ai aktivitet përfaqëson 50% të biznesit, rreziku i përgjithshëm neto ndoshta do të vlerësohet si i lartë pavarësisht nga nivelet e rrezikut neto të ulët të vlerësuar për aktivitetet e tjera. Ashtu si me rrezikun neto, drejtimi i rrezikut të përgjithshëm neto duhet të vlerësohet në rënie, i qëndrueshëm ose në rritje.

Rreziku Neto i Përgjithshëm i Ulët

Shoqëria ka administrim rreziku që i zbut në masë të konsiderueshme rreziqet e pranishëm të aktiviteteve të biznesit deri në nivele që çojnë në një probabilitet më të ulët se sa mesatarja, që

ato të kenë një ndikim negativ të konsiderueshëm ndaj kapitalit dhe fitimeve në një të ardhme të pritshme.

Rreziku Neto i Përgjithshëm Mesatar

Shoqëria ka administrim rreziku që i zbut në mënyrë të mjaftueshme rreziqet e pranishëm të aktiviteteve të biznesit, deri në nivele që e çojnë në një probabilitet mesatar ndikimin negativ të konsiderueshëm ndaj kapitalit dhe fitimeve në një të ardhme të pritshme.

Rreziku Neto i Përgjithshëm i Lartë

Shoqëria ka dobësi në administrimin e rrezikut që çojnë në një risk neto të lartë në një numër aktivitete të biznesit. Këto nivele rreziku krijojnë probabilitet të lartë për një ndikim negativ të konsiderueshëm në kapitalin dhe fitimet e shoqërisë në një të ardhme të pritshme.

A.4.2 Kapitali dhe fitimet

Kapitali	Fitimet	
Rreziku i përbërë	Drejtimi i rrezikut	Harku kohor

Kapitali është një tregues i fuqisë aktuale ndërsa të ardhurat janë një tregues i suksesit në vazhdim, megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se kapitali dhe të ardhurat varen nga njëri tjetri në mënyrë reciproke. Të ardhurat mbështetin kapitalin duke gjeneruar fitime të pashpërndara (retained earnings), dhe kapitali i mjaftueshëm lehtëson fitimet.

Kapitali

Kapitali është një burim i mbështetjes financiare për të mbrojtur një shoqëri nga humbjet e papritura. Vlerësimi i mjaftueshmërisë së kapitalit merr në konsideratë edhe sasinë dhe cilësinë e kapitalit, si dhe menaxhimin e kapitalit, d.m.th., se si i parashikojnë drejtuesit dhe bordi nevojat e kapitalit të shoqërisë.

- | | |
|-----------|---|
| Sasia | <ul style="list-style-type: none"> - a i plotëson kapitali i shoqërisë kërkesat minimale dhe ato të synuara? - a është në gjendje shoqëria që ta rritë kapitalin nga jashtë pa u mbështetur tek aksionarët? - a kanë treguar aksionarët vullnet dhe aftësi për të kontribuar me kapital shtesë nëse kërkohet? |
| Cilësia | <ul style="list-style-type: none"> - a është kapitali i shoqërisë i përhershëm, p.sh., i pa kërkueshëm (ang. non-redeemable)? - a është kapitali i shoqërisë i lirë nga çdo detyrim për të bërë pagesa nga të ardhurat, p.sh., dividendët? - a është kapitali i shoqërisë ligjërish i varur nga të drejtat e të siguruarve dhe nga kreditorët e tjerë të shoqërisë? |
| Menaxhimi | <ul style="list-style-type: none"> - a ka shoqëria një politikë të menaxhimit të kapitalit? - a ka vendosur menaxhimi i lartë objektiva të brendshme për kapitalin? - nëse po, si lidhet objektivi i brendshëm me kërkesat rregullatore? - a fakton shoqëria në mënyrë periodike skenarë për të testuar stresin (ang. stress test) e kapitalit të saj? - cila është politika e dividendit? |

Efektiviteti i menaxhimit të kapitalit mund të vlerësohet duke rishikuar në retrospektivë:

- raportet e kapitalit;
- prirjet ose tendencat në kapitalin total;
- aftësinë për të menaxhuar objektivat e brendshme dhe kërkesat e rregullatorit;
- aftësinë për të rritur kapitalin kur nevojitet

Krahasimi me shoqëritë e tjera (ang. peer comparison) mund të jetë i dobishëm për të ndihmuar në formulimin e një vlerësimi për menaxhimin e kapitalit, por ky nuk duhet të jetë i vetmi kriter për vlerësimin. Krahasimi me shoqëritë e tjera është një mënyrë efektive për të identifikuar të 'spikaturit', por shoqëria 'më e mirë' e një grupi shoqërisht 'të këqija' përsëri është një shoqëri 'e keqe'. Përfitimi kyç që merret nga krahasimi me shoqëritë e tjera është kuptimi i arsyeve për dallimet mes shoqërive. Kapitali vlerësohet si i fortë, i pranueshëm ose i dobët dhe gjendja vlerësohet si në përmirësim, e qëndrueshme ose duke u përkeqësuar.

Kapital i fortë

Niveli i kapitalit i kalon nevojat aktuale dhe është shumë më lart kërkesave aktuale të rregullatorit. Prirja për mjaftueshmërinë e kapitalit gjatë 12 muajve të ardhshëm pritet të mbetet pozitive dhe shoqëria ka politika dhe praktika efektive të menaxhimit të kapitalit.

Kapital i pranueshëm

Niveli i kapitalit i kalon nevojat aktuale por jo aq shumë mbi kërkesat aktuale rregullatore. Prirja në mjaftueshmërinë e kapitalit gjatë 12 muajve të ardhshëm pritet të mbetet pozitive megjithëse ka pasur disa luhatje të fitimeve.

Kapital i dobët

Niveli i kapitalit nuk plotëson ose plotëson në mënyrë marginale, kërkesat minimale të rregullatorit të përcaktuara nga ligji ose politikat mbikëqyrëse. Klasifikimi tregon se kapitali i shoqërisë është i pamjaftueshëm për rreziqet që ka marrë përsipër. Prirja në mjaftueshmërinë e kapitalit gjatë 12 muajve të ardhshëm pritet që të jetë negative meqenëse veprimtaria ka gjeneruar humbje të konsiderueshme.

Fitimet

Fitimet absorbojnë humbjet normale dhe të pritshme në një periudhë të caktuar dhe japin mbështetje financiare duke kontribuar në gjenerimin e brendshëm të kapitalit të shoqërisë dhe në aftësinë e tij për të për të aksesuar kapital nga burime të jashtme. Vlerësimi i fitimeve merr në konsideratë nivelin (sasinë), burimet, qëndrueshmërinë dhe luhatjen e fitimeve.

Niveli	- a janë të arritshme objektivat e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit?
	- cili është niveli i konkurrencës në treg?
Burimet	- sa të diversifikuara janë burimet e fitimeve/të ardhurave të shoqërisë?
	- a është e përfshirë shoqëria në operacione të tjera të lidhura me veprimtarinë e sigurimit (ang. ancillary)?
	- a vjen ndonjë e ardhur nga biznesi me palët e lidhura?
Qëndrueshmëria	- a vjen ndonjë e ardhur nga burime jo të përsëritshme (ang. non-recurring),

- p.sh. përfitime kapitali të një here të vetme?
- në se po, cilat janë ato dhe sa e rëndësishme është mbështetja e shoqërisë tek to për të shfaqur kthime pozitive?
 - a i rrit shoqëria fitimet nëpërmjet interpretimeve të parimeve të kontabilitetit dhe/ose aktuariale?
 - cili është i niveli i konkurrencës në treg?
- Luhatjet
- a ka luhatje të mëdha të fitimeve nga periudha në periudhë?
 - cilat janë arsyet për luhatjet?
 - sa të diversifikuara janë burimet e të ardhurave të shoqërisë?
 - a është angazhuar shoqëria në veprimtari me rrezik të lartë?

Kur vlerësojnë të ardhurat, inspektorët duhet të kenë parasysh gjërat e mëposhtme:

- përdorimin e praktikave të tilla të kontabilitetit ose aktuariale të cilat deformojnë pozicionin financiar të shoqërisë;
- marrëveshje komplekse biznesi pa ndonjë interes të dukshëm biznesi;
- kalimi i buxhetit përtej mundësive të shoqërisë;
- mospërputhshmëri midis performancës dhe paraqitjes së situatës nga drejtuesit;
- paqartësia e drejtuesve për performancën e fitimeve;
- mospërputhjet e shpeshta midis drejtuesve dhe audituesve të jashtëm; dhe
- ndryshimet e shpeshta në provigjone, veçanërisht në tre mujorin e fundit të vitit, ose në se drejtuesit janë duke u larguar.

Sikurse kapitali, të ardhurat vlerësohen si të forta, të pranueshme ose të dobëta dhe gjendja e vlerësuar vlerësohet më tej si: në përmirësim, e qëndrueshme ose duke u përkeqësuar.

Fitime të forta

Shoqëria ka performancë të kënaqshme dhe të vazhdueshme të të ardhurave, duke patur kthime që kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në suksesin e saj afatgjatë, dhe kryesisht nuk ka ndonjë mbështetje tek burimet e të ardhurave të pa përsëritshme (ang. non-recurring) për të rritur fitimet. Parashikimi i të ardhurave për 12 muajt e ardhshëm është pozitiv.

Fitime të pranueshme

Shoqëria ka performancë të kënaqshme të të ardhurave, të cilat edhe pse tregojnë disa paqëndrueshmëri, në tërësi kanë patur kthimet e nevojshme për të siguruar suksesin afatgjatë të shoqërisë. Kryesisht nuk ka ndonjë mbështetje tek burimet e të ardhurave të pa përsëritshme (ang. non-recurring) për të rritur fitimet dhe megjithëse ka një farë ekspozimi ndaj paqëndrueshmërisë së fitimeve, parashikimi për 12 muajt e ardhshëm është pozitiv.

Fitime të dobëta

Shoqëria ka performancë të paqëndrueshme të të ardhurave, ku kthimet ndonjëherë nuk janë të mjaftueshme për të siguruar suksesin e saj afatgjatë. Ajo ka regjistruar shpesh humbje operationale dhe për të pasur një fitim është mbështetur tek burimet e pa përsëritshme (ang. non-

recurring) të të ardhurave. Parashikimi për fitimet për 12 muajt e ardhshëm është i pasigurt dhe ka mundësi të jetë negativ.

A.4.3 Rreziku i përbërë

Kapitali	Earnings		
Rreziku i përbërë	Drejtimi i rrezikut		Harku kohor

Klasifikimi i rrezikut të përbërë është një vlerësim i profilit të përgjithshëm të shoqërisë pas marrjes në konsideratë të ndikimit të kapitalit dhe fitimeve në rrezikun përgjithshëm neto të tij. Për rrezikun e përbërë shtojmë një nivel rreziku që vlerësimi të jetë më i detajuar. Rreziku i përbërë vlerësohet si i ulët, mesatar, mbi mesatar ose i lartë.

Rrezik i përbërë i ulët

Një shoqëri e fortë dhe e mirë menaxhuar. Ajo është elastike ndaj kushteve më të vështira të biznesit dhe atyre ekonomike. Performanca e saj ka qenë e mirë vazhdimisht, ku shumica e treguesve kyçë është mbi normat e industrisë, që i lejojnë asaj akses të gatshëm për kapital shtesë. Çdo shqetësim i mbikëqyrësit ka efekt të ulët në profilin e saj të rrezikut dhe mund të trajtohet në mënyrë rutinë. Normalisht një shoqëri sigurimi në këtë kategori, ka nivel rreziku agregat neto të ulët të kombinuar me nivel të pranueshëm kapitali dhe fitimesh, ose nivel mesatar rreziku agregat neto të kombinuar me nivel të fortë kapitali dhe të fitimeve. Kombinime të tjera mund të jenë të mundshme në varësi të rrethanave të shoqërisë.

Rrezik i përbërë mesatar

Një shoqëri e shëndoshë, në përgjithësi e menaxhuar mirë dhe elastike ndaj kushteve të vështira të biznesit dhe atyre ekonomike. Performanca e shoqërisë është e kënaqshme, ku treguesit kyç në përgjithësi i përmbushin pritshmëritë dhe janë të krahasueshëm me normat e industrisë, duke lejuar akses të pranueshëm ndaj kapitalit shtesë. Shqetësimet e mbikëqyrësit janë brenda mundësive të shoqërisë për t'u adresuar. Normalisht një shoqëri sigurimi në këtë kategori, ka nivel rreziku agregat neto të ulët të kombinuar me nivel të pranueshëm kapitali dhe fitimesh, ose nivel të lartë rreziku agregat neto të kombinuar me nivel të fortë të kapitalit dhe të fitimeve. Kombinime të tjera mund të jenë të mundshme në varësi të rrethanave të shoqërisë.

Rrezik i Përbërë mbi Mesataren

Shoqëria ka probleme që tregojnë një paralajmërim të hershëm ose që mund të çojë në një rrezik për shëndetin e saj financiar. Është e prekshme nga kushtet e vështira të biznesit dhe ato ekonomike. Performanca e saj është e pakënaqshme ose duke u përkeqësuar, me disa tregues kyç në nivelet e kufijve minimalë ose pak më poshtë, duke dëmtuar aftësinë e saj për të ngritur kapital shtesë. Shoqëria ka probleme në administrimin e rrezikut të saj të tilla që, megjithëse jo aq shumë të rënda sa të paraqesin një kërcënim të menjëhershëm për shëndetin financiar apo për aftësinë paguese, mund të shndërrohen në probleme serioze në qoftë se nuk do të trajtoheshin menjëherë. Normalisht një shoqëri sigurimi në këtë kategori, ka nivel rreziku agregat neto mesatar, i cili nuk zbutet mjaftueshëm nga kapitali dhe fitimet (i pranueshëm), ose nivel të ulët

rreziku agregat neto të kombinuar me nivel kapitali dhe të fitimeve, që kërkon përmirësim (i dobët). Kombinime të tjera mund të jenë të mundshme në varësi të rrethanave të shoqërisë.

Rrezik i Përbërë i Lartë

Shoqëria ka shqetësime të rënda të sigurisë dhe të shëndetit financiar. Është e prekshme nga shumica e kushteve të vështira të biznesit dhe ato ekonomike, duke paraqitur një kërcënim të rëndë për shëndetin e saj financiar dhe aftësinë paguese, nëse nuk zbatohen masa mbikëqyrëse efektive në mënyrë të menjëhershme. Performanca e saj është e dobët, me shumicën e treguesve kyç poshtë normave të industrisë, duke dëmtuar rëndë aftësinë e saj për akses ndaj kapitalit shtesë. Normalisht një shoqëri sigurimi në këtë kategori, ka nivel rreziku agregat neto të lartë, i cili nuk zbutet mjaftueshëm nga kapitali dhe fitimet (i pranueshëm/i dobët), ose nivel mesatar rreziku agregat neto të kombinuar me nivel kapitali dhe të fitimeve, që kërkon përmirësim (i dobët). Kombinime të tjera mund të jenë të mundshme në varësi të rrethanave të shoqërisë.

Siç është vënë në dukje në diagramën e vlerësimit të rrezikut neto, të ilustruar në faqen 40, diagrama e vlerësimit të rrezikut të përbërë më poshtë sugjeron vlerësimet që mund të priten, duke pasur parasysh një kombinim të veçantë të vlerësimeve të pjesëve përbërëse, por, nuk duhet të përdoret si një përcaktues absolut i nivelit të rrezikut.

Diagrama e Vlerësimit të Rrezikut të Përbërë

Rreziku Agregat Neto	Kapitali dhe fitimet		
	I fortë	I pranueshëm	I dobët
I ulët	I ulët	I ulët/Mesatar	Mesatar/Mbi Mesatar
Mesatar	I ulët	Mesatar/Mbi Mesatar	I lartë
I lartë	I ulët/Mesatar	Mbi Mesatar/I lartë	I lartë

Pasi të vlerësohet niveli i rrezikut të përbërë, duhet marrë në konsideratë nëse ai do të ulët, do të mbetet i qëndrueshëm apo do të rritet nga niveli i vlerësuar aktualisht. Ky vlerësim është një funksion i atyre që janë bërë për drejtimin e rrezikut të përgjithshëm neto, kapitalin dhe fitimet.

Vlerësimi përfundimtar që i bëhet rrezikut të përbërë është periudha kohore në të cilin do të mbeten të vlefshme vlerësimet aktuale të nivelit dhe drejtimit të rrezikut. Kur tregu është i qëndrueshëm dhe shoqëria nuk është duke konkurruar fort për pjesën e saj në treg, vlerësimi i rrezikut të përbërë mund të mbetet i vlefshëm për disa periudha financiare radhazi. Megjithatë, paqëndrueshmëria e shoqërisë ose e tregut mund të kërkojnë që vlerësimi të rishikohet në një kohë shumë më të shkurtër. Disa konsiderata:

- priten ndryshime në shoqëri, p.sh., riorganizim, produkte të reja ose aktivitete të reja?
- nëse po, a pritet që ato të jenë të konsiderueshme dhe sa shpejt mund të ndodhin?

- priten ndryshime në kushtet ekonomike ose të veprimtarisë së shoqërisë, p.sh., rënie ekonomike ose konkurrentë të rinj?

Të gjitha klasifikimet duhet të dokumentohen mirë dhe të justifikohen, sepse pavarësisht se çfarë kombinimesh specifike të parametrave përdoren, ata bazohen tek gjykimi. Në qoftë se do të zhvillohen diskutime efektive dhe kuptimplotë me drejtuesit e shoqërisë dhe këshillin, të gjitha gjykimet duhet të mbështeten në vëzhgime dhe të dhëna të bazuara në fakte.

A. 5 Faza V Njoftimi i gjetjeve të Inspektimit dhe Letra për drejtuesit

A. 5. 1 Njoftimi i gjetjeve të Inspektimit

Mbikëqyrësi në përfundim të inspektimit, por përpara largimit nga shoqëria, i njofton kësaj të fundit gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Shoqëria brenda afatit të përfundimit të inspektimit ka të drejtë të parashtrojë observacionet e saj, nëse ka të tilla, Pas shqyrtimit të këtyre observacioneve, mbikëqyrësi harton letrën për drejtuesit.

Një model i [letrës për drejtuesit](#) është përfshirë tek ilustrimet.

A. 5. 2 Letra për drejtuesit

[Letra për drejtuesit](#) përdoret për t'i paraqitur drejtuesve të shoqërisë rezultatet e inspektimit. Ajo duhet të jetë konçize, të trajtojë vetëm ato çështje që kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve nga ana e drejtuesve. Letrat për drejtuesit nuk duhet të jenë me dy kuptime apo të paqarta, por duhet të jenë të thjeshta për t'u lexuar dhe kuptuar. Janë katër pika që duhet të ngrihen në të gjitha letrat për drejtuesit:

1. Gjetjet. Duhet të përshkruhen qartë problematikat që janë konstatuar nga inspektimi dhe që duhen rregulluar, p.sh., “nga zhvillimi i të dhënave të dëmeve duket qartë se provigjonet e dëmeve të shoqërisë janë nënvlerësuar nga 10 deri 15%”;
2. Përse duhet të rregullohen problematikat e evidentuara (efekti tek shoqëria). Letra për drejtuesit duhet të parashtrojë efektin e problemit tek shoqëria, p.sh., “nënvlerësimi i provigjoneve të dëmeve çon në mbivlerësim të marzhit të aftësisë paguese, duke deformuar paraqitjen e gjendjes financiare të shoqërisë”;
3. Çfarë duhet bërë (rekomandimet). Menaxhimit të lartë të shoqërisë i kërkohet të marrë masa të korrigjojnë problemin. Në këtë mënyrë shoqëria njihet me gjetjet dhe problematikat kryesore dhe ka mundësi të reagojë në kohë për korrigjimin e situatës.

Çështje të ‘mirëmbajtjes’, d.m.th., ato që duhen korrigjuar por që nuk përfaqësojnë ndonjë kërcënim për shëndetin financiar të shoqërisë, nuk duhet të përfshihen në letrën për drejtuesit, e cila përmban konstatime dhe rekomandime të rëndësishme. Përfshirja e këtyre pikave të vogla e zvogëlon rëndësinë e konstatimeve të rënda.

Letra për drejtuesit duhet të dërgohet nga rregullatorët tek menaxhimi i lartë dhe këshillit, me një kërkesë që një kopje t'i jepet audituesit të jashtëm të shoqërisë. Me letër të veçantë, audituesi i jashtëm, duhet të informohet se është dërguar letra për drejtuesit dhe të drejtohet pranë shoqërisë për një kopje.

Në qoftë se përgjigjja e shoqërisë është e kënaqshme, d.m.th., veprimet e ndërmarra ose që do të ndërmerren janë të pranueshme, inspektori duhet të përgjigjet duke pranuar se veprimet e shoqërisë duken të pranueshme. Por, kjo do të vlerësohet në inspektimin tjetër të programuar.

A. 6. Faza VI Përditësimi i Përparësive dhe Profilit Përmbledhës të Siguruesit

A. 6. 1 Vendosja e Përparësive dhe Profili Përmbledhës i Siguruesit

Gjetjet përkatëse dhe të rëndësishme që dalin gjatë vlerësimit të rrezikut dhe çdo aktiviteti tjetër inspektimi, duhet të përdoren dhe të përfshihen në përcaktimet e prioritetit të siguruesit. Rezultatet e inspektimit dhe/ose gjetjet janë elemente kyç që duhet të konsiderohen kur përditësohen prioritetet dhe Profili Përmbledhës i Siguruesit, pasi aftësia paguese ose kushtet e menaxhimit të zbardhura në këto raporte dhe në dokumentacionin e mbledhur gjatë analizës financiare duhet të përcaktojnë punën e ardhshme monitoruese.

Vendosja e përparësive

Vendosja e përparësive për siguruesit është një proces cilësor dhe sasior dhe mund të kryhet nëpërmjet përdorimit të aplikimeve të ndryshme, duke përfshirë Testet e Paralajmërimit të Hershëm (ang. Early Warning Test), rezultatet e inspektimit e të tjera në dispozicion. Është e rëndësishme që vendosja e përparësive të mos jetë një ushtrim thjesht mekanik. Në një mjedis me fokus rrezikun, gjykimi i mirë, i informuar është thelbësor. Mbikëqyrësit duhet të përdorin njohuritë e tyre të thelluara për shoqërinë, për të përcaktuar nëse niveli i përparësisë së treguar nga numrat është i drejtë apo jo për atë shoqëri.

Profili Përmbledhës i Siguruesit

Të paktën një herë në vit [profili përmbledhës i siguruesit](#), një model i së cilit përfshihet tek ilustrimet, duhet të përditësohet duke përdorur rezultatet e inspektimeve të fundit dhe procesin e analizës vjetore dhe tre mujore. Përmbledhja duhet të jetë konçize dhe të skicojë çdo shqetësim në vazhdim, mbledhje apo aktivitete të tjera të planifikuara, pikat e forta dhe të dobëta të shoqërisë siç janë vëzhguar nga grupi i inspektimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

A. 6. 2 Shkalla e Ndërhyrjes

Pas vlerësimit dhe evidentimit të rrezikut, nga ana e mbikëqyrësit bëhet përcaktimi i rrethanës/rrethanave konkrete për marrjen e masave të mbikëqyrjes dhe masa që gjykohet e përshtatshme për parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen këtyre rrethanave.

Vlerësimi i rrethanave dhe marrja e masave të mbikëqyrjes duhet të jenë në proporcion me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, duke përfshirë dhe aktivitete që paraqesin risk sistematik.

Masat e mbikëqyrjes duhet të jenë:

- të efektshme e të përshtatshme për parandalimin, korrigjimin apo ndërprerjen këtyre rrethanave, duke ndërhyrë në kohë veçanërisht kur rrethanat janë të tilla që vendosin të siguruarit në situatë me risk apo pengojnë mbikëqyrjen;
- në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës;
- në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në funksion të ndikimit pozitiv në interesat e të siguruarve;
- të përshkallëzuara, veçanërisht nëse situata përkeqësohet apo shoqëria e sigurimit nuk reagon për të zbatuar masat korrigjuese dhe parandaluese të urdhëruara nga Autoriteti.

Autoriteti sigurohet që të jetë transparent në ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes dhe marrjen e masave.

Në tabelën e mëposhtme, jepen orientime për mbikëqyrësin në vlerësimin e rrethanave për marrjen e masave të mbikëqyrjes dhe përcaktimin e masës të mbikëqyrjes.

Rreziku i përbërë	Rrethanat për marrjen e masave të mbikëqyrjes	Masat e mbikëqyrjes
I Lartë	• Shoqëria e sigurimit është sipas vlerësimit të Autoritetit, e paaftë të përmbushë detyrimet e saj kur ju vjen afati apo bëhen të kërkueshme; • Aktivitetet e shoqërisë nuk janë të mjaftueshme për të garantuar një mbrojtje të përshtatshme për të siguruarit dhe kreditorët; • Rrezikohen interesat e të siguruarve dhe/ose niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • Shoqëria e sigurimit është e paaftë të përmbushë kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit sipas nenit 80, të ligjit, përfshirë kërkesat për fondin e garancisë sipas nenit 81 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • Shoqëria e sigurimit nuk ka zbatuar urdhrin e dhënë, sipas nenit 153, pika 1, shkronja “l”, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • Shoqëria e sigurimit nuk përmbush kushtet për ushtrimin e veprimtarisë	• Urdhëron kryerjen apo ndalimin e një ose disa veprimeve të përcaktuara në germet b), c), d), dh), ë), g), gj), i), j), k), l), të pikës 1, si dhe pikës 3 të nenit 153 të ligjit nr. 52/2014. • nxjerr urdhër për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive duke urdhëruar arritjen e menjëhershme të nivelit të kapitalit sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, nëse niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. • Autoriteti mund të kërkojë nga audituesi i jashtëm, me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit, të kryejë një auditim të veçantë që lidhet me përshtatshmërinë e procedurave të shoqërisë së sigurimit për të mbrojtur kreditorët, aksionarët dhe të siguruarit e saj apo çdo auditim tjetër në interes të publikut dhe t'i raportojë Autoritetit për këtë; • kërkon shqyrtim të jashtëm, nëpërmjet një aktuari të autorizuar të pavarur, të metodave dhe supozimeve aktuariale të përdorura nga shoqëria e sigurimit, me shpenzimet e mbuluara nga kjo e fundit, ose mund të kërkojë që një aktuar i

	së sigurimit; • Shoqëria e sigurimit shkel rregullat e administrimit të rrezikut përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 151 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • Shoqëria e sigurimit, e urdhëruar të marrë një ose disa masa të mbikëqyrjes, nuk ka filluar zbatimin e këtyre masave ose nuk i ka zbatuar ato brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti; • Shoqëria e sigurimit, pavarësisht zbatimit të masave të mbikëqyrjes, nuk ka arritur ende nivelin e kërkuar të aftësisë paguese ose nuk përmbush përcaktimet e dispozitave të neneve 80 dhe/ose 81 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • veprimtaria e mëtejshme e shoqërisë së sigurimit rrezikon likuiditetin, aftësinë paguese të saj ose sigurinë e të siguruarit. • Janë hapur procedurat e falimentimit në Shqipëri, apo diku tjetër, në rast kur kemi të bëjmë me grup; • shoqëria e sigurimit shkel dispozitat e këtij ligji apo akteve të Autoritetit në fushën e sigurimeve;	pavarur apo i jashtëm të kryejë shqyrtimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve të shoqërisë së sigurimit; • Autoriteti, në përputhje me dispozitat e nenit 136, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, cakton punonjësit e autorizuar për inspektim në shoqërinë e sigurimit për të monitoruar situatën në vazhdimësi; • vendos shoqërinë e sigurimit apo aktivet e saj në administrim të përkohshëm; • vendos për revokim të plotë apo të pjesshëm të licencës. • vendos hapjen e procedurave të likuidimit të detyrueshëm të shoqërisë së sigurimit
Mbi Mesatar	• shoqëria e sigurimit pritët të jetë, sipas vlerësimit të Autoritetit, e paaftë të përmbushë detyrimet e saj kur ju vjen afati apo bëhen të kërkueshme; • Rrezikohen interesat e të siguruarve dhe/ose niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • shoqëria e sigurimit pritët të jetë e paaftë të përmbushë kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit sipas nenit 80, të ligjit, përfshirë kërkesat	• Përfaqësues të AMF-së takohen me menaxhimin dhe drejtuesit e siguruesit për të paraqitur shqetësimet dhe për të diskutuar veprimet që gjykohen të nevojshme për t’u ndërmarrë. • urdhëron shoqërinë e sigurimit apo personin përgjegjës të ndalojë të kryejë një veprim të caktuar ose të ndjekë një sjellje etike biznesi të caktuar apo e urdhëron që të kryejë një veprim të caktuar që, sipas gjykimit të Autoritetit, është i nevojshëm për përmirësimin e situatës dhe/ose për parandalimin ose korrigjimin e shkeljeve të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit

	për fondin e garancisë sipas nenit 81 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • aktivet e pasqyruara në librat kontabël të shoqërisë së sigurimit apo aktivet që mbahen nën administrimin e saj nuk janë kontabilizuar saktë; • shoqëria e sigurimit nuk vijon të përmbushë një ose disa nga kërkesat fillestare të marrjes së licencës; • shoqëria e sigurimit mund të mos përmbushë kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit; • shoqëria e sigurimit shkel rregullat mbi mbajtjen e librave të kontabilitetit dhe/ose regjistrave tregtarë, si dhe ato që lidhen me raportimin periodik, auditimin e brendshëm apo auditimin e pasqyrave vjetore; • shoqëria e sigurimit gjendet në një situatë të tillë, në Shqipëri, apo diku tjetër në rast kur kemi të bëjmë me grup, që mund të dëmtohen interesat e të siguruarve, kreditorëve apo zotëruesve të aktiveve nën administrimin e shoqërisë; • shoqëria e sigurimit shkel dispozitat e këtij ligji apo akteve të Autoritetit në fushën e sigurimeve;	dhe risigurimit” dhe akteve të Autoritetit; Urdhri i Autoritetit mund të përmbajë një ose disa nga kufizimet e përcaktuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 153 të ligjit nr. 52/2014. • nxjerr urdhër për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive; • i kërkon shoqërisë së sigurimit të depozitojë një plan rimëkëmbjeje financiare, të përcaktuar në nenin 83, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” për përmbushjen e kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit, si dhe mund të urdhërojë rritjen e menjëhershme të nivelit të kapitalit sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, nëse niveli i kapitalit nuk është i mjaftueshëm, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 81, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; • i kërkon shoqërisë së sigurimit të auditojë veprimtarinë financiare nga një auditues i zgjedhur nga Autoriteti, por me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit, ose urdhëron shoqërinë e sigurimit të shkarkojë një auditues dhe të emërojë një tjetër, sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti ose i kërkon audituesit të jashtëm të zgjerojë objektin e auditimit apo të kryejë procedura të tjera dhe të përgatitë një raport për Autoritetin; Përveç kësaj Autoriteti gjithashtu, mund të kërkojë nga audituesi i jashtëm, me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit, të kryejë një auditim të veçantë që lidhet me përshtatshmërinë e procedurave të shoqërisë së sigurimit për të mbrojtur kreditorët, aksionarët dhe të siguruarit e saj apo çdo auditim tjetër në interes të publikut dhe t’i raportojë Autoritetit për këtë; • mund të kërkojë një rivlerësim të vlerës së aktiveve, të cilat janë marrë parasysh në llogaritjen e kapitalit të shoqërisë së sigurimit, në rastin kur ka pasur një ndryshim të konsiderueshëm të vlerës së tregut për këto elemente në krahasim me vitin paraardhës financiar;
--	---	---

- i kërkon shoqërisë së sigurimit të kryejë vlerësim të disa apo të gjithë aktiveve të saj apo të ndonjë prej shoqërive të kontrolluara të saj. Ky vlerësim mund të kryhet nga Autoriteti ose nga një ekspert i emëruar nga Autoriteti me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit;
- i kërkon shoqërisë së sigurimit informacion shtesë në çdo kohë dhe në formën që Autoriteti e gjykon të nevojshme dhe/ose kërkon rritjen e shpeshtësisë së raportimit në Autoritet dhe/ose kryen inspektimet përkatëse që lidhen me raportimet në fjalë;
- kërkon shqyrtim të jashtëm, nëpërmjet një aktuari të autorizuar të pavarur, të metodave dhe supozimeve aktuariale të përdorura nga shoqëria e sigurimit, me shpenzimet e mbuluara nga kjo e fundit, ose mund të urdhërojë shoqërinë e sigurimit të modifikojë metodat apo supozimet e saj aktuariale, duke bërë rivlerësim të provigjoneve, ose mund të kërkojë që një aktuar i pavarur apo i jashtëm të kryejë shqyrtimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve të shoqërisë së sigurimit;
- i kërkon shoqërisë së sigurimit të kalojë në risigurim përgjegjësitë, të cilat tejkalojnë mbulimin maksimal, sipas përcaktimeve të nenit 116 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
- Autoriteti, zgjeron objektin dhe rrit shpeshtësinë e inspektimeve në vend, në përputhje me dispozitat e nenit 136, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ose cakton punonjësit e autorizuar për inspektim në shoqërinë e sigurimit për të monitoruar situatën në vazhdimësi;
- mund të kërkojë rillogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, duke u bazuar mbi risigurimin apo retrocedimin, nëse natyra apo cilësia e kontratave të risigurimit apo retrocedimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, krahasuar me vitin e mëparshëm financiar, ose nëse këto

		kontrata nuk mundësojnë një transferim të ekuilibruar të rrezikut; - Autoriteti mund të këshillojë shoqërinë e sigurimit të ndërmarrë veprime të caktuara ose të rregullojë linjën e disa veprimeve të saj, përveç atyre të përcaktuara në nenet 150, 151, 152 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. - Të paktën njëherë në muaj Bordi i AMF përditësohet me progresin dhe situata diskutohet në mbledhjet e bordit - AMF fillon planifikimin urgjent për hapat e mëtejshëm, në rast se profili i rrezikut të shoqërisë rritet
Mesatar	- aktivet e pasqyruara në librat kontabël të shoqërisë së sigurimit apo aktivet që mbahen nën administrimin e saj nuk janë kontabilizuar saktë; - shoqëria e sigurimit nuk vijon të përmbushë një ose disa nga kërkesat fillestare të marrjes së licencës; - shoqëria e sigurimit shkel detyrimin për raportim dhe njoftim në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; - shoqëria e sigurimit shkel rregullat në lidhje me emërimin e aktuarit të autorizuar; - anëtarë i këshillit nuk ka marrë miratimin, sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. - personi i përcaktuar në nenin 17, të këtij ligji, nuk vijon të përmbushë në vazhdimësi një ose disa nga kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi për të mbajtur pozicionin e caktuar; - shoqëria e sigurimit shkel dispozitat e këtij ligji apo akteve të Autoritetit në fushën e sigurimeve; . - Mangësi në politika dhe procedura, ose ekzistenca e kushteve apo rrethanave, që mund të sjellin	- Shoqëria njoftohet për shqetësimet dhe i kërkohet të paraqesë një plan për t'i trajtuar ato - urdhëron shoqërinë e sigurimit apo personin përgjegjës të ndalojë të kryejë një veprim të caktuar ose të ndjekë një sjellje etike biznesi të caktuar apo e urdhëron që të kryejë një veprim të caktuar që, sipas gjykimit të Autoritetit, është i nevojshëm për përmirësimin e situatës dhe/ose për parandalimin ose korrigjimin e shkeljeve të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe akteve të Autoritetit; Urdhri i Autoritetit mund të përmbajë kufizimet e përcaktuara në gërmat i) dhe e), të pikës 1, si dhe pikës 3 të nenit 153 të ligjit nr. 52/2014. - nxjerr urdhër për eliminimin e shkeljeve dhe parregullsive; - i kërkon shoqërisë së sigurimit të auditojë veprimtarinë financiare nga një auditues i zgjedhur nga Autoriteti, por me shpenzimet e shoqërisë së sigurimit, ose urdhëron shoqërinë e sigurimit të shkarkojë një auditues dhe të emërojë një tjetër, sipas kushteve të përcaktuara nga Autoriteti ose i kërkon audituesit të jashtëm të zgjerojë objektin e auditimit apo të kryejë procedura të tjera dhe të përgatitë një raport për Autoritetin; - kërkon shqyrtim të jashtëm, nëpërmjet një aktuari të autorizuar të pavarur, të metodave dhe supozimeve aktuariale të

	përkeqësim të profilit të rrezikut Situata është e tillë që mund të rregullohet përpara se të kalojë në një nivel më të lartë rreziku	përdorura nga shoqëria e sigurimit, me shpenzimet e mbuluara nga kjo e fundit, ose mund të urdhërojë shoqërinë e sigurimit të modifikojë metodat apo supozimet e saj aktuariale, duke bërë rivlerësim të provigjoneve, ose mund të kërkojë që një aktuar i pavarur apo i jashtëm të kryejë shqyrtimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve të shoqërisë së sigurimit; - i kërkon shoqërisë së sigurimit të kalojë në risigurim përgjegjësitë, të cilat tejkalojnë mbulimin maksimal, sipas përcaktimeve të nenit 116 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; - i kërkon shoqërisë së sigurimit informacion shtesë në çdo kohë dhe në formën që Autoriteti e gjykon të nevojshme dhe/ose kërkon rritjen e shpeshtësisë së raportimit në Autoritet dhe/ose kryen inspektimet përkatëse që lidhen me raportimet në fjalë; - Autoriteti, zgjeron objektin dhe rrit shpeshtësinë e inspektimeve në vend, në përputhje me dispozitat e nenit 136, të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; - mund të kërkojë rillogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të shoqërisë së sigurimit, duke u bazuar mbi risigurimin apo retrocedimin, nëse natyra apo cilësia e kontratave të risigurimit apo retrocedimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, krahasuar me vitin e mëparshëm financiar, ose nëse këto kontrata nuk mundësojnë një transferim të ekuilibruar të rrezikut; - Autoriteti mund të këshillojë shoqërinë e sigurimit të ndërmarrë veprime të caktuara ose të rregullojë linjën e disa veprimeve të saj, përveç atyre të përcaktuara në nenet 150, 151, 152 të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
I Ulët	Shqetësim i vogël i mbikëqyrësit që mund të trajtohet në mënyrë rutinë.	- Rishikohen raportimet financiare dhe raportimet e tjera të depozituara; - Inspektime në vend me frekuencë të

		ulët; • Mbahen kontakte me shoqërinë nëpërmjet vizitave periodike për diskutime të nivelit të lartë me menaxhimin e lartë • Monitorohet për të zbuluar ndonjë fushë që mund të shfaqet me rrezik;
--	--	--

ANEKS 1

ILUSTRIME

[Profili Përmbledhës i Siguruesit](#)

[Pyetësi i Planifikimit të Inspektimit](#)

[Kuptimi i Strukturës së Qeverisjes së Shoqërisë](#)

[Procedurat e Rishikimit Analitik](#)

[Matrica e rrezikut](#)

[Letra për drejtuesit](#)

[Pasqyra e Zhvillimit të Dëmeve](#)

Profili përmbledhës i siguruesit

Profili përmbledhës i siguruesit duhet të hartohet për çdo sigurues brenda vendit dhe të përditësohet sipas nevojave gjatë gjithë vitit. Profili përmbledhës i siguruesit duhet të jetë konçiz dhe duhet të përmbajë informacionin e marrë nga cikli mbikëqyrës me fokus rrezikun. Një format i propozuar për profilin përmbledhës të siguruesit jepet më poshtë. Duhet të disponohet një version aktual, për rishikim nga i gjithë stafi i mbikëqyrës së AMF-së, sipas kërkesës.

Shembull:

Shoqëria e sigurimeve ABC

Shoqëria e sigurimeve ABC (ABC) Rruga "X" Qyteti Y Shqipëri Lloji i siguruesit: Jojetë	Përmbledhje e biznesit Shoqëria e sigurimeve ABC disponon një gamë të gjerë produktesh sigurimi për pronën dhe përgjegjësitë dhe shërbimesh për bizneset, shoqatat dhe individët. Ajo siguron/nuk siguron rreziqet jashtë Shqipërisë. Mbulimi parësor më i madh është sigurimi i automjeteve, që përbën 83% të primeve të fituara. Komponentët kryesorë të portofolit të sigurimit të automjeteve janë DMTPL, që përbën 59%, dhe Kartoni Jeshil, që përbën 17%.
--	---

Përparësia e departamentit: [#]

Gjetjet rregullatore

Në inspektimin e fundit, shoqëria është cituar për manipulim të provigjoneve të dëmeve dhe mangësi të dokumentacionit që mbështet marrëveshjet me palët e lidhura. Letra për drejtuesit, nga inspektimi i fundit, ka venë në dukje dobësi në kontrollet e brendshme që lidhen me pagesat dhe regjistrimin e dëmeve. Shoqëria ra dakord që të forconte dhe të rriste kontrollet në departamentin e dëmeve.

Plani rregullator

- **Frekuenca e inspektimit** – Inspektimi i fundit u krye në [datën] dhe inspektimi tjetër është planifikuar që të kryhet në [datën].
- **Fushat që kanë shqetësime: Provigjonimi i dëmeve** – Shoqëria duket se i manipulon rezultatet e saj të marrjes në sigurim në favorin e saj duke mos i provigjionuar siç duhet dëmet e raportuara.
- **Agjenda e mbledhjeve të planifikuara me shoqërinë** – Mbledhja me drejtuesit e shoqërisë është planifikuar për 3 mujorin e katërt pranë zyrave të AMF-së, në 15 dhjetor [viti].

Informacion i jashtëm

- Opinioni i auditit të jashtëm - Shiko Raportin Vjetor; [emri i audituesit të jashtëm]
- Raporti i aktuarit të pavarur; [emri i aktuarit]

Vlerësimi i Grupit të Sigurimit

ABC zotërohet tërësisht nga mëma, Shoqëria XYZ. Shoqëria XYZ ka lëshuar një garanci për të mbuluar detyrimet e ABC. Shoqëria XYZ është e mirëkapitalizuar dhe ka qenë shumë fitimprurëse në 5 vitet e fundit.

Shoqëria e sigurimit ABC (ABC) Të Dhëna Financiare Kyçe – Pikat e Forta dhe Pikat e Dobëta

Pikat e Forta – Cash flow pozitiv, shoqëria mëmë e fortë, me garanci nga mëma

Pikat e Dobëta – Kapital rregullator në rënie , likuiditet i varfër, fitueshmëria e dobët në 3 vitet e fundit

Përmbledhje e Shoqërisë së Sigurimit ABC:

Ky seksion do të përmbajë komentet e bazuara në të gjithë informacionet e mësipërme. Komentet mund të trajtojnë një nga çështjet e mëposhtme:

Shoqëria ka humbur para, ose mjaftueshmëria e provigjoneve të dëmeve, nëse risigurimi luan një rol të rëndësishëm, ose transaksione/aktive të rëndësishme midis shoqërive brenda grupit. Me fjalë të tjera, përdoruesi i informacionit duhet të kuptojë gjendjen financiare dhe veprimtarinë e shoqërisë.

Pyetësi i Planifikimit të Inspektimit

Pyetësi i Planifikimit të Inspektimit përmban procedura dhe pyetje që janë hartuar për të ndihmuar inspektorin për të mbledhur informacionin e nevojshëm të planifikimit dhe për të kuptuar organizatën e siguresit. Inspektori duhet ta plotësojë këtë pyetësor sa më herët që të jetë praktike në fazën e planifikimit. Për të ndihmuar në plotësimin e tij, do të ishte me vend që të përdorej personeli i siguresit. Nëse do të jetë kështu, përgjigjet për këtë pyetësor duhet të vlerësohen në mënyrë kritike. Përgjigjet e pyetësorit duhet të konsiderohen kur përcaktohet vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut. Ato duhet të kenë ndikim edhe në qasjen e inspektimit të planifikuar dhe në natyrën, kohën dhe masën e procedurave të inspektimit të kryer.

Të gjitha pyetjet duhet të trajtohen plotësisht duke përdorur fleta shtesë nëse është e nevojshme.

I. NDIKIMET E PRONËSISË DHE DREJTIMIT

A. Përqendrimi i Pronësisë

Përshkruani përqendrimin e pronësisë duke përfshirë numrin e përafërt të aksionarëve, ndonjë aksionar të rëndësishëm apo ndryshime në pronësi, nëse aksionet tregtohen aktivisht dhe cilat janë interesat e menaxhimit në pronësi.

B. Këshilli

Përshkruani përbërjen e këshillit duke përfshirë numrin e drejtorëve, lidhjet e drejtorëve të jashtëm, marrëdhëniet e secilit drejtor me organizatën dhe numrin e viteve si drejtor. Përfshini anëtarët e këshillit që kanë shërbyer në çdo kohë gjatë periudhës që shqyrtohet.

C. Komiteti i Auditit

Jepni informacion për komitetin e auditit, nëse ka. Informacioni i dhënë duhet të përfshijë:

- numrin e anëtarëve që shërbejnë në komitet;
- emrat e anëtarëve të komitetit të auditit të cilët mund të cilësohen si ekspertë financiarë sepse mbajnë një certifikatë kontabiliteti dhe janë punësuar më parë në rolin e mbikëqyrjes financiare;

Po	Jo	Jep Shpjegime

	Po	Jo	Jep Shpjegime
c) numrin e anëtarëve që nuk janë pjesë e drejtimit të shoqërisë dhe nuk kanë marrëdhënie biznesi me shoqërinë.			
D. Detyrat e Këshillit dhe Komiteteve të tij			
1. Siguroni një ekstrakt të aktit të themelimit dhe aktet nënligjore që parashikojnë përshkrimin e detyrave të caktuara dhe të kryera nga këshilli.			
2. Siguroni inventarin e politikave të shpallura/deklaruara.			
3. Siguroni provat e veprimtarive të mëposhtme të këshillit:			
a) a e monitoron këshilli etikën profesionale dhe pavarësinë nga lëshuesit e raporteve të auditit?			
b) a e mbikëqyr këshilli punën e auditit (të brendshëm dhe të jashtëm)?			
c) a përgjigjet këshilli për pranimin dhe vazhdimin e angazhimeve të auditit?			
4. Siguroni prova për aktivitetet e mëposhtme të komitetit të auditit, nëse ka.			
a) a përgjigjet komiteti për miratimin e të gjithë shërbimeve të auditit dhe jo të auditit që kryhen nga audituesi i jashtëm i shoqërisë?			
b) a është të paktën njëri prej anëtarëve të komitetit ekspert financiar?			
E. Kultura			
1. Siguroni deklaratën formale të misionit të shoqërisë, duke shënuar elementet në lidhje me përputhshmërinë, etikën dhe vlerat.			
2. Si e vendosin këshilli dhe drejtuesit “tonin nga sipër (ang. tone at the top)” dhe si i komunikojnë përputhshmërinë, etikën, vlerat, misionin dhe vizionin?			

II. ORGANIZIMI DHE PRAKTIKAT E PERSONELIT

A. Organizimi

1. Jepni detaje të strukturës së shoqërisë, duke përfshirë:
 - a) organigramën e shoqërisë (me njësitë ligjore/të biznesit);
 - b) tabelën organizative të personelit;
 - c) tabelën organizative që detajon strukturën e veprimtarive kyçe të biznesit që përfshijnë individët që përgjigjen për çdo veprimtari.
2. A pasqyrojnë qartë tabelat fushat e përgjegjësisë dhe linjat e raportimit dhe komunikimit? Nëse jo, jepni një shpjegim tregues që përshkruan linjat e komunikimit.
3. Nëse disponohet, siguroni një kopje të politikës formale të konfliktit të interesit. Jepni informacion për elementët e më poshtëm në lidhje me politikën e konfliktit të interesit:
 - a) a kërkon politika e konfliktit të interesit deklarime periodike nga funksionarët kryesorë?
 - b) përshkruani sistemin e përdorur për të monitoruar përputhshmërinë me politikën e konfliktit të interesit;
 - c) cili pozicion në organizatë siguron mbikëqyrjen dhe drejtimin në funksionin e përputhshmërisë/etikës dhe ku ndodhet ky pozicion në organigramë?
4. A ka shoqëria një kuadër të shkruar të qeverisjes së shoqërisë? Nëse po, a është struktura e qeverisjes së shoqërisë:
 - a) e miratuar dhe e mbikëqyrur nga këshilli i përfshirë?
 - b) e zbatuar dhe e monitoruar nga drejtuesit ekzekutivë?

[illegible]

	Po	Jo	Jep Shpjegime
c) e synuar për identifikimin dhe për mbushjen e objektivave të shëndosha etike, strategjike dhe financiare?			
d) e përforcuar nga zbatimi i fortë i parimeve të shëndosha të ndarjes së autoriteteve?			
e) objektive në raportimin e gjetjeve për këshillin apo komitetet përkatëse të tij? Kush përgjigjet për raportimin që i bëhet këshillit?			
B. Personeli			
1. A ka pasur lëvizje të mëdha tek drejtuesit? Nëse po, dokumentoni arsyet.			
2. Për sa kohë kanë qenë në pozicionet aktuale drejtuesit në shoqëri?			
3. A është i lidhur ndonjë nga punonjësit me ndonjë shoqëri që është shpallur pa aftësi paguese?			
4. A ka ndonjë person të lidhur të punësuar në shoqëri? Nëse po, jepni emrat, emërtimin e detyrës së tyre dhe marrëdhënien.			
III. VEPRIMTARITË E AUDITIT TË BRENDSHËM DHE KONTROLLET E BRENDSHME			
A. Audit i Brendshëm			
1. A ka shoqëria njësi të auditit të brendshëm?			
2. A planifikohet paraprakisht objekti i auditit të brendshëm me funksionarët kryesorë, këshillin apo komitetin e auditit? Në qoftë se aktivitetet planifikohen me funksionarët kryesorë, përshkruani se si mbetet i pavarur departamenti i auditimit të brendshëm.			
3. A përgatisin dhe ndjekin audituesit e brendshëm programe auditimi të shkruara? Këto programe:			
a. a sigurojnë shqyrtime dhe vlerësime objektive, të pavarura të veprimtarive të siguruesit, kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të administrimit të informacionit (MIS)?			

	Po	Jo	Jep Shpjegime
b. a ndihmojnë për të ruajtur dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes së shoqërisë?			
c. a garantojnë siguri të arsyeshme për saktësinë dhe përpikmërinë në kohë të regjistrimit të transaksioneve dhe saktësinë dhe plotësinë e raporteve financiare rregullatore?			
4. A kanë audituesit e brendshëm akses të drejtpërdrejtë tek:			
a. Menaxhimi lartë?			
b. Këshilli?			
c. Komiteti i auditit?			
d. Drejtuesit përkatës?			
5. A dokumentohen përgjigjet e rekomandimeve të auditit të brendshëm?			
6. A monitorohet zbatimi i rekomandimeve të auditit të brendshëm?			
7. A është i lidhur ndonjë prej audituesve të brendshëm ose anëtarëve të familjeve të tyre me punonjës të tjerë?			
IV. PROCEDURAT E MONITORIMIT			
A. Buxhetet			
1. A hartojnë drejtuesit ndonjë buxhet vjetor dhe plan financiar të bazuar tek qëllimet dhe objektivat e shoqërisë?			
2. A u komunikohen pritshmëritë e buxhetit atyre që preken?			
3. A rishikohen parashikimet e përfshira në të dhënat dhe pasqyrat financiare nga persona me njohuri që janë të pavarur nga procesi i parashikimit? Nëse po, kush e kryhen këtë rishikim?			
4. A rishikohet periodikisht dhe/ose a krahasohet me planin, performanca financiare dhe statusi i gjendjes financiare të shoqërisë?			
a. A shpjegohen nga drejtuesit devijimet midis			

	Po	Jo	Jep Shpjegime
performancës dhe planit?			
b. Sa shpesh kryhen këto analiza?			
5. A i mbulojnë procedurat e buxhetimit të gjithë degët dhe departamentet?			
6. A i mbulojnë buxhetet dhe parashikimet:			
a. Të ardhurat nga primet sipas linjave të sigurimit?			
b. Përfitimet nga policat sipas linjave të sigurimit?			
c. Shpenzimet e përgjithshme?			
d. Investimet (alokimi i fondeve të investueshme dhe të ardhurave dhe shpenzimeve)?			
e. Fluksi i parasë?			
B. Planifikimi dhe Raportimi Financiar			
1. A dorëzohen pasqyrat financiare në intervale të rregullta? A u jepen ato:			
a. Menaxhimit operacional?			
b. Këshillit?			
c. Komitetit të auditit?			
2. A shoqërohen pasqyrat financiare me komente analitike? A tregojnë ato krahasimet me:			
a. Periudhat e mëparshme?			
b. Buxhetet ose parashikimet?			
3. Kush i rishikon dhe i miraton informacionet financiare për shpërndarjet publike p.sh., deklaratat për shtyp, dosjet e organeve rregullatore dhe raportet për të siguruarit apo aksionarët?			
a. Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv?			
b. Drejtuesit operacionalë përkatës?			
c. Drejtori i financës?			
d. Këshilli?			
e. Komiteti i auditit?			

	Po	Jo	Jep Shpjegime
5. A kërkohet që të gjitha llogaritë kontabël, veç atyre standarde, të autorizohen nga një person përgjegjës i pa përfshirë në procesin e regjistrimit të të dhënave?			
6. A është akses i të dhënave kontabël dhe financiare i kufizuar vetëm për personelin e autorizuar?			
7. A janë të shkruara dhe aktuale procedurat e kontrollit të brendshëm për ruajtjen e aktiveve të shoqërisë?			
F. Risigurimi			
1. A kërkojnë marrëveshjet e risigurimit rishikim dhe miratim formal para se të nënshkruhen nga punonjësit? Detajoni cilët punonjës e kryejnë këtë rishikim dhe miratim. Shënoni gjithashtu nëse edhe këshilli i rishikon dhe i miraton.			
2. A dokumentohet miratimi rregullator i marrëveshjeve të risigurimit?			
3. A mbështeten me dokumentacion me shkrim të gjitha ndryshimet në marrëveshjet e risigurimit?			
4. Diskutoni ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në terma, p.sh., komisioni, pjesëmarrja në përqindje, kufijtë ose mbajtjet.			
5. A rishikohet stabiliteti financiar i shoqërive pranuese të risigurimit për të vërtetuar nëse këto shoqëri kanë aftësi paguese dhe kanë aftësinë që të plotësojnë detyrimet e marra përsipër me marrëveshjen e risigurimit?			
6. A raporton menaxhimi i shoqërisë për planin e risigurimit dhe a ia komunikon këshillit vlerësimin e efektivitetit të planit të paktën një herë në vit?			
V. KËRKESAT LIGJORE DHE RREGULLATORE			
1. Ku mbahen kopjet aktuale të legjislacionit dhe rregulloreve të tjera shoqërisë së sigurimeve dhe/ose të Grupit të sigurimit?			
1. Përshkruani procedurat që garantojnë se drejtuesit informohen për ndryshimet në ligje.			

	Po	Jo	Jep Shpjegime
2. A rishikohen fushat e mëposhtme specifike të veprimtarive të shoqërisë për përputhje me kërkesa rregullatore? Nëse po, sa shpesh? Përshkruani procedurat e dokumentimit dhe tregoni kush përgjigjet.			
a. Kërkesat e kapitalit dhe kufizimet e dividendit?			
b. Transaksionet me punonjësit, drejtorët dhe drejtuesit e tjerë?			
c. Raportet e lejuara të kategorive të lejuara të investimeve ndaj kapitalit rregullator?			
d. Ndalime ose kufizime për lloje të veçanta investimesh?			
e. Trajtimi i të siguruarve në çështje që lidhen me shlyerjen e përfitimeve?			
f. Veprimtaritë jo të drejtpërdrejta të sigurimit të lejuara?			
g. Operacionet e huaja?			
3. Deklaroni ndonjë kufizim apo kërkesë rregullatore që i përket në mënyrë specifike shoqërisë.			
4. A ka ndonjë detyrim apo angazhim me peshë, jashtë bilancit?			
VI. KODI I SJELLJES			
1. A ka shoqëria një kod sjelljeje? Nëse po, jepni një kopje dhe këshilloni se çfarë trajton kodi dhe kush e merr atë.			
2. A u shpërndahet kodi i sjelljes punonjësve dhe a është e konfirmuar se punonjësit e marrin dhe e kuptojnë kodin dhe politikat e tjera? Nëse po, ju lutemi përshkruani këtë proces.			
3. A ka një proces të përditësimit të politikave dhe procedurave? Ju lutemi përshkruani këtë proces.			
4. A ka kodi ndonjë procedurë të vendosur për të trajtuar çështjet e përputhshmërisë dhe etikës që mund të lindin? Nëse po, ju lutemi përshkruani procedurat për këtë proces dhe se si e shqyrton shoqëria burimin e mospërputhjes?			

5. A siguron kodi udhëzime për të ndërmarrë veprime kundër shkelësve të kodit? Nëse po, ju lutemi përshkruani se sa është zbatuar kjo në mënyrë të vazhdueshme dhe në se ka dispozita të tjera që e trajtojnë këtë çështje.
6. A ka procese në vazhdim që monitorojnë efektivitetin e përputhshmërisë dhe programin e etikës? Në se po, ju lutemi përshkruajeni.

Po	Jo	Jep Shpjegime

Kuptimi i Strukturës së Qeverisjes së Shoqërisë

Qëllimi i këtij ilustrimi është që të ndihmojë inspektorin që të dokumentojë kuptimin dhe vlerësimin e këshillit të siguriesit, strukturën administrative dhe menaxhimin. Një vlerësim i përgjithshëm i favorshëm i qeverisjes në vetvete nuk shërben për të reduktuar gamën ose masën e procedurave të inspektimit; në të kundërt, kontrollet specifike të qeverisjes duhet të vlerësohen për saktësinë e tyre të administrimit të rreziqeve specifike, në lidhje me kontrolle të tjera të planifikuara për të menaxhuar të njëjtën gjë.

A. VLERËSIMI I KËSHILLIT

Një vlerësim i këshillit mund të përcaktohet nëpërmjet diskutimeve me këshillin dhe nëpërmjet kuptimit të rolit mbikëqyrës të këshillit. Si udhëzim i përgjithshëm, në vlerësimin e këshillit duhet të konsiderohen fushat e mëposhtme:

1. A është i përfshirë këshilli aktivisht në përzgjedhjen dhe vlerësimin e performancës së funksionarëve kryesorë siç duhet?
2. A i monitoron dhe i mbikëqyr këshilli efektivisht aktivitetet e drejtuesve?
3. A është këshilli i pavarur nga drejtuesit në mënyrë të mjaftueshme, që kur të jetë e nevojshme, të bëjë pyetje të vështira dhe hetuese?
4. A është informacioni që i jepet këshillit apo anëtarëve të komitetit i mjaftueshëm dhe në kohën e duhur që të lejojë monitorimin e objektivave dhe strategjive të drejtuesve, pozitës financiare të subjektit dhe rezultatet operationale dhe termat e marrëveshjeve të rëndësishme?
5. A i rishikon këshilli aktivisht materialet e paraqitura nga drejtuesit për qëllime informacioni apo për miratim të këshillit, duke peshuar siç duhet çështjet dhe alternativat më të rëndësishme, duke u përfshirë në diskutime, duke kundërshtuar pretendimet kryesore të drejtuesve dhe duke kërkuar informacion shtesë dhe/ose shpjegime si të jetë e nevojshme?
6. Cila është frekuenca dhe harku kohor në të cilën mbahen takimet me drejtorët e financës dhe/ose kontabilitetit, audituesit e brendshëm dhe audituesit e jashtëm?
7. A i vlerëson këshilli rregullisht e objektivisht, saktësinë e tolerancës së përgjithshme ndaj rrezikut, veprimtarive kryesore të biznesit dhe rreziqet e shoqërisë?
8. A u përgjigjet dhe a i ndjek këshilli problemet e identifikuara nga drejtuesit, auditit i brendshëm ose i jashtëm, aktuarët e emëruar, AMF-ja ose rregullatorë të tjerë, në mënyrë që të jetë e kënaqur që ka kryer veprimin e duhur ose ka marrë vendimin e duhur?

Në vijim të udhëzimeve të mësipërme të vlerësimit, një këshill aktiv dhe efektiv ose komiteti përkatës, kryejnë një funksion të rëndësishëm mbikëqyrës. Veç kësaj, për shkak të aftësisë së menaxhimit për t'i anashkaluar kontrollet e sistemit, këshilli luan një rol të rëndësishëm për të siguruar kontrollin e brendshëm efektiv, duke vendosur 'tonin nga sipër' dhe duke vendosur standardet e tjera të drejtimit që mund të ndikojnë në analizën e rrezikut për veprimtaritë e shoqërisë. Komponentët kyç përfshijnë:

1. Pavarësinë nga menaxhimi, e tillë që, kur është e nevojshme, të ngrihen pyetje të vështira dhe hetuese. Për shembull, konsideroni në se:

- a) këshilli kundërshton në mënyrë konstruktive veprimet e planifikuara të menaxhimit, p.sh., iniciativat strategjike dhe transaksionet madhore dhe kërkon shpjegime për rezultatet e kaluara, p.sh., devijimet e buxhetit;
 - b) një këshill që përbëhet vetëm nga zyrtarët dhe punonjësit e një enti (p.sh., një korporatë e vogël), vë në pikëpyetje dhe kontrollon aktivitetet, paraqet pikëpamje alternative dhe ndërmerr veprimin e përshtatshëm nëse është e nevojshme.
2. Përdorimin e komiteteve të këshillit, kur është e domosdoshme, nga nevoja për vëmendje më të thellë ose të drejtuar për çështje të veçanta. Për shembull, konsideroni nëse:
- a) ekzistojnë komitetet e këshillit;
 - b) ata janë të mjaftueshëm, në përmbajtje dhe anëtarësi, që t'i trajtojnë çështjet e rëndësishme siç duhet.
3. Frekuencën dhe harkun kohor në të cilën mbahen takimet me drejtorët e financës dhe/ose të kontabilitetit, auditin e brendshëm dhe auditin e jashtëm. Për shembull, konsideroni nëse:
- a) komiteti i auditit takohet privatisht me drejtorin e kontabilitetit dhe auditit të brendshëm dhe të jashtëm për të diskutuar mbarëvajtjen e procesit të raportimit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm, komente dhe rekomandime të rëndësishme dhe performancën e drejtuesve;
 - b) komiteti i auditimit shqyrton fushën e aktiviteteve të auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm çdo vit;
4. Mjaftueshmërinë dhe afatet kohore me të cilat jepet informacion për këshillin ose anëtarët e komitetit, për të mundësuar monitorimin e objektivave dhe strategjive të menaxhimit, pozicionin financiar të njësisë ekonomike dhe të rezultateve operative, dhe kushtet e marrëveshjeve të rëndësishme. Për shembull, merrni në konsideratë nëse:
- a) këshilli merr rregullisht informacion kyç, të tillë si pasqyrat financiare, iniciativat e mëdha të marketingut, kontrata ose negociata të rëndësishme;
 - b) drejtorët besojnë se ata marrin informacionin e duhur.
5. Mjaftueshmërinë dhe afatet kohore me të cilat këshilli ose komiteti i auditimit është i njohur me informacion delikat (sensitiv), hetimet dhe aktet e pahijshme (p.sh., shpenzimet e udhëtimit të funksionarëve kryesorë, çështje gjyqësore të rëndësishme, hetime të agjencive rregullatore, keqpërdorime, përvetësimin apo keqpërdorimin e pasurive të korporatës, shkeljet e rregullave për informacionet e tregtimit të brendshëm (ang. insider trading rules), pagesat politike (political payments), apo pagesat e paligjshme). Për shembull, merrni në konsideratë nëse:
- a) ekziston një proces për informimin e këshillit për çështje të rëndësishme;
 - b) informacioni komunikohet në kohë.
6. Roli i këshillit në krijimin e përshtatshme të “tonit nga sipër” (ang. tone at the top). Për shembull, konsideroni nëse:
- a) këshilli dhe komiteti i auditimit janë të përfshirë sa duhet në vlerësimin e efektivitetit të “tonit nga sipër”;
 - b) këshilli merr hapa për të siguruar një "ton" të përshtatshëm;

- c) këshilli në mënyrë specifike trajton respektimin e kodit të sjelljes nga ana e menaxhimit.
- 7. Veprimet që merr këshilli ose komiteti përkatës si rezultat i gjetjeve të tij, duke përfshirë edhe hetime të veçanta sipas nevojës. Për shembull, merrni në konsideratë nëse:
 - a) këshilli ka lëshuar direktiva të detajuara për menaxhimin që kanë të bëjnë me veprimet specifike që duhet të ndërmerren;
 - b) këshilli mbikëqyr dhe ndjek çështjet sipas rastit.

B. KUPTIMI I STRUKTURËS ORGANIZATIVE

Struktura organizative nuk duhet të jetë e thjeshtë sa të mos jetë në gjendje që të monitorojë siç duhet veprimtaritë e sipërmarrjes, as aq komplekse sa të pengojë fluksin e nevojshëm të informacionit. Drejtuesit ekzekutivë duhet të kuptojnë plotësisht përgjegjësitë e tyre kontrolluese dhe të kenë përvojën dhe nivelin e duhur të njohurive që të përputhen me pozicionet e tyre. Komponentët kyçë përfshijnë:

1. Saktësinë e përcaktimit të përgjegjësiave të funksionarëve kryesorë, dhe kuptimin e përgjegjësiave nga ana e tyre. Për shembull, konsideroni nëse përgjegjësitë dhe pritshmëritë për veprimtaritë e biznesit të entit u komunikohen qartë drejtuesve ekzekutivë që përgjigjen për këto aktivitete.
2. Njohuritë dhe përvoja e funksionarëve kryesorë nën dritën e përgjegjësiave. Për shembull, konsideroni nëse drejtuesit ekzekutivë që përgjigjen për detyra të caktuara, i kanë njohuritë, përvojën dhe trajnimin e kërkuar për të kryer këto detyra.
3. nëse janë siç duhet marrëdhëniet e raportimit. Për shembull, konsideroni nëse:
 - a) marrëdhëniet e vendosura të raportimit – formale ose joformale, të drejtpërdrejta ose matrica – janë efektive, dhe nëse u japin drejtuesve informacionin e duhur për përgjegjësitë dhe autoritetin e tyre;
 - b) drejtuesit e aktiviteteve të biznesit kanë akses tek funksionarët kryesorë operacionalë nëpërmjet kanaleve të qarta të komunikimit.
4. Mjaftueshmëria e numrit të punonjësve, veçanërisht në drejtim dhe në kapacitetet drejtuese dhe mbikëqyrëse. Për shembull, konsideroni nëse:
 - a) menaxhimi dhe drejtuesit e shoqërisë, kanë kohë të mjaftueshme të kryejnë përgjegjësitë e tyre në mënyrë efektive;
 - b) menaxhimi dhe drejtuesit e shoqërisë punojnë me orare të zgjatura dhe përmbushin përgjegjësitë e më tepër se një punonjësi.

C. KUPTIMI I CAKTIMIT TË AUTORITETIT DHE PËRGJEGJËSISË

Caktimi i përgjegjësisë, delegimi i autoritetit dhe vendosja e politikave të lidhura krijojnë një bazë për përgjegjshmëri dhe kontroll, dhe parashtrajnë rolet përkatëse të individëve. Komponentët kyç përfshijnë:

1. Caktimin e përgjegjësisë dhe delegimin e autoritetit për të trajtuar qëllimet dhe objektivat organizative, funksionet operationale dhe kërkesat rregullatore, duke përfshirë përgjegjësinë për sistemet e informacionit dhe autorizimet për ndryshimet. Për shembull, konsideroni nëse:
 - a) autoriteti dhe përgjegjësia u janë caktuar punonjësve në të gjithë subjektin;
 - b) përgjegjësia për vendimet lidhet me caktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë;
 - c) konsiderohet informacioni i duhur në përcaktimin e nivelit të autoritetit dhe gamës të përgjegjësisë që i jepet një individ.
2. Saktësia e standardeve dhe procedurave që lidhen me kontrollin, duke përfshirë përshkrimin e punës së punonjësit. Për shembull, konsideroni nëse:
 - a) përshkrimet e punës, të paktën për personelin drejtues dhe mbikëqyrës ekzistojnë;
 - b) përshkrimet e punës, ose standardet dhe procedurat e tjera, përmbajnë referime specifike për përgjegjësitë që lidhen me kontrollin.
3. Mjaftueshmëria e numrit të stafit, veçanërisht në lidhje me sistemet e informacionit dhe funksionet e kontabilitetit, me nivelet e aftësive të kërkuara që lidhen me madhësinë e subjektit dhe natyrën e kompleksitetit të aktiviteteve dhe sistemeve. Për shembull, konsideroni nëse subjekti ka burime njerëzore të përshtatshme, në numra dhe përvojë – që të kryejë misionin e tij.

D. VLERËSIMI I MENAXHIMIT

Vlerësimi i cilësisë së këshillit dhe menaxhimit mund të përcaktohet nëpërmjet diskutimeve dhe vëzhgimeve të proceseve të qeverisjes. Si udhëzim i përgjithshëm, fushat e mëposhtme duhet të përfshihen në vlerësimin e menaxhimit.

1. Sa kohë kanë qenë drejtuesit në pozicionet aktuale në shoqëri dhe çfarë përvoje specifike të industrisë kanë?
2. A ka pasur lëvizje të rëndësishme tek drejtuesit?
3. A kanë qenë personat që mbajnë pozicione menaxheriale, funksionarët kryesorë, dorëzanët ose aksionarë kontrollues të ndonjë shoqërie tjetër sigurimesh e cila, ndërsa ata mbanin këtë post ose shërbenin me këtë cilësi në lidhje me të:
 - a) është shpallur pa aftësi paguese;
 - b) u vu në administrim të përkohshëm;
 - c) u këshillua dhe u urdhërua që të eliminonte shkeljet apo/dhe të mos shkelte ligjin e letrave me vlerë apo Ligjin e Sigurimeve dhe aktet përkatëse të Autoritetit; ose
 - d) iu pezullua ose ju revokua miratimi i Autoritetit ose licenca për të ushtruar veprimtari në një vend tjetër. në ndonjë shtet?

Vlerësimi i Performancës së Menaxhimit

1. A ka menaxhimi qëndrim pozitiv në lidhje me kontrollet e brendshme?

2. A e monitoron menaxhimi respektimin e politikave të miratuara, kontrolleve organizative dhe procedurale, kërkesave të përputhshmërisë, duke u siguruar që të ndërmerret veprimi i duhur dhe në kohë për të rregulluar ndonjë mangësi që mund të lindë?
3. A vendos menaxhimi 'tonin nga sipër' siç duhet, duke i kryer detyrat e tyre me etikë dhe duke pritur të njëjtën gjë nga individët në të gjithë shoqërinë?
4. A analizon menaxhimi në mënyrë efektive dhe a e kontrollon informacionin financiar dhe operacional dhe tendencat në mënyrë të tillë që tendencat negative dhe keqdeklarimet në Pasqyrat Vjetore mund të pritët që të identifikohen në mënyrë të arsyeshme dhe të korrigjohen në kohën e duhur?
5. A ekzistojnë në ambientet e ushtrimit të veprimtarisë, (seli zyra), masa mbrojtëse fizike të përshtatshme dhe a janë të gjithë zyrtarët dhe punonjësit të mbuluar me sigurim (ang. bonded)?
6. A e informon menaxhimi këshillin dhe komitetet, plotësisht, në kohën e duhur, për kushtet e tregut, mundësitë dhe shqetësimet strategjike, performancën operationale dhe problemet që mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mirëqenien e shoqërisë?

Për ta zgjeruar më tej modelin vlerësues të mësipërm, filozofia dhe stili operues i menaxhimit normalisht ka një efekt në të gjithë subjektin. Këto janë gjëra të paprekshme por duken shenjat pozitive dhe negative. Komponentët kyç përfshijnë:

1. Natyra e rreziqeve të biznesit të pranuar, p.sh., nëse menaxhimi shpesh hyn në sipërmarrje veçanërisht me risk të lartë, ose është tepër konservator për të pranuar rreziqet, për shembull, konsideroni nëse menaxhimi vepron me kujdes, vetëm pasi të kenë analizuar me kujdes rreziqet dhe përfitimet e mundshme të një sipërmarrjeje të mundshme.
2. Lëvizja e personelit. Për shembull, konsideroni nëse:
 - a) ka pasur lëvizje të tepërta të funksionarëve kryesorë dhe të personelit mbikëqyrës;
 - b) funksionarët kryesorë janë larguar papritur ose me një njoftim të shkurtër në kohë;
 - c) ka një tendencë të lëvizjes së personelit, p.sh., paaftësia për të mbajtur drejtuesit ekzekutivë financiarë ose të auditit të brendshëm, që mund të jetë një tregues i theksit që drejtuesit, i vënë kontrollit.
3. Frekuenca e ndërveprimit midis menaxhimit të lartë dhe atij operacional, veçanërisht kur veprohet nga vendndodhje të largëta gjeografikisht. Për shembull, konsideroni në se:
 - a) menaxhimi i lartë viziton shpesh operationet e degëve apo të divizioneve;
 - b) mbahen shpesh mbledhje nga menaxhimi në nivel grupi ose divizioni.
4. Qëndrimet dhe veprimet ndaj raportimit financiar, duke përfshirë mosmarrëveshjet mbi aplikimin e trajtimeve kontabël, p.sh., përzgjedhja e politikave kontabël konservatore përkundër atyre liberale, qoftë nëse parimet e kontabilitetit janë aplikuar keq, informacioni financiar i rëndësishëm nuk është publikuar ose janë manipuluar ose falsifikuar të dhënat. Për shembull, konsideroni në se:
 - a) menaxhimi shmang fokusin e tepërt ndaj rezultateve afat-shkurtra të raportuara;
 - b) personeli nuk dorëzon raportet negative për të arritur objektivat;

- c) menaxhimi nuk injoron shenjat e praktikave të pasakta;
- d) parashikimet nuk i çojnë faktet deri tek kufiri i arsyes dhe më tej.

E. DOKUMENTACIONI

Ekipi i inspektimit duhet të dokumentojë kuptimin dhe vlerësimin nga ana e tij e qeverisjes së subjektit, si dhe vlerësimin e tij për ndikimin e lidhur me inspektimin. Kjo përmbledhje duhet të përfshijë një përshkrim të ndonjë procedure unike inspektimi, duke përfshirë kontrollet speciale që konsiderohen të nevojshme për ndonjë risk të rëndësishëm të identifikuar si rezultat i këtij vlerësimi.

Procedurat e Rishikimit Analitik

Kryerja e rishikimit analitik përfshin studimin dhe krahasimin e marrëdhënieve midis të dhënave në një moment kohor dhe tendencës së atyre marrëdhënieve në periudha kohore. Bazuar në kuptimin e biznesit të shoqërisë, inspektori harton disa pritshmëri për marrëdhëniet e rëndësishme financiare dhe operationale. Rezultatet e rishikimit analitik që mbështetin këto pritshmëri rrisin nivelin e besimit dhe mund të çojnë në efica të inspektimit duke ndryshuar natyrën e testeve ose duke reduktuar masën e procedurave të tjera. E kundërta, rezultatet e rishikimit analitik që ndryshojnë nga pritshmëritë duhet të rritin skepticizmin e përgjithshëm dhe mund të kërkojnë procedura shtesë për të shpjeguar devijimet e rëndësishme nga pritshmëritë.

Përveç kryerjes së vlerësimeve të tyre analitike, inspektorët duhet të përdorin edhe rishikimet analitike të kryera nga drejtuesit e shoqërisë, audituesit e brendshëm dhe të jashtëm dhe analistët financiarë. Këto burime mund ta ndihmojnë inspektorin që të identifikojë marrëdhëniet e pazakonta dhe ndoshta për të reduktuar masën e procedurave analitike ose të testimit të detajeve që inspektori pret të kryejë.

Llojet e Procedurave të Rishikimit Analitik:

A. Krahasimet me Periudhat e Mëparshme

Analiza e karakteristikave financiare dhe rezultatet operationale të shoqërisë gjatë një periudhe kohore jep informacionin e dobishëm për vlerësimin e performancës operationale dhe vlerësimin e kushteve financiare të pritshme të vitit aktual dhe rezultateve të operationeve. Krahasimet e dy viteve, p.sh., një analizë krahasuese e shpenzimeve operuese të vitit aktual dhe vitit të mëparshëm mund të jetë e mjaftueshme për të identifikuar ndryshimet që kërkojnë ndjekjen nga shoqëria. Megjithatë, krahasimet e disa viteve, d.m.th., analiza e tendencave, shpesh mund të jetë më informative. Shumë faktorë mund të ndikojnë tek krahasimet. Për shembull, ndryshimet në nivelet e çmimit, ose tendenca e përgjithshme e industrisë (rritja ose rënia) mund të shtrembërojë krahasimet midis periudhave. Prandaj, krahasimet e pasqyrave vjetore duhet të përfshijnë edhe vlerat edhe përqindjen e aktiveve totale dhe klasifikimet e pasqyrës së të ardhurave si një përqindje e primeve totale.

Kur bëhen krahasime me disavjecare të mëparshme, trendi mund të pësojë deviacione si pasojë e ngjarjeve të rëndësishme që nuk kanë natyrë periodike. Disa faktorë që mund të ndikojnë në krahasueshmërinë ndërmjet periudhave janë:

1. Ndryshimet në dizenjimin e produktit, klientët, strategjia e marketingut ose kapitalizimi;
2. Shitja ose blerja e një linje biznesi;
3. Ndryshimet kontabël ose riklasifikimet e llogarive;
4. Pagesat e pazakonta ose kredit për operationet;
5. Transaksione të mëdha risigurimi.

Inspektori duhet të kuptojë efektet e këtyre ngjarjeve në kryerjen dhe vlerësimin e analizës së tendencave dhe në hartimin e pritshmërive për të dhënat financiare të shoqërisë.

B. Krahasset me Buxhetet ose Parashikimet

Krahasset e rezultateve faktike operationale me buxhetin ose shumën e parashikuara, shpesh mund të japin prova të rëndësishme për rishikimin analitik. Megjithatë, përpara se të bëhen krahasset me buxhetin ose parashikimet dhe devijimet investiguese, inspektori duhet të kuptojë buxhetin e shoqërisë ose procesin e përgatitjes së parashikimit dhe supozimet e rëndësishme që ato përmbajnë. Për shembull, në qoftë se procesi buxhetor përfshin një studim të përvojës së tanishme dhe të kaluar operationale të shoqërisë dhe të kushteve të përgjithshme ekonomike dhe të industrisë dhe në qoftë se buxhetet e kaluar kanë provuar se kanë qenë realiste, krahasimi me shumën e buxhetuara mund të jetë i dobishëm. Por në qoftë se buxhetet janë thjesht mjete motivuese, d.m.th., ‘qëllime të sforcuara’ më tepër se sa parashikimet më të mira të drejtuesve ose historikisht janë përgatitur në mënyrë të pasaktë, ato mund t’i nënshtrohen devijimeve të mëdha. Në këto raste, krahasset me buxhetet për qëllimet e rishikimit analitik duhet të jenë të kufizuara.

Disa komponentë të pasqyrave financiare vjetore janë më të përshtatshëm për krahasime me buxhetin. Si shembuj janë të ardhurat e investimit dhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative. Informacioni tjetër financiar, i tillë si përfitimet dhe dëmet, ndikohen nga faktorë të vështirë për t’i shprehur në mënyrë sasiore kur përgatitet një buxhet.

Kur përmbledhja ose parashikimi përdoren për të kryer rishikimin analitik të procedurave, inspektori duhet të:

1. T’i krahasojë ato me rezultatet operationale të viteve të mëparshëm dhe me informacionin financiar të vitit aktual, dhe
2. Të analizojë rishikimet kryesore të bëra për to gjatë vitit.

C. Krahasset me Tregun dhe të Dhënat e Konkurrentëve

Krahasset e vlerave të pasqyrave vjetore dhe marrëdhënieve për shoqërinë ose segmentet e saj me konkurrentët ose statistikën e industrisë mund të lehtësojnë kuptimin e mjedisit të biznesit të shoqërisë duke treguar ndikim tek shoqëria të tendencave në lindje ose ndryshimeve strukturore në industri. Duke theksuar performancën financiare të shoqërisë lidhur me industrinë, këto krahasime gjithashtu ndihmojnë për të identifikuar fushat që kërkojnë vëmendjen ose fushat ku procedurat mund të kufizohen. Krahasset mund të kryhen duke identifikuar grupe të njëjta kompanish me karakteristika të ngjashme dhe duke krahasuar performancën e shoqërisë me grupin ose duke krahasuar shoqërinë me mesataret e industrisë.

Një mesatare tregu nuk është një ‘numër magjik’ që tregon një performancë ideale ose madje të pranueshme. Megjithatë, statistikën e industrisë mund të shërbejnë si një standard efektiv për të vlerësuar operationet e shoqërisë. Prandaj devijimet e mëdha nga mesatarja e tregut mund të tregojnë probleme dhe duhen kuptuar. Krahasset e industrisë mund të identifikojnë probleme të mundshme të inspektimit ose shqetësime të lidhura me menaxhimin.

Ndërsa krahasset me statistikën e industrisë mund të japin informacion të dobishëm, të dhënat duhet të jenë të krahasueshme. Krahasset kuptimplota mund të jenë të vështira për

disa arsye të ndryshme, duke përfshirë faktin që secila shoqëri ka karakteristika unike, të tilla si dizenjimi i produktit, konsumatorët e synuar, vendndodhja, struktura e shoqërisë dhe kapitalizimi. Luhatshmëria e të dhënave të industrisë nuk do të thotë se krahasimet me normat e industrisë nuk do të jenë të dobishme. Në të kundërt, vlera e tyre parimore mund të jenë pyetjet që ato ngrenë. Megjithatë, inspektori gjithmonë duhet të përdorë gjykimin në përzgjedhjen e të dhënave të industrisë për qëllimet e rishikimit analitik dhe në vlerësimin e krahasimeve. Në përdorimin e krahasimeve të grupeve të njëjta, është e rëndësishme të përzgjidhen shoqëritë e sigurimeve që janë të krahasueshme në madhësi, strukturë financiare, vendndodhje dhe rëndësi në treg, p.sh., linjat e biznesit, sepse këta faktorë do të ndikojnë tek treguesit e performancës. Ndërsa duhet përdorur kujdesi, krahasimet midis shoqërive të njëjta mund të jenë të dobishme për të përcaktuar agresivitetin ose konservatorizmin e politikave të investimit të shoqërisë, praktikave fiskale dhe strategjive të vendosjes së çmimeve.

D. Vlerësimi i Rezultateve të Rishikimit Analitik

Kuptimi i biznesit të shoqërisë mund të identifikojë lëvizje të mundshme të të dhënave financiare. Këto lëvizje mund të shkaktohen nga:

1. Tendencat – ndryshimet e përgjithshme të kurseve të biznesit;
2. Tendencat sezonale – ndryshimet në veprimtarinë e biznesit të shkaktuara nga moti ose nga ndryshimet e tjera stinore;
3. Tendencat e ciklit – ndryshimet në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik; ose
4. Marrëdhëniet e varura – ndryshimet e lidhura me lëvizjet në të dhënat e tjera financiare.

Lëvizjet që nuk mund të shpjegohen me njohuritë e biznesit të shoqërisë ose nga marrëdhëniet e njohura me të dhënat e tjera financiare mund të rezultojnë nga transaksione që nuk përsëriten, procedura ose praktika të gabuara të kontabilitetit ose faktorë të tjerë. Kur ndodhin lëvizje të mëdha në shumën ose në marrëdhënie kyçe ose nuk ndodhin ato që priten, inspektori duhet të gjejë arsyen. Procedurat fillestare të ndjekjes duhet të përfshijnë diskutimet me drejtuesit ekzekutivë operacionalë dhe drejtuesit financiarë. Drejtuesit mund të kenë vendosur tashmë shkakun e devijimeve ose nëse nuk e kanë bërë, mund të kursejnë kohë duke ndjekur këto çështje. Inspektori duhet të kundërshtojë arsyetueshmërinë e shpjegimeve të drejtuesve sipas kuptimit të biznesit nga inspektorët dhe sipas pritshmërive të inspektorit.

Inspektori duhet të konsiderojë se si aftësia e shoqërisë për të reaguar ndaj hetimit të arsyeshëm analitik do të ndikojë në vlerësimin e kompetencës së menaxhimit. Shoqëritë e menaxhuara mirë do të jenë në gjendje që t'i përgjigjen pyetjeve për marrëdhëniet kyçe ose do të ndjekin shkakun kryesor të lëvizjeve të papritura.

E. Shembuj të Proçedurave të Rishikimit Analitik

Shembujt e proçedurave të rishikimit analitik diskutohen më poshtë. Inspektori duhet të konsiderojë informacionin e rishikimit analitik që tashmë është përgatitur nga drejtuesit. Shembujt përfshijnë diagramat, shembujt e ndryshëm, grafikët dhe analizat e ngjashme duke përfshirë raportet e brendshme të drejtuesve të shoqërisë, raportet e këshillit, statistikën e divizionit ose të linjës së biznesit dhe dokumente të ngjashme. Çelësi nuk është që të

llogariten të gjitha raportet e mundshme, por të identifikohen ato pak marrëdhënie kyçe që përmbushin më mirë objektivin e inspektorëve. Kur vendoset nëse duhen inkorporuar procedurat e rishikimit analitik në programin e inspektimit si teste direkte të bilanceve, inspektori duhet të konsiderojë masën në të cilën duhet të testohen të dhënat e tyre.

Lista e mëposhtme përshkruan të dhënat dhe marrëdhëniet kyçe që mund të përdoren në kryerjen e procedurave të rishikimit analitik për objektivat e caktuara të inspektimit. Lëvizjet në këto marrëdhënie mund të tregojnë ndryshimet në politikat operationale, metodat e kontabilitetit, përbërjen e produkteve ose kushte apo rrethana të tjera, p.sh., një ndryshim në raportet e përfitimit mund të tregojë një ndryshim në linjën e biznesit ose të përbërjes së produkteve ose ndryshimeve në kosto ose në tarifa.

Për të pasur përdorimin më efektiv të procedurave të rishikimit analitik, është e rëndësishme që të dhënat dhe marrëdhëniet kyçe të llogariten për linjat specifike të biznesit ose të produkteve të sigurimeve.

Lista nuk është gjithëpërfshirëse, as nuk përfaqëson procedurat e kërkuara për të gjitha inspektimet e sigurimeve.

Objektivat e inspektimit	Të dhëna/marrëdhënie kyçe
Të ardhurat e llogaritura (ang. accrued) dhe të pafituara nga investimet janë regjistruar saktë në llogari, në shumë dhe në periudhë.	Shpenzimet e llogaritura të investimit, ndaj të ardhurave të llogaritura të investimit. Të ardhurat e llogaritura të investimit si përqindje e të ardhurave të investimit.
Investimet në pasuri të paluajtshme janë të autorizuar dhe janë regjistruar siç duhet në llogari, shumë dhe periudhë.	Pasuritë e paluajtshme në investimet totale. Pasuritë e paluajtshme në aktivet totale.
Të ardhurat e llogaritura dhe të pafituara në investimet e pasurive të paluajtshme janë të regjistruara saktë në llogari, shumë dhe periudhë.	Shpenzimet e llogaritura, ndaj të ardhurave të llogaritura. Të ardhurat e llogaritura në portofolin total të pasurisë së paluajtshme. Të ardhurat e llogaritura nga pasuritë e paluajtshme si përqindje e të ardhurave totale të investimit.
Investimet afatshkurtra janë autorizuar, janë vlerësuar siç duhet dhe regjistruar saktësisht në llogari, shumë dhe periudhë.	Investimet afatshkurtra në investimet totale. Përbërja e investimeve afatshkurtra, p.sh., certifikatat e depozitës zënë 50%.
Të ardhurat e llogaritura dhe të pafituara në investimet afatshkurtra janë regjistruar siç duhet në llogari, shumë dhe periudhë.	Interesi i llogaritur në investimet afatshkurtra, në investimet totale afatshkurtra. Interesi i llogaritur në investimet afatshkurtra, në të ardhurat totale të investimit.
Aktivët e tjera janë vlerësuar siç duhet dhe regjistruar saktësisht në llogari, shumë dhe	Amortizimi/zhvlerësimi në koston e aktivit.

Objektivat e inspektimit	Të dhëna/marrëdhënie kyçe
periudhë.	
Risigurimi i pranuar dhe cedimet janë autorizuar dhe regjistruar saktë në llogari, shumë dhe periudhë.	Primet e sigurimit të pranuar në të ardhurat nga primet. Primet e risigurimit të ceduara në të ardhurat nga primet.
Provigjonet për tatimet ndaj të ardhurave dhe aktivet e lidhura dhe detyrimet janë regjistruar saktë në llogari, shumë dhe periudhë.	Provigjoni i tatimit mbi të ardhurat, në të ardhurat para tatimeve.
Detyrimet e dëmeve janë të plota dhe të arsyeshme dhe janë regjistruar saktë në llogari, shumë dhe periudhë.	Numrat dhe shuma totale e dëmeve për t'u paguar dhe të papaguara dhe në proces. Shuma për t'u paguar, të papaguara dhe në proces shlyerje në rezervën totale të dëmit. Rezervat mesatare të dëmit, në shumën mesatare të pagesave së dëmshpërblimit.
Paratë e marra hua janë autorizuar dhe regjistruar siç duhet në llogari, shumë dhe periudhë.	Shpenzimi i interesit, në përqindjen mesatare të huamarrjes nga borxhi i papaguar.

Rezultatet e Marrjes në Sigurim

Një tregues që përdoret shpesh për rezultatet e marrjes në sigurim për jojetën është 'raporti i kombinuar', d.m.th., raporti i dëmeve, shpenzimeve të trajtimit të dëmeve dhe shpenzimet e marrjes në sigurim ndaj primeve. (Të gjitha shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të ndryshme nga ato të alokuara për veprimtarinë e investimit, konsiderohen shpenzime të marrjes në sigurim) Raporti i kombinuar detajohet më tej në dy komponentë – raporti dëme/prime dhe raporti i shpenzimeve të marrjes në sigurim. Raporti dëme/prime përfshin dëmet dhe shpenzimet e dëmeve të ndodhura, si një përqindje e primit të fituar. Raporti i shpenzimeve të marrjes në sigurim është: shpenzimet e marrjes në sigurim të kryera tek primet e fituara.

Raportet e dëmeve

Raporti i dëmeve ndryshon nga periudha në periudhë për shkak të ndryshimeve në marrëdhëniet midis dëmeve dhe primeve. Dëmet ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve në ekspozime, frekuencë dhe madhësi të ndodhjes së tyre. Ndryshimet në nivelet e shpenzimeve për trajtimin e dëmeve gjithashtu ndikojnë në raportin e dëmeve. Primet ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në tarifa, në volumin e rreziqeve të siguruar dhe në masën e ekspozimit për risk të siguruar. Disa marrëdhënie analitike ekzistojnë midis dëmeve dhe primeve dhe komponentëve të tyre. Duhet bërë kujdes i veçantë për t'i marrë këto statistika sipas vitit kur ndodhin, nëse disponohen, për të eliminuar shtrembërimin nga rishikimet e rezervës së viteve të mëparshëm. Këto marrëdhënie analitike përfshijnë:

1. Numrin mesatar të dëmeve që ndodhin në një periudhë të dhënë, për policë. (Kjo është frekuenca e dëmit dhe ajo llogaritet si numri i dëmeve pjesëtuar me numrin e policave në fuqi);
2. Primet mesatare të shkruar ose të fituar për policë;
3. Të dhëna historike për zhvillimet e dëmeve. (Këto japin informacion në se shoqëria historikisht i ka provigjionuar dëmet siç duhet; ato mund të jenë të dobishme për vlerësimin e saktësisë së provigjioneve aktuale. Megjithatë, të dhënat janë të dobishme vetëm kur konsiderohen siç duhet rrethanat aktuale që ndikojnë tek provigjionet e dëmit, p.sh., rritjet e tarifave, ndryshimet në mbulimin e policës dhe inflacioni;
4. Provigjoni mesatar i dëmit. (Kur lidhet me provigjionet mesatare të dëmeve në periudha të mëparshme, ky raport shërben si një matës aktual i saktësisë krahasuese të provigjionit të dëmit);
5. Dëmi mesatar i ndodhur. (Kjo është ashpërsia/masa e dëmit dhe ajo është një masë e kostos mesatare të dëmeve. Ajo llogaritet si shuma totale e dëmeve të ndodhura pjesëtuar me numrin e dëmeve);
6. Dëmi mesatar i ndodhur për policë në një periudhë të caktuar. (Kjo është kostoja e dëmit dhe ajo është produkt i frekuencës së dëmit dhe ashpërsisë/madhësisë së tij);
7. Dëmet e ndodhura në raport me rezervat e dëmit. (Ky raport mat se sa shpejt ndryshojnë nivelet e rezervës së dëmit në raport me volumin e dëmeve);
8. Rezerva IBNR ndaj matësve të ndryshëm të ekspozimit ndaj dëmeve (primet e fituara, njësitë ekspozimit të fituara, primet e shkruara, primet në fuqi, dëmet e ndodhura, dëmet e raportuara, etj). Raporti mat saktësinë krahasuese të rezervës IBNR;

Këto marrëdhënie mund të japin disa tregues të saktësisë së provigjioneve të dëmeve.

Raportet e Shpenzimeve të Marrjes në Sigurim

Raportet e shpenzimeve të marrjes në sigurim ndryshojnë nga periudha në periudhë për shkak të ndryshimeve në marrëdhëniet midis shpenzimeve të marrjes në sigurim dhe primeve. Një pjesë e rëndësishme e shpenzimeve të marrjes në sigurim përbëhet nga kostot që ndryshojnë drejtpërdrejt me primet, p.sh., komisionet. Kosto të tjera, kryesisht pagat, mund të jenë fikse ose gjysmë fikse. Raporti i këtyre kostove të tjera me primet gjithnjë mund të ndryshojë me lëvizjen e niveleve të primit.

Mund të përdoren raporte të ndryshme analitike për të shqyrtuar nëse marrëdhëniet midis shpenzimeve të marrjes në sigurim, e primeve të shkruara, të fituara dhe të pafituara, janë të arsyeshme. Këto përfshijnë:

- komisionet ndaj primeve. (Në shumicën e shoqërive, llogaritje të veçanta të këtij raporti duhet të bëhen sipas linjës së biznesit, për biznes të drejtpërdrejtë, të pranuar dhe të ceduar.);
- komisionet e netuara kundrejt llogarive/rezultateve/bilanceve të agjentëve ndaj rezultateve/bilanceve të agjentëve. (Bilancet e agjentëve regjistrohen neto pa komisionet e lidhura që janë të pagueshme për agjentët. Shuma e komisioneve neto, nëse ka, duhet të

krahasohet me shumën bruto të bilanceve të agjentëve. Raporti që rezulton duhet të krahasohet me raportin e shpenzimeve për komisione ndaj primeve.);

- rezerva primit të pafitur ndaj primeve të shkruara. (Ky raport mat pjesën e pa skaduar të primeve ndaj volumin total të primeve.)

Katër raporte të tjerë lidhen me marrjen në sigurim dhe, në mënyrë më specifike, me primet e kërkueshëm (debitorë primi) ose bilancet e agjentëve:

- Bilancet e agjentëve ose primeve, të pakthyeshme, ndaj primeve të shkruara;
- Bilancet e agjentëve ose primeve, të pakthyeshme, ndaj primeve të fituara;
- Të arkëtueshme nga primet ose agjentët ndaj primeve në fuqi; dhe
- Mosha e kërkesave të arkëtueshme nga primet ose agjentët. (These ratios will take on varying significance in different situations. Këto raporte do të kenë rëndësi të ndryshueshme në situata të ndryshme. Shpesh, problemet e mbledhjes së primit dhe borxheve të këqija janë minimale sepse primet merren para ofrimit të mbulimit të policës. Megjithatë, në qoftë se një i siguruar i ka paguar primin një agjenti të shoqërisë, shoqëria duhet të kryejë mbulimin edhe në se agjenti nuk i transmeton primet tek shoqëria. Prandaj është shqetësim besueshmëria e agjentëve.)

Risigurimi

Për shoqëritë që marrin përsipër shuma të mëdha risigurimi, tabelat analitike që përmbledhin llogari të rëndësishme nga bilancet dhe pasqyrat fitim-humbje sipas çdo marrëveshjeje kryesore, lejojnë analizën e rezultateve të marrjes në sigurim për çdo marrëveshje kryesore. Rezultatet e tyre duhet të krahasohen me pritshmëritë që lindin nëpërmjet kuptimit të marrëveshjeve (ang. treaty) të përfshira dhe konsideratave të mjedisit.

Investimet

Përveç raporteve të ndryshme që mund të përdoren për të analizuar rezultatet operationale, raportet e mëposhtme mund të përdoren për të matur operationet e investimit:

1. Yield i investimit – në total dhe sipas kategorive të investimit. (Ky raport mund të bazohet në të ardhurat nga investimi ndaj aktiveve mesatare të investuara, në total dhe sipas kategorisë së investimit. Ky raport mund të jetë një tregues i rëndësishëm i marzheve të fitimit mbi produktet e ndjeshme ndaj interesit dhe një tregues tërësor i performancës së investimit.)
2. Tabela e maturimit të obligacionit. (Ky mund të jetë një tregues i rëndësishëm i likuiditetit – veçanërisht për shoqëritë në pozicion të dobët të fluksit të parasë.)

MATRICA E RREZIKUT

EMRI I SHOQËRISË															
MATRICA E RREZIKUT më [DATË]															
	Rreziku i biznesit							Cilësia e funksioneve të mbikëqyrjes							
Aktivitetet e biznesit	Kreditit	Tregut	Likuiditetit	Sigurimit	Operacional	Ligjor & Rregulator	Strategjik	Manaxhimi operacional	Përputhshmëria	Auditi i Brendshëm	Administrimi i Rrezikut	Manaxhimi i lartë	Këshilli mbikëqyrës	Rreziku neto	Drejtimi i rrezikut
Vlerësimi i përgjithshëm															

Kapitali		Fitimet	
Rreziku i përbërë		Drejtimi i rrezikut	Harku kohor

Letra për drejtuesit

[Data]

Drejtori Ekzekutiv
Shoqëria e Sigurimeve XYZ

[Përshëndetje]

Kemi kryer inspektimin e shoqërisë së sigurimeve XZY në [datën], dhe të informacioneve të tjera të lidhura me XYZ. Kemi identifikuar problemet dhe shqetësimet e mëposhtme në lidhje me disa veprimtari dhe praktika të veçanta të Shoqërisë, për të cilat kërkojmë që të ndërmerrni veprim korrigjues.

Për çdo çështje/problem të shënuar:

- Përshkruani çështjen duke përdorur deklarata të përmbledhura të problemit të identifikuar;
- Ilustroni efektin e kësaj çështjeje duke përfshirë ndikimin sasior, dhe çfarë ndikimi ka pasur në deklaratat financiare, gjendjen financiare të shoqërisë, ose operacionet e shoqërisë;
- Deklaroni se çfarë duhet bërë (rekomandimet). Shoqëria duhet të udhëzohet që të ndërmarrë veprim për të zgjidhur problemin;
- Jepni një afat për përgjigjen e shoqërisë, p.sh., “ju lutemi informoni [deri në datën] se si e keni korrigjuar ose si synoni ta rregulloni këtë çështje”.

Sinqerisht,

Inspektori

cc: Kryetarit, Këshillit.

Pasqyra e Zhvillimit të Dëmeve

Vitët fiskale		Dëmet sipas viteve										
		Viti Y-5 ¹ dhe më parë	Viti Y-4	Viti Y-4 dhe më parë	Viti Y-3	Viti Y-3 dhe më parë	Viti Y-2	Viti Y-2 dhe më parë	Viti Y-1	Viti Y-1 dhe më parë	Viti Y	Viti Y dhe më parë
Viti Y-5 ¹	Provigjonet ² fundi i vitit											
Viti Y-4	Paguar gjatë vitit											
	Provigjonet fundi i vitit											
	Tepricë/Defiçit											
	Raporti Tepricë/Defiçit											
Viti Y-3	Paguar gjatë vitit											
	Provigjonet fundi i vitit											
	Tepricë/Defiçit											
	Raporti Tepricë/Defiçit											
Viti Y-2	Paguar gjatë vitit											
	Provigjonet fundi i vitit											
	Tepricë/Defiçit											
	Raporti Tepricë/Defiçit											
	Provigjonet fundi i vitit											
	Tepricë/Defiçit											
	Raporti Tepricë/Defiçit											
Viti Y-1	Paguar gjatë vitit											
	Provigjonet fundi i vitit											
	Tepricë/Defiçit											
	Raporti Tepricë/Defiçit											
Viti Y	Paguar gjatë vitit											
	Provigjonet fundi i vitit											
	Tepricë/Defiçit											
	Raporti Tepricë/Defiçit											

1 Y- viti aktual; Y-1= viti i mëparshëm, etj.

2 Provigjone = provigjoni i dëmit + shpenzimet e trajtimit + IBNR

Në përdorimin e pasqyrës së zhvillimit të dëmeve duhet kujdes pasi treguesit në përmirësim jo detyrimisht nënkuptojnë tendenca në përmirësim. Për shembull, le të supozojmë se kemi një tendencë si më poshtë të deficitit në praktikatat e provigjonimit:

Deficit për vitin e aksidentit Y-5, dmth., 5 vjet zhvillim.....	30 %
Deficit për vitin e aksidentit Y-4, dmth., 4 vjet zhvillim.....	25 %
Deficit për vitin e aksidentit Y-3, dmth., 3 vjet zhvillim.....	20 %
Deficit për vitin e aksidentit Y-2, dmth., 2 vjet zhvillim.....	10 %
Deficit për vitin e aksidentit Y-1, i.e., dmth 1 vit zhvillim	5 %

Duket sikur provigjonimi i shoqërisë po vjen duke u përmirësuar, por duhet vënë re që deficitin në rënie është progresivisht për periudha më të shkurtra zhvillimi të dëmeve. Nëse për vitin e aksidentit Y-5 deficitin pas një viti është 5%, pas dy vjetësh 10%, dhe në vazhdim arrin 30% pas pesë vjetësh, kjo do të thotë që edhe deficitin në periudhat e shkurtra do të rritet me rritjen e periudhës së zhvillimit, në këtë mënyrë duket që nuk ka përmirësim në praktikatat e provigjonimit. Sado e dobishme të jetë kjo pasqyrë, kërkon kujdes në interpretim.

TESTET E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Hyrje në Testet e Paralajmërimit të Hershëm

Matrica e rrezikut i jep analistit një mjet për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nivelet relative të rrezikut në fusha të ndryshme të rreziqeve të biznesit të siguruesve. Ajo përdor të dhënat sasiore, duke ju referuar në mënyrë të veçantë raporteve dhe tendencave të TPH (ang. EWT) dhe parametrave financiarë bazë, si dhe të dhënat cilësore, veçanërisht vëzhgimeve të inspektorëve dhe mbledhjes dhe vlerësimit sistematik të informacionit të tregut.

Raportet EWT konsiderohen se janë tregues kyç të fillimit të dobësimit financiar tek siguruesit e përgjithshëm. Raportet u zhvilluan nga Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve të SHBA (NAIC) në fillim të viteve 1970 dhe u bazua në zbatimin e qindra raporteve në rezultatet financiare të disa mijëra siguruesve të përgjithshëm dhe qindra paafësive pagueuse të siguruesve që ndodhën në një periudhë mbi 50 vjeçare. U demonstrua se kur grupi i përzgjedhur i raporteve u aplikua për një shoqëri të veçantë, nga ana statistikore pati një korrelacion të rëndësishëm midis numrit të raporteve që dilnin jashtë ‘diapazoneve normale’ të paracaktuar dhe të probabilitetit të vështirësisë financiare serioze për siguruesin. EWT u identifikuan si ato raporte që ishin në gjendje që të parashikonin paafësinë pagueuse me probabilitet të arsyeshëm dy vite përpara dështimit të shoqërisë. Sipas njohurive tona më të mira, ky është i vetmi studim në shkallë të gjerë për raportet e sigurimeve që është kryer mbi një bazë të rëndësishme statistikore.

EWT nuk janë vetëm tregues financiarë që ne duhet të konsiderojmë kur analizojmë fuqinë financiare të një siguruesi të përgjithshëm, por ato pranohen pothuajse në mënyrë universale dhe që prej derivimit të tyre rreth 40 vite më parë, mbikëqyrësit në të gjithë botën kanë konstatuar se ato japin një kontribut mjaft të dobishëm për matjen e rrezikut të siguruesit.

Siç përmendëm më parë çdo test ka një diapazon normal. Diapazoni normal i pranuar mund të mos jetë i njëjtë në çdo vend, pasi varet nga numri i lojtarëve dhe kushteve në treg por duhet të përdoret kujdes i madh në qoftë se vendosen diapazone normale të ndryshme nga ato të NAIC. NAIC përcaktoi diapazonet normale në mënyrë empirike në të gjithë gamën e gjerë të shoqërive dhe ngjarjeve gjatë një periudhe të konsiderueshme dhe, meqenëse biznesi i sigurimeve është në thelb i njëjtë në çdo juridiksion, është e vështirë që të imagjinohet që këto diapazone të mos jenë të zbatueshme dhe në juridiksione të tjera. Në tregjet në zhvillim, ka gjasë që shumë shoqëri të mos jenë brenda diapazoneve normale të NAIC. Në këto rrethana, mbikëqyrësit mund ti përdorin EWT për të identifikuar shoqëritë që bëjnë përjashtim, d.m.th., shoqëritë me rezultate mjaft të ndryshme se sa vlerat mesatare ose vlerat me ndodhi më të shpeshtë, por qëllimi përfundimtar duhet të jetë që të sillen të gjitha shoqëritë tek diapazonet normale ose afër tyre.

Interpretimi i rezultateve të EWT si dhe me ato të çdo mjeti analitik, kërkon zbatimin e gjykimit me dije dhe të informuar. Është thelbësore që mbikëqyrësi dhe inspektori i veçantë të shikojë rezultatet e testit në kontekstin e njohurive të tij/të saj të shoqërisë dhe rrethanave të saj. Dy shoqëri me rezultate testi të krahasueshme mund të paraqesin profile mjaft të

ndryshme të rrezikut, p.sh., shoqëria që shkruan vetëm rreziqet e pronës rezidenciale kundrejt një shoqërie që shkruan linja të shumta duke përfshirë produkte të ndryshme të përgjegjësisve tregtare.

Për disa raporte ‘rreziku i lartë’ barazohet me vlerat e raportit më të ulët, p.sh., kapitali si përqindje e detyrimeve dhe për raporte të tjera ‘rreziku më i lartë’ do të tregohet nga vlerat më të mëdha të raportit p.sh., primet neto të shkruara ndaj kapitalit.

Në vlerësimin e rrezikut, disa juridiksione marrin parasysh masën në të cilën raportet janë jashtë diapazonit normal. Për shembull, në qoftë se diapazoni normal për raportin e primeve të shkruara neto ndaj kapitalit është 3.0 ose më pak, këto juridiksione do të jepnin një klasifikim të rrezikut më të lartë të një shoqërie që ka një raport prej 4.5 se sa në rastin e një shoqërie me raport 3.5. Edhe pse do të ishte e vështirë që të argumentohet se nuk duhet të jetë kështu, të tjerët ndiejnë se përdorimi peshave specifike i jep një shkallë precizioni procesit të vlerësimit të rrezikut që në një farë mënyrë është e vështirë që të justifikohet duke pasur parasysh aspektet e tjera jo të sakta, duke përfshirë cilësinë e të dhënave, që janë një pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit. Veç kësaj, ndoshta nuk është veprim i zgjuar që të përpiqemi të zëvendësojmë gjykimin e mirë me një qasje të shprehur tej mase në mënyrë sasiore. Nuk ka asgjë që ta pengojë mbikëqyrësin që të marrë parasysh vlerën e raportit më të lartë të dukshëm duke e krahasuar me një rast tjetër, gjatë kohës kur harton reagimin mbikëqyrës dhe planin për të sjellë rreziqet nën një kontroll më të mirë.

Shumica e vendeve përdorin rreth 15 raporte EWT, por vende të ndryshme kanë modifikuar disa raporte me kalimin e kohës dhe kanë shtuar raporte të tjera që ata besojnë se janë veçanërisht efektivë ose me një rëndësi të veçantë në tregjet e tyre.

Qëllimi i EWT është që të veprojnë si tregues të paralajmërimit të hershëm dhe të ndihmojnë në vendosjen e përparësive për alokimin e burimeve në monitorimin e shoqërive të të sigurimeve. Pavarësisht disa kufizimeve dhe paralajmërimeve, raportet janë pranuar në mënyrë ndërkombëtare për shkak të efektivitetit të tyre si tregues të rrezikut.

Raportet e diskutuara më poshtë nuk synojnë që të zbatohen në mënyrë mekanike dhe pritet që analisti ta axhustojë objektin e inspektimit/analizës po kështu, në varësi të rrethanave të veçanta. Të gjitha referimet ndaj ‘primit neto’ do të thotë prime totale të shkruara duke zbritur risigurimin e ceduar. Me ‘kapital’ kuptojmë asetet pasi janë zbritur detyrimet, këto siç raportohen në pasqyrat financiare të audituara por pas rregullimeve/axhustimeve që mund të bëhen nga mbikëqyrësi.

Mbikëqyrësit mund t’i bëjnë axhustime shifrave financiare të audituara kur vlerësojnë rrezikun, kur testojnë pozicionin minimal të aftësisë pagueuse e kështu me radhë. Për shembull, në qoftë se mbikëqyrësi ka prova të besueshme se disa nga pronat e paluajtshme të siguruesit janë mjaft të mbivlerësuara, atëherë kur kryhen procesin e vlerësimit të rrezikut nga këndvështrimi mbikëqyrës, mbikëqyrësi mund të axhustojë vlerën e reflektuar në bilanc. Por axhustimet NUK do të përfshinin ndonjë ndryshim faktik në pasqyrat financiare të audituara. Këto janë rishikuar nga audituesit, janë miratuar përfundimisht dhe sipas opinionit të audituesit, paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të shoqërisë. Pikëpamja e

raportimit financiar të përgjithshëm kombëtar ose ndërkombëtar nuk është e njëjtë me pikëpamjen mbikëqyrëse. Kjo ndodh në veçanti kur raportohet për vlerën e tregut të asetëve. Është praktikë e zakonshme për agjencitë mbikëqyrëse që të bëjnë disa axhustime gjatë aplikimit të testeve të ndryshme dhe matësve për vlerësimin e rrezikut.

Raportet mund të shprehen si përqindje ose, aty ku janë më të mëdha se 1, si shumëfisha.

Formulat e Raporteve të Testeve të Paralajmërimit të Hershëm

1. Ndryshimi në primet e shkruara bruto/neto (G/NPW)

$$= (G/NPW, \text{viti aktual} - G/NPW, \text{viti i mëparshëm}) / G/NPW \text{ viti i mëparshëm}$$

Vlera e pranuar për këtë raport është $\pm 33\%$

Raporti llogaritet si për primet bruto edhe neto dhe është një tregues i rëndësishëm i rrezikut të marrjes në sigurim. Rritja ose rënia e shpejtë në volumin e primit mund të tregojë ndryshime të mëdha në strategjinë e shoqërisë ose faktorë të tjerë të rëndësishëm. Gjithashtu kur ka rritje të shpejtë ka dhe një risk mjaft të rritur që sistemet TI, sistemet e kontabilitetit ose sistemet e tjera të kontrollit të brendshëm dhe operacionale mund të mos jenë gjendje të përballojnë volumin e rritur të biznesit. Problemet në ndonjë nga këto fusha mund të çojnë në vështirësi financiare të rënda me kalimin e kohës. Ndryshime të mëdha në volumin e primit në rritje ose në rënie gjithmonë duhet të hetohen sepse kjo është rryma e të ardhurave që përbën gjakun jetësor të shoqërisë.

Rritjet e mëdha në primet neto mund të sinjalizojnë hyrjen në linja të reja të biznesit, përpjekjet për të rritur pjesën në treg ose strategjinë e marrjes në sigurim për nevoja likuiditeti (ang. cash flow underwriting-praktika e reduktimit të tarifave për të fituar biznes shtesë, duke gjeneruar në këtë mënyrë para që mund të përdoren për të plotësuar kërkesat imediate për likuiditet). Ndryshimet e rëndësishme në marrëveshjet e risigurimit do të çojnë gjithashtu në lindjen e ndryshimeve të rëndësishme në volumin e primit neto, përsëri duke pasur potencialin për risk të rritur.

Duke pasur parasysh se në shumicën e mbulimeve të sigurimit të përgjithshëm ka pak për tu diferencuar midis policës së një siguruesi nga ajo e një tjetri, mund të pyesim në mënyrë të arsyeshme se cilët faktorë mund të kontribuonin në rritjen e shpejtë në biznes të një shoqërie krahasuar me tregun si i tërë. Shpesh arsyeja për rritjen është se policat e shoqërisë kanë çmime poshtë tarifave të konkurrentëve të tyre. Megjithatë, në qoftë se policat kanë çmim të ulët, efekti përfundimtar zakonisht do të jetë që primet janë të pamjaftueshme për të mbuluar dëmet që lindin në mënyrë të pashmangshme nga mbulimet e ofruara. Kështu, një strategji biznesi me çmime të ulëta që mund të jetë iniciuar nga siguruesi për të lehtësuar presionet për likuiditet dhe për të gjeneruar lëvizje parash, zakonisht do të ketë rezultatin e kundërt gjatë afatit të mesëm deri në afatgjatë, d.m.th., një ngërç në fluksin e parave dhe ndoshta paaftësi paguese.

Në të kundërt, rënie të rëndësishme në volumin e primit mund të tregojnë humbjen e pjesës së tregut për shkak të konkurrencës, aplikimi i standardeve më strikte të marrjes në sigurim ose madje humbjes së favorizimeve nga ndërmjetësit e pavarur (gjë që zakonisht do të thotë

që siguries të tjerë paguajnë përqindje komisioni më të lartë!). Një tendencë për reduktimin e volumit të primit mund të çojë në një problem me rritjen e raportit të shpenzimit për shkak se kostot fikse të shoqërisë të tilla si pagat dhe qiraja, nuk do të jenë në gjendje që të ulen në të njëjtën përqindje në të cilën ulet volumi i primit. Kjo do të thotë se shpenzimet fikse do të konsumojnë një pjesë në rritje të të ardhurave duke zvogëluar potencialin për veprimtari fitimprurëse.

2. Raporti i Rrezikut të Sigurimit

- **Raporti i Rrezikut Neto = primit e shkruara neto / kapitali**

Diapazoni normal për këtë raport është ≤ 3.0 .

- **Raporti i Rrezikut Bruto = primi i shkruar bruto / kapitali**

Diapazoni normal për këtë raport është ≤ 7.0 .

Rëndësia e Raportit të Rrezikut Neto

Dihet që sigurimi i përgjithshëm (i Jojetës) është mjaft i paqëndrueshëm për shkak të paparashikueshmërisë së dëmeve (moti, tërmeti, fatkeqësi të tjera natyrore, zjarret e mëdha, etj). Le të supozojmë se raporti i kombinuar mund të lëvizë midis 80% dhe 120% në një vit të dhënë. Në qoftë se volumi i primit neto është 100, do të kemi një fitim maksimal të marrjes në sigurim prej 20 ose një humbje maksimale të marrjes në sigurim prej 20. Le të themi se baza e kapitalit është e barabartë me 50 kështu që raporti = me 2.0 (primi neto i 100 pjesëtuar me kapitalin 50).

Tani, në qoftë se raporti i kombinuar është 80%, arrijmë një fitim të marrjes në sigurim prej 20, i cili jep një kontribut të marrjes në sigurim të kthimit ndaj kapitalit (ROE) prej + 40% (fitimi 20 pjesëtuar me kapitalin 50). Në të kundërt, në qoftë se raporti i kombinuar është 120% dhe arrin një humbje të marrjes në sigurim prej 20, e cila jep një kontribut të marrjes në sigurim në ROE prej – 40% (humbja e 20 pjesëtuar me kapitalin prej 50). Kështu, sipas supozimeve tona të paqëndrueshmërisë në raportin e kombinuar dhe me një raport rreziku prej 2.0, kontributi ynë i marrjes në sigurim në ROE do të lëvizë midis $\pm 40\%$.

Le të mbajmë të njëjtin supozim për paqëndrueshmërinë e raportit të kombinuar por të supozojmë që raporti i rrezikut është 5.0 me 1 në vend të 2.0 me 1. Me të njëjtën bazë kapitali prej 50 tani do të kemi një volum primi prej 250 (kapital x raporti i rrezikut = 50 x 5).

Tani, në qoftë se raporti i kombinuar është 80% ne arrijmë një fitim të marrjes në sigurim prej 50, i cili jep një kontribut të marrjes në sigurim në ROE prej + 100% (fitimi prej 50 i pjesëtuar me kapitalin prej 50), dhe në qoftë se raporti i kombinuar është 120%, ne kemi një humbje të marrjes në sigurim prej 50, e cila jep një kontribut të marrjes në sigurim në ROE, prej – 100% (humbja e 50 pjesëtuar me kapitalin prej 50).

Pra, mund të shikojmë se me të njëjtat supozime për paqëndrueshmërinë e marrjes në sigurim, efekti potencial në bazën e kapitalit tonë të një viti të keq të marrjes në sigurim

zmadhohet në raport të drejtë me përqindjen e rritjes në raportin e rrezikut. Në qoftë se raporti i rrezikut rritet nga 2.0 në 5.0, potenciali i humbjes së marrjes në sigurim rritet në të njëjtin përpjesëtim dhe meqenëse kapitali nuk ka ndryshuar, efekti potencial në të gjithashtu rritet në të njëjtin përpjesëtim.

Kjo rritje vepron si në drejtimin pozitiv edhe në atë negativ, kështu sipërmarrësit, të cilët synojnë të jenë optimistë, në përgjithësi duan që raporti i rrezikut të jetë sa më i lartë që të jetë e mundur në mënyrë që ai të maksimalizojë të ardhurat e tyre mbi kapitalin kur janë pozitive rezultatet e marrjes në sigurim. Por mbikëqyrësit, të cilët duhet të shqetësohen për rreziqet e përfshira, mendojnë për efektin në bazën e kapitalit të shoqërisë në qoftë se marrja në sigurim është e dobët dhe raporti i rrezikut është i lartë. Një raport i lartë i rrezikut dhe një rezultat negativ i marrjes në sigurim do të maksimalizonin efektin negativ në pozicionin e kapitalit të shoqërisë.

Përvoja ka vendosur se një raport neto i rrezikut me rreth 3.0 nuk duhet të tejkalohet. Kur raporti i rrezikut është mbi këtë normë, baza e kapitalit ekspozohet në mënyrë të rrezikshme për shkak të natyrës të paparashikueshme të rezultateve të marrjes në sigurim. Sa më e madhe të jetë masa në të cilën i tejkalon kufijtë e pranueshëm raporti i rrezikut, aq më i madh është ekspozimi ndaj bazës së kapitalit të shoqërisë.

Rëndësia e Raportit të Rrezikut Bruto

Për sa kohë që kemi besim në marrëveshjet e risigurimit të shoqërisë, raporti i rrezikut neto është raport i rëndësishëm për tu konsideruar. Raporti i rrezikut bruto pranon se gjithmonë ka një risk të caktuar për grumbullimin e shumave të risigurimit, kështu që duhet specifikuar edhe një prag për raportin. Kjo parashikon të paktën një kufi për levën që do të ndodhte në rastin e mos mbledhjes së shumave nga risigurimi.

3. Raporti Dëme/Prime Neto

= dëmet e ndodhura neto / primet e fituara neto

Diapazoni normal për këtë raport është 50% deri në 80%

Vlerat aktuale të këtij raporti në tregun Shqiptar janë tepër të ulëta, duke u luhatur në 25%-30% në vitet e fundit. Ky raport duhet të monitorohet me kujdes, derisa eksperiencia e dëmeve të siguruesve shqiptarë të zhvillohet në normat e sugjeruara nga 50%-80%, të cilat rekomandohen nga Banka Botërore për tregjet në zhvillim.

4. Raporti i Shpenzimeve

= shpenzimet / primet e fituara neto

Diapazoni normal për këtë raport është 25% deri në 50%

Vlerat aktuale të këtij raporti në tregun Shqiptar janë tepër të larta, duke u luhatur në 65%-70% në vitet e fundit. Ky raport duhet të monitorohet me kujdes, derisa të zhvillohet në normat e sugjeruara nga 25%-50%, të cilat rekomandohen nga Banka Botërore për tregjet në zhvillim.

5. Raporti i kombinuar

= (dëmet e ndodhura neto + shpenzimet) / primet e fituara neto

Diapazoni normal për këtë raport është 85% deri në 105%

Raporti i kombinuar përfaqëson rezultatin e llogarisë teknike të shoqërisë. Aty ku raporti i kombinuar i tejkalon 100%, shoqëria duhet të ketë të ardhura nga investimet dhe/ose të ardhura të tjera të mjaftueshme për të kompensuar tepricën mbi 100%, në mënyrë që të mbetet me fitim. Ka një rrezik, që në qoftë se të ardhurat e investimit janë më të larta, shoqëritë me dije do të pranojnë një humbje në llogarinë teknike, duke u bazuar tek të ardhurat e investimit për të prodhuar fitim. Arsyeja e zakonshme është që të rritet pjesa në treg duke reduktuar tarifat e primit. Në qoftë se tregjet e investimit pësojnë një rënie, shoqëritë që kanë tentuar për këtë strategji mund të gjenden në vështirësi financiare.

6. Raporti i Mbajtjes

= primet e shkruara neto / primet e shkruara bruto

Diapazoni normal për këtë raport është 40% deri në 80%

Ky raport përcakton se sa ka mbajtur një shoqëri nga biznesi i saj i shkruar për llogarinë e saj, d.m.th., sa nuk ka risiguruar. Lëvizjet në këtë raport mund të sugjerojnë një politikë më agresive dhe konservatore të marrjes në sigurim ose probleme me risiguruesit.

7. Raporti i Ndryshimit të Kapitalit

= ((kapitali, viti aktual pas zbritjes së injektiveve të kapitalit gjatë vitit) – (kapitali, viti i mëparshëm pas zbritjes së injektiveve të kapitalit gjatë vitit))/kapitali, viti i mëparshëm pas zbritjes së injektiveve të kapitalit gjatë vitit

Diapazoni normal për këtë raport është -10% deri në +25%.

Ky raport pasqyron ndryshimin nga viti në vit në kapitalin e një shoqërie që rezulton nga operacionet. Duke pasur parasysh se baza e kapitalit të shoqërisë është mbrojtja e saj përfundimtare kundër paaftësisë paguese, ndryshimi në të nga një vit në tjetrin është një tregues i rëndësishëm i rrezikut financiar. Ndryshimet përtej kufirit të sipërm të diapazonit normal mund të tregojnë për një ngjarje jo normale të njehershme si një përfitim rastësor nga një risk i vetëm i madh. Ndryshimet përtej kufirit të poshtëm janë shkak për shqetësim të menjëhershëm për shkak të implikimeve në aftësinë paguese.

8. Testi i Debitorëve

= debitorë nga primi / kapitali

Vlera e pranuar për këtë raport është ≤ 20%

Shumat e mëdha të pazakonta të kërkueshme nga ndërmjetësit mund të jenë një sinjal që agjentët ose ndërmjetësit nuk besojnë se shoqëria premton vazhdimësi ose kanë ndonjë ankesë tjetër të rëndë kundër saj. Gjithashtu në qoftë se një ndërmjetës bëhet i paaftë për të paguar ndërsa i detyrohet një shumë të madhe siguruesit, kjo mund të ndikojë në mënyrë serioze në pozicionin financiar të siguruesit. Në disa vende, grumbullimi i primeve nga policat është problem, kështu që ky mund të jetë burimi i niveleve të mëdha të debitorëve.

Në të gjitha rastet, raporti mat masën në të cilën baza e kapitalit të shoqërisë do të ndikohet në qoftë se nuk mblihen shumat e papaguara. Në qoftë se raporti i kalon 50%, ekziston një shkallë e pamatshme e rrezikut që baza e kapitalit të shoqërisë mund të zvogëlohet ndjeshëm nga mospagesa e shumave që ndërmjetësit i detyrohen siguruesit.

9. Borxhe/hua me palët e lidhura / Kapitali

= të gjitha llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura / kapitali

Vlera e pranuar për këtë raport është $\leq 10\%$

Në qoftë se ka probleme financiare në një grup, shumat nga palët e lidhura mund të mos mblihen. Transaksionet e palëve të lidhura normalisht fillohen me palën dominuese ose kontrolluese dhe zakonisht janë interesat e asaj pale që marrin përparësi. Në një situatë të paafësisë paguese, këto palë kanë gjasa që të refuzojnë ripagesën e borxhit, duke çuar në procese gjyqësore për vite me radhë që mund të mos jenë të suksesshëm, dhe duke i lënë të siguarit në pozita jo të mira. Të gjitha transaksionet me palët e lidhura dhe llogaritë që rezultojnë prej tyre duhet të kufizohen dhe monitorohen fort nga rregullatori.

Borxhi i palës së lidhur nuk përfshin zëra të tillë si investimet në filiale dhe mbështetjen financiare për degët ose filialet në juridiksionet e huaja nën autoritetin e një rregullatori të huaj. Borxhi i palës së lidhur përfshin bilancet e papaguara që lindin nga kreditë ose parapagesat e ripagueshme që u janë bërë palëve të lidhura, përfshirë ndonjë shoqëri, aksionerë, drejtorë apo zyrtarë të lidhur të shoqërisë ose të ndonjë shoqërie të lidhur dhe anëtarët e familjes të ndonjë aksioneri, drejtori ose zyrtari të shoqërisë ose të ndonjë shoqërie të lidhur.

10. Kapitali si % e Detyrimeve

= kapitali / (detyrimet + rezervat e kërkuara nga rregullatori)

Diapazoni normal për këtë raport është $\geq 25\%$

Ky është një nga raportet më bazë të disponueshme sepse ai mat marzhin e aktiveve mbi detyrimet që lidhen me shumat që u detyrohen të siguarve dhe kreditorëve të tjerë. Tek një sigurues, detyrimet janë të vështira për tu shprehur në sasi. Sa më e vogël baza e kapitalit që lidhet me detyrimet, aq më i vogël kapaciteti që shoqëria do të ketë për të amortizuar goditjet e paparashikuara, p.sh., humbjet katastrofike për shkak të tërmetit ose përmbytjes, dështimit të një risiguruesi, rezultateve jashtëzakonisht të këqija të marrjes në sigurim ose humbjeve të investimit.

Detyrimet e shoqërisë do të përfshijnë çdo axhustim që kërkohet nga rregullatori për të marrë parasysh mbivlerësimin e aseteve (të tilla si pasuritë e paluajtshme) ose nënvlerësimin e detyrimeve (të tilla si provigjonet e dëmeve) si dhe ndonjë provigjon mbikëqyrës të vçantë që mund të kërkohet, p.sh., provigjone shtesë për biznesin e garancive.

11. Marzhi i Aftësisë Pagueuse

= kapitali ose aktivet e disponuara / kapitali ose aktivet e kërkuara

Diapazoni normal për këtë raport do të varet nga natyra e kërkesave të aftësisë paguese.

Marzhi i aftësisë paguese përcaktohet aktualisht mbi bazën ose të shumës vjetore të primeve ose të shumës mesatare të dëmeve për tre vitet e kaluar financiarë, në përputhje me direktivën e BE-së për Aftësinë Pagueuse 1. Marzhi është rezultati më i lartë i llogaritjeve me bazë primet ose dëmet.

Në qoftë se AMF lëviz drejt një qasjeje sipas ‘testit minimal të aktiveve’ (ang. MAT), aftësia paguese do të llogaritet si marzhi i aktiveve të disponueshme mbi aktivet e kërkuara. Aktivet e kërkuara llogariten si totali i detyrimeve plus marzhe pasigurie. Detyrimet më të dukshme për marzhet janë provigjonet e dëmeve për shkak të pasigurisë të parashikimit dhe primit të pa fituar për shkak të pasigurisë së saktësisë së primit. Aktivet e disponueshme llogariten si aktivet totale pas zbritjes së aktiveve të palejuara. Këto mund të jenë aktive të tilla si kërkesa të arkëtueshme që kanë kaluar një kohë të caktuar, pasuritë e paluajtshme dhe aktivet ‘e buta’ të tilla si shpenzimet e shtyra dhe/ose të parapaguara dhe emri i mirë. Rregullatorët në mënyrë tipike kërkojnë që të mbahet një marzh mbi nivelin ‘e kërkuar’ dhe ky është marzhi i aftësisë paguese. Kërkesa e zakonshme për marzhin sipas skenarit MAT është 10%, d.m.th., aktivet e disponuara duhet të jenë të paktën 110% të aktiveve të kërkuara.

Marzhi i vendosur nga rregullatori synon që të jetë minimumi i nivelit të pranueshëm të shëndetit financiar. Kur marzhi i aftësisë paguese bie nën nivelin e kërkuar minimal, rregullatori mundësi që të fillojë masat për ta sjellë shoqërinë përsëri në gjendje të përmbushë kërkesën. Këto masa mund të përfshijnë kufizimet për volumin e primit, frekuencën e rritur të raportimit financiar, frekuencën e rritur të monitorimit në vend, depozitim të planeve të biznesit duke treguar se si do të përmirësohet pozicioni i shoqërisë, duke kërkuar një injektim kapitali e kështu me radhë.

Një shoqëri nuk quhet pa aftësi paguese thjesht sepse ajo nuk plotëson kërkesën minimale të aftësisë paguese. Paaftësia për të paguar ndodh vetëm kur detyrimet tejkalojnë aktivet. Kërkesat për aftësinë paguese imponojnë një detyrim për siguresit që të ruajnë një marzh të caktuar të aktiveve ose kapitalit, kështu mospërmbushja e kërkesës nuk do të thotë që nuk ka marzh, siç do të ishte rasti kur arrihet pika e paaftësisë paguese.

12. Rezultati nga investimi

= (të ardhurat neto nga investimi / (aktivet e investuara në fund të vitit + aktivet e investuara në fillim të vitit) / 2) - të ardhurat neto nga investimi gjatë vitit

Diapazoni për këtë raport është norma mesatare e bonove të thesarit gjashtëmujore të qeverisë siç tregohet në Kurbën e Yield-it të Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Rezultatet mbi normale nga investimi janë një tregues i rrezikut i cili ka nevojë të hetohet. Për shembull, në qoftë se një fitim i ulët në mënyrë të pazakonshme vjen si rezultat i investimeve që kanë falimentuar, kjo mund të jetë një tregues i problemeve më serioze për siguresin, si politikat dhe procedurat e dobëta të administrimit të rrezikut në lidhje me

rrezikun e kreditit. Nga ana tjetër, në qoftë se fitimi i ulët është një pasqyrim i faktit se shoqëria i jep hua fonde palëve të lidhura në norma poshtë tregut, kjo gjithashtu do të kishte implikime të mëdha në lidhje me rrezikurrezikun e përgjithshëm për shoqërinë.

Rezultatet nga investimi që janë konsiderueshëm mbi normat e tregut janë këmbana alarmi që tregojnë situata potenciale të një rreziku të lartë. Parimi themelor financiar që ‘risk i lartë do të thotë kthim të lartë’ nuk mund të anashkalohej. Në qoftë se rezultatet janë shumë më të larta se mesatarja, zakonisht kjo vjen nga që investimet janë me risk të lartë. Ndërsa shoqëria mund të ketë qenë me fat dhe ka fituar shumë në një vit, kjo lehtësisht mund të zerohet nga humbjet në periudhat e ardhshme.

Kur shoqëritë marrin fonde nga publiku dhe ofrojnë garanci për pagesat e ardhshme (të tilla si pagesat e dëmeve), fondet duhet të investohen në mënyrë të tillë që ato kërkesa likuiditeti në të ardhmen të jenë të sigurta në mënyrë të arsyeshme. Nga pikëpamja e mbikëqyrjes, siguruesit konsiderohen që i mbajnë fondet në besim për të siguruarit e tyre.

13. Raporti i likuiditetit

= totali i detyrimeve / (mjete monetare + bono thesari + depozita me afat)

Diapazoni normal për këtë raport është $\leq 95\%$

Veprimtaria e qëndrueshme e një kompanie sigurimi është e lidhur me administrimin e kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit. Paaftësia paguese ndonjëherë shkaktohet nga kreditorët e dëmtuar që kërkojnë të zbatohen urdhërat e likuidimit deri në sigurimin e zgjidhjeve të vendimeve gjyqësore të cilat nuk janë respektuar. Analiza e kompanive me paaftësi paguese ka treguar se shumë sigurues që u shpallën pa aftësi paguese shfaqën vlera në rritje të raportit të detyrimeve ndaj aktiveve likuide.

Ky raport, i cili mund të përshkruhet si një lloj raporti i ‘testit acid’, është një test i mirë për aftësinë paguese të kompanisë për të përmbushur kërkesat financiare që mund të vendosen ndaj saj, pa qenë nevoja për shitjen e parakohshme e investimeve afatgjata të pamaturuara, ose marrjen e parave hua. Kjo është kritike për siguruesit e përgjithshëm, pasi vështirësia në pagimin normal të dëmeve mund të shkaktojë një imazh negativ të shoqërisë me pasojë tek të ardhurat, së bashku me një numër në rritje të ankesave pranë AMF.

14. Raporti i sigurisë

= provigjoni për dëme neto / kapitali

Vlera e pranuar për këtë raport është ≤ 2.5

Provigjonet neto për dëmet në këtë raport duhet të rakordojnë me provigjonet e pasqyruara në bilancin e kompanisë dhe duhet të përfshijnë provigjonet për të gjitha shpenzimet lidhur me dëmet, p.sh., dëmshpërblimi, tarifat e vlerësueve, tarifat ligjore dhe IBNR. Raporti i sigurisë është një lloj raporti i levës financiare. Nëse dëmet pezull janë 1,5 herë më shumë se kapitali, atëherë një nënvlerësim prej 10% i detyrimit të dëmeve është e barabartë me 15% të bazës së kapitalit të kompanisë. Por, nëse raporti i dëmeve pezull dhe kapitalit është 5 me 1, i njëjti 10% i detyrimit të dëmeve bëhet 50% e kapitalit dhe gjysma e bazës së kapitalit të kompanisë do të eliminohej nga nënvlerësimi në rezerva.

Është gjithmonë e vështirë për të ditur masën në të cilën provigjonet e dëmeve mund të jenë nënvlerësuar, kështu duke mbajtur raportin nën 2.5 shmang rrezikun e tepërt në bazën e kapitalit të siguresit.

15. Kthimi ndaj kapitalit (ROE)

$$= \text{rezultati financiar neto} / ((\text{kapitali, viti aktual} + \text{kapitali viti paraardhës})/2)$$

Diapazoni për këtë raport duhet të jetë kthimi mesatar për të gjitha kompanitë për vitin fiskal paraardhës.

Kthimi ndaj kapitalit (ROE) është një matës i përgjithshëm i rëndësishëm i performancës financiare për çdo kompani. Kthimi i ulët ose negativ gjatë një periudhe kohore do të shkaktojë përkeqësim financiar të kompanisë.

Po kështu, qëndrueshmëria e industrisë së sigurimeve varet nga aksionerët që bien dakord për të investuar fondet e tyre në kompanitë e sigurimit. Nëse ata nuk marrin kthim të arsyeshëm, sidomos duke pasur parasysh rezultatet e paqëndrueshme të siguresit, ata do të tërheqin kapitalin e tyre dhe industria do të zhduket.

Një zgjidhje tipike mbikëqyrëse për problemet financiare është që t'i kërkojë aksionerëve për të rritur bazën e kapitalit të shoqërisë duke investuar fonde shtesë. Sa më gjatë që kompania të ketë gjeneruar kthim negativ, aq më i madh do të jetë rezistenca e aksionerëve për të bërë një investim të tillë shtesë. Prandaj, përveç vlerës si një tregues i prosperitetit të siguresit, mbikëqyrësit duhet të kenë parasysh se më të gjatë ata lejojnë një sigures për të vepruar me kthim të papranueshëm për investitorët, aq më e vështirë në fund të fundit do të jetë për të bindur aksionerët për të vazhduar mbështetjen e tyre të siguresit.

16. Raporti i mjaftueshmërisë së provigjonit të dëmeve

$$= \text{tepricë ose deficit në dëmet pezull të vitit paraardhës} / \text{kapitali}$$

Vlera e pranuar për këtë raport është $\leq -10\%$.

Raporti i mjaftueshmërisë së provigjonit të dëmeve në total në lidhje me dëmet që kanë ndodhur gjatë një periudhe të caktuar, pas një viti zhvillim, në raport me bazën e kapitalit të shoqërisë. Aty ku zhvillimi i provigjoneve për dëmet është i favorshëm, raporti merr vlerë pozitive; në të kundërt vlera është negative.

Nëse raporti i mjaftueshmërisë së provigjoneve sugjeron që vlerësimet e shoqërisë për dëmet pezull janë tepër të ulëta, atëherë fitueshmëria e shoqërisë sikurse dhe baza e kapitalit, do të mbivlerësohen në masë të plotë me vlerën e nënprovigjonimit. Kjo është veçanërisht situatë serioze, nëse treguesi shfaq deficit të vazhdueshëm të shoqërisë në provigjonimin e dëmeve në periudha më të gjata se një vit. Në këtë situatë, të gjitha raportet e tjera dhe përcaktimi i aftësisë pagueuse, duhet të korrigjohen për të marrë në konsideratë faktin që shifrat e raportuara kanë mbivlerësuar të ardhurat dhe nënvlerësuar detyrimet e shoqërisë.

Testet e Paralajmërimit të Hershëm (EWT) - Përdorimi në Vlerësimin e Rrezikut

Testet e Paralajmërimit të Hershëm - EWT janë një përbërës kyç i metodologjisë së vlerësimit të rrezikut.

Ndërsa kërkimet origjinale në lidhje me EWT, të përshkruara më sipër, janë kryer në Shtetet e Bashkuara duke e bazuar vlerësimin me fokus rrezikun vetëm në numrin e raporteve që bien jashtë diapazoneve normale, shumica e mbikëqyrësve bien dakord se jo të gjitha raportet kanë të njëjtën rëndësi. Për shembull, raporti i kapitalit ndaj detyrimeve është një masë themelore e shëndetit financiar. Një përkeqësim i konsiderueshëm në këtë raport flet për një rënie themelore në fuqinë financiare të shoqërisë. Nga ana tjetër, një përkeqësim i konsiderueshëm në raportin e likuiditetit, do të jetë një sinjal për ndryshime potencialisht të dëmshme që mund të ndodhin në kuadër të kompanisë, por pozita themelore e aftësinë paguese së siguruesit ende mund të mos jetë prekur ndjeshëm ende.

Disa juridiksione, për të matur këto ndryshime i japin pesha të ndryshme çdo raporti për qëllime të vlerësimit të rrezikut, duke faktorizuar ndonjëherë shkallën e devijimit të raportit nga diapazoni normal në peshën e rrezikut formal. Më pas, gjenerohet një vlerë për rrezikun e përgjithshëm të kompanisë (ang. risk score), ku çdo raport që ka një peshë që varet nga rëndësia e tij relative dhe masa e devijimit nga diapazoni normal.

Vështirësia me këto qasje është se nuk ka dy situata të ngjashme, në mënyrë që hartimi i një serie rregullash ose algoritmesh për qëllime të vendosjes së peshave, mund të çojë në një dobësi të sistemeve të bazuara në rregulla, d.m.th, "*one size does not fit all*" dhe duke i bërë rregullat për pesha specifike të ndryshme, mund të humbasë pamja e përgjithshme e disa informacioneve të rëndësishme në lidhje me rrezikunt. Asgjë nuk mund ta ndalojë një rregullator që të ketë faktorë të caktuar të në mendje kur harton strategjinë mbikëqyrëse, por duhen konsideruar të gjithë faktorët përpara se të mendohet vendosja e koeficientëve apo peshave.

Është e lehtë të mendohen situata ku koeficientët e paracaktuara mund të shkaktojnë probleme. Supozoni se vendosim që raporti i rrezikut neto është shumë i rëndësishëm dhe se atij do t'i jepet një peshë e barabartë me dy herë peshën që ju jepet raporteve të tjera. Nëse kemi të bëjmë me dy sigurues, A dhe B; Siguruesi A ka një raport rreziku neto 3.5, i cila është jashtë diapazonit normal të pranuar prej ≤ 3.0 , ndërsa raporti i rrezikut neto të Siguruesit B është 2.8, brenda diapazonit normale. Në skenarin tonë, A do të penalizohet, nga pikëpamja e vlerësimit të rrezikut për raportin e tij të lartë të rrezikut neto. Le të supozojmë më tej se kur shikojmë rezultatet EWT në të gjithë gamën, A dhe B janë të dy jashtë diapazoneve normale në 8 teste. Meqenëse një nga dështimet e testit për A është raporti i rrezikut neto, A do të konsiderohet se është me risk më të lartë se sa B. Megjithatë, pas plotësimit të vlerësimit tonë të rrezikut, mësojmë se Siguruesi A është një filial i njërit prej siguruesve më të mëdhenj European, i cili ka burime të mëdha kapitali dhe për të cilin rregullatori ka besim të plotë që do të japë kapitalin shtesë në qoftë se kërkohet nga Siguruesi A. Nga ana tjetër, Siguruesi B është me pronësi vendase dhe AMF e di se grupi i aksionerëve po kalon vështirësi financiare, kështu që në qoftë se do të kërkohet kapital shtesë apo ndihmë tjetër

nga shoqëria mëmë, ka shumë gjasë që kjo të mos jepet. Ajo që duhet të kuptojmë është se është i rëndësishëm gjithmonë konsiderimi i kujdesshëm i rrethanave kur interpretojmë rezultatet e EWT dhe në të gjitha aspektet e vlerësimit të rrezikut. Siç u përmend më lart, një nga faktorët më të rëndësishëm të vlerësimit të suksesshëm të rrezikut është kuptimi i biznesit.

Testet e Paralajmërimit të Hershëm – Komente të Tjera

Me testet e paralajmërimit të hershëm dhe të gjitha raportet e tjera, është e rëndësishme të konsiderohet jo vetëm shifra aktuale për një raport të veçantë, por edhe tendenca e raportit në kohë. Në qoftë se tre vite me parë një shoqëri shfaqte një raport në qendër të diapazonit të lejuar, dhe dy vite më parë raporti kishte lëvizur drejt një pozicioni afër kufirit të jashtëm të diapazonit, atëherë nuk duhet të çuditemi në qoftë se për vitin aktual rezultati do të jetë jashtë diapazonit normal. Sa herë që një raport ose një seri raportesh tregon një tendencë përkeqësuese, edhe pse raportet mund të mos kenë lëvizur akoma jashtë diapazoneve të tyre normale, mbikëqyrësi duhet të kontaktojë shoqërinë për t'i kërkuar (1) një shpjegim të përkeqësimit dhe (2) për planet e shoqërisë për të ndryshuar tendencën e padëshiruar.

Siç u përmend më sipër, vlerat individuale të raporteve duhet të interpretohen në kontekstin e biznesit të shoqërisë, pikave të fortave të menaxhimit dhe aksesit ndaj kapitalit.

Kur testet e paralajmërimit të hershëm - EWT u demonstrojnë se janë tregues të vlefshëm nga ana statistikore për rrezikun nga NAIC në Shtetet e Bashkuara, kjo ka ndodhur para ditëve të mbikëqyrjes me fokus rrezikun dhe profileve të rrezikut. Prandaj EWT shikoheshin thjesht si një grup raportesh. Megjithatë, në qoftë se mendojmë për rrezikun në kategoritë e tij, mund të konsiderojmë se çdo raport EWT është një tregues rreziku në një kategori rreziku të caktuar.

Analiza e Tendencave

Të gjithë raportet dhe treguesit e përshkruar më sipër sjellin përfitim po të analizohen në një sërë vitesh. Lëvizja e treguesve financiarë në kohë jep një kuptim më të vlefshëm e efektiv për drejtimin e përgjithshëm të operacioneve të shoqërive se sa një fotografi e vetme në një moment të caktuar në kohë.

Raportimet financiare vjetore në AMF duhet të përfshijnë një përmbledhje 5-vjeçare të parametrave kyç financiarë, pasi ato japin një pamje të dobishme të veprimtarisë gjatë periudhës. Konsiderohet me përfitim për rregullatorin, vëzhgimi i tendencave të rëndësishme të veprimtarisë, fitueshmërisë, dividendëve dhe ndryshimeve në kapital, raportet kyçe apo dhe në aftësinë paguese gjatë periudhës.